



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 191

Tiranë – E mërkurë, 22 janar 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 9, datë 27.12.2019	Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 682/4, datë 1.4.2016, “Për aktivitetin e autoshkollave, pajisjen e kandidatëve me leje drejtimi, kualifikimin e instruktorëve të autoshkollave dhe specialistëve të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR)” 17481
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 10, datë 27.12.2019	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 4, datë 28.6.2019, “Për dokumentet për qarkullim dhe regjistrim të mjeteve rrugore” 17481
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 446, datë 18.12.2019	Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme Detare” 17482
Urdhër i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 593, datë 31.12.2019	Për disa ndryshime në urdhrin nr. 344, datë 19.8.2013, “Për ngritjen e njësisë së shërbimit psikosocial”, të ndryshuar..... 17501
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 213, datë 20.12.2019	Për miratimin e marrëveshjes për bashkëpunim midis Entit Rregullator të Energjisë të Republikës së Shqipërisë (ERE) dhe Zyrës së Rregullatorit për Energjinë (ZRRE) të Republikës së Kosovës..... 17502
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 214, datë 20.12.2019	Për një ndryshim në “Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik” 17503
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 215, datë 20.12.2019	Mbi rishikimin e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” 17508
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 216, datë 20.12.2019	Mbi licencimin e shoqërisë “Axpo Albania” sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike..... 17513

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 217, datë 20.12.2019	Mbi licencimin e shoqërisë “Elva 2001” sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Mivas”, me kapacitet të instaluar 1940 kw.....	17514
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 218, datë 20.12.2019	Mbi licencimin e shoqërisë “HEC Arsti” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-i “Arsti”	17515
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 219, datë 20.12.2019	Mbi licencimin e shoqërisë “Hydro Power Panarit” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “Vile” me kapacitet të instaluar 1994 kw.....	17517
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 220, datë 20.12.2019	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a., në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”, të ndryshuar dhe një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”, të ndryshuar.....	17519
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 221, datë 20.12.2019	Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, “Mbi certifikimin e shoqërisë operatori i kombinuar i gazit natyror” “Albgaz” sh.a., të ndryshuar.....	17521
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 222, datë 20.12.2019	Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “NOA Energy Trade” sh.p.k., nr. 262, seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 7, datë 2.2.2015.....	17523
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 223, datë 20.12.2019	Mbi mosfillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Hydropower Elektrik” sh.p.k., me nr. 268, seria FK15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë të klientëve të kualifikuar, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 20, datë 11.2.2015.....	17524
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 224, datë 20.12.2019	Mbi mosfillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Power Elektrik Slabinjë” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike të klientëve të kualifikuar nr. 266, seria FK15, dhënë me vendim të Bordit të Komisionerve nr. 18, datë 11.2.2015.....	17526
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 225, datë 20.12.2019	Mbi kërkesën e shoqërisë “SA’GA-Mat” sh.p.k., për heqjen e licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike me nr. 254, seria T14P, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerve nr. 103, datë 7.11.2014, për një afat 30-vjeçar.....	17528
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 226, datë 20.12.2019	Mbi kërkesën e shoqërisë “ERS-08” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 63, datë 13.6.2008, i ndryshuar.....	17529
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 227, datë 20.12.2019	Mbi kërkesën e shoqërisë OSHEE sh.a. për miratimin e planit të investimeve për vitin 2019 dhe përditësimin e planit të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes për periudhën pesëvjeçare 2018–2022, të shoqërisë OSHEE sh.a.....	17531
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 228, datë 20.12.2019	Mbi kërkesën e OST sh.a., për miratimin e planit të investimeve për vitin 2019 dhe atë të përditësuar dhjetëvjeçar, 2015–2025, të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST sh.a.....	17533

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 229, datë 20.12.2019	Mbi miratimin e “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”	17536
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 230, datë 20.12.2019	Mbi miratimin e kontratës së lidhur ndërmjet shoqërive “Albpetrol” sh.a. dhe “Albgaz” sh.a., për shërbimin e transmetimit të gazit natyror, për një afat njëvjeçar, duke filluar nga data 1.1.2019–31.12.2019.....	17545
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 231, datë 20.12.2019	Mbi miratimin e “Kodit të rrjetit që harmonizon strukturat tarifore të transmetimit të gazit”	17548
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 232, datë 20.12.2019	Mbi miratimin e “Rregullores dhe të metodologjisë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike”	17570
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 233, datë 20.12.2019	Mbi miratimin e disa ndryshimeve në “Metodologjinë e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar.....	17576
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 234, datë 20.12.2019	Mbi miratimin e disa shtesave në “Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, i ndryshuar me vendimin nr. 177, datë 8.11.2016, të Bordit të ERE-s, si aneks 3, “Tarifat për lidhjet e reja me sistemin e shpërndarjes e vetëprodhuesve të energjisë elektrike nga dielli, me kapacitet total të instaluar deri në 500 kwp”, për përcaktimin dhe miratimin e tarifave për lidhjen e impianteve vetëprodhuese të energjisë elektrike nga dielli, me kapacitet total deri në 500 kw.....	17578
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 235, datë 20.12.2019	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Strategjisë për infrastrukturën kritike në sektorin e energjisë elektrike”	17580
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 236, datë 20.12.2019	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Kodit të rrjetit të transmetimit të gazit natyror” në Shqipëri.....	17581

**UDHËZIM****Nr. 9, datë 27.12.2019****PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË UDHËZIMIN NR. 682/4, DATË
1.4.2016, “PËR AKTIVITETIN E
AUTOSHKOLLAVE, PAJISJEN E
KANDIDATËVE ME LEJE DREJTIMI,
KUALIFIKIMIN E INSTRUKTORËVE
TË AUTOSHKOLLAVE DHE
SPECIALISTËVE TË DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME TË SHËRBIMEVE TË
TRANSPORTIT RRUGOR (DPSHTRR)”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, neneve 119, 120 dhe 121, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të neneve 310, 311 dhe 313, të vendimit nr. 153, datë 7.4.2000 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 682/4, datë 1.4.2016, bëhen ndryshimet dhe shtesat si vijon:

1. Fjalja e parë e paragrafit të parë, të nenit 8, të pjesës I, riformulohet si më poshtë:

“Me paraqitjen e dokumenteve nga autoshkolla në portalin unik të shërbimeve qeveritare *e-Albania*, DRSHTRR-ja bën verifikimin nëse autoshkolla plotëson kriteret teknike dhe profesionale për të ushtruar veprimtarinë sipas përcaktimeve të licencës.”.

2. Fjalja e parë e nenit 11, të pjesës I, riformulohet si më poshtë:

“Regjistrimi i personave të interesuar për t'u pajisur me leje drejtimi bëhet në portalin unik të shërbimeve qeveritare *e-Albania*.”

3. Pika 1 e nenit 12, të pjesës I, riformulohet si më poshtë:

“1. Të gjithë personat e interesuar, që nuk janë shtetas shqiptarë, mund të pajisen me leje drejtimi të mjetit, pasi të paraqesin dokumentet e përcaktuara në nenin 311, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000, të ndryshuar, në portalin unik të shërbimeve qeveritare *e-Albania*.”

4. Pas fjalisë së parë të nenit 26, të pjesës II, shtohet fjalja me përmbajtje si më poshtë:

“Për përfitimin e autorizimit, aplikanti duhet të kryejë aplikimin në portalin unik të shërbimeve qeveritare *e-Albania*.”

5. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

UDHËZIM**Nr. 10, datë 27.12.2019****PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN
NR. 4, DATË 28.6.2019, “PËR
DOKUMENTET PËR QARKULLIM DHE
REGJISTRIM TË MJETEVE RRUGORE”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 80, 92–102 dhe 220–224, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të neneve 237–252, 368 dhe 370, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000, “Rregullorja e zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 4, datë 28.6.2019, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Pika 1, e nenit 14, e kreut I, riformulohet si më poshtë:

“1. Në rastet e humbjes, vjedhjes, shkatërrimit ose dëmtimit të certifikatës së pronësisë së mjetit, aplikanti paraqet në portalin unik të shërbimeve qeveritare *e-Albania*:

a) aplikimin dhe shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) deklarin për humbjen e certifikatës së pronësisë, e shprehur në modelin e shkronjës “a”, të pikës 1 të këtij neni.”

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor për zbatimin e këtij udhëzimi.



Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

URDHËR
Nr. 446, datë 18.12.2019

**PËR MIRATIMIN E “RREGULLORES SË
BRENDSHME PËR ORGANIZIMIN
DHE FUNKSIONIMIN E DREJTORISË
SË PËRGJITHSHME DETARE”**

Në bazë të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, nenit 401, germa “b”, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; të ligjit nr. 9000/2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe nenit 5, të ligjit nr. 10109, datë 2.4.2009 “Për administratën detare të Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Rregullore së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme Detare”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Detare.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

**RREGULLORE E BRENDSHME
PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME DETARE**

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave lidhur me:

1. Organizimin dhe funksionimin e brendshëm të institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme Detare.

2. Të drejtat dhe detyrimet për të gjithë punonjësit e institucionit në lidhje me përmbushjen e detyrave të caktuara konform kuadrit ligjor në fuqi, strukturës organizative, urdhrave dhe rregulloreve, në bazë të së cilave funksionon dhe mbështet veprimtaria e Drejtorisë së Përgjithshme Detare.

**Neni 2
Misioni dhe veprimtaria**

1. Ndjekja dhe realizimi i veprimtarisë së transportit detar, në bazë të programit të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, të Planit Kombëtar të Transportit, masterplaneve dhe strategjisë së zhvillimit të Transportit; si edhe monitorimin e zhvillimit të porteve detare.

2. Organizimi i strukturave përbërëse të administratës detare në përputhje me legjislacionin në fuqi për fushën e detarisë, si edhe marrëveshjet e konventave ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.

**Neni 3
Strukturat përbërëse të institucionit të
Drejtorisë së Përgjithshme Detare**

1. Drejtor i përgjithshëm.
2. Kapitaneria e Porteve dhe Kontrolli Shtetëror Portual e cila ka në përbërjen e saj:
a) Kapiten i porteve dhe zv.drejtor i përgjithshëm;
b) Kapitanerinë e Portit Durrës;
c) Drejtues skafi;
d) Kapitanerinë e Portit Vlorë;
e) Kapitanerinë e Portit Sarandë;
f) Kapitanerinë e Portit Shëngjin;
g) Sektori i Kontrollit Shtetëror Portual;
h) Sektori i Koordinimit Ndërinstitucional (QNOD).

3. Drejtoria e (Autoriteti Shtetëror) Sigurisë Detare dhe Administrimit e Kontrollit Shtetëror të Flamurit e cila ka në përbërjen e saj:

a) Sektori i Sigurisë Detare në Anije dhe Porte;
b) Sektori i Regjistrimit të Mjeteve Lundruese dhe Detarëve;



c) Sektori i Administrimit dhe Kontrollit të Flamurit.

4. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse e cila ka në përbërjen e saj:

- a) Sektori Juridik, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve;
- b) Sektori i Financës;
- c) Magazinier;
- d) Shofer.

KREU II FUNKSIONIMI I STRUKTURAVE

Neni 4

Drejtori i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme Detare

Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme Detare, ka autoritetin dhe përgjegjësinë për marrjen e të gjitha vendimeve në fushën e detarisë, që nuk janë kompetencë ekskluzive e ministrit.

a) Drejton dhe bashkërendon veprimtarinë e strukturave përbërëse të administratës detare.

b) Përgjigjet për menaxhimin e sistemit buxhetor, si dhe për monitorimin e zbatimit të kontrollit të brendshëm financiar;

c) Është përgjegjës për përcaktimin e objektivave të drejtorisë, nëse ato nuk përcaktohen nga një nivel më i lartë hierarkik, për planifikimin e veprimtarisë së drejtorisë dhe realizimin e detyrave të saj, duke dhënë orientime dhe udhëzime, si dhe duke monitoruar veprimtarinë e njësive administrative dhe personelit brenda drejtorisë;

d) Ushtron kontroll për mbarëvajtjen e punës dhe kryerjen e detyrave mbi të gjitha strukturat përbërëse të administratës detare;

e) Përgjigjet për vendosjen dhe përmbushjen e qëllimeve dhe objektivave të drejtorisë, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve buxhetore, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe eficiencë.

f) Siguron hartimin e politikave, miraton dhe monitoron objektivat e drejtorisë, planet strategjike vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të planveprimeve për arritjen e objektivave si dhe përfaqëson institucionin në marrëdhënie me të tretë;

g) Miraton sistemet e menaxhimit të informacionit;

h) Miraton sistemin e rregullave e të procedurave për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësive publike;

i) Miraton struktura të përshtatshme organizative dhe vendosjen e linjave të raportimit, që mundësojnë kryerjen efektive të përgjegjësisë të tyre;

j) Rregullon funksionin e auditimit të brendshëm dhe garantimin e pavarësisë funksionale të tij;

k) Përcakton procedurat antikorupsion, bazuar në legjislacionin në fuqi;

l) Siguron, nëpërmjet akteve të brendshme administrative, zbatimin e rregullave për kontrollin e brendshëm;

m) Ngre grupet e ekspertëve për kryerjen e hetimeve për incidentet dhe aksidentet detare, si dhe miraton rekomandimet për parandalimin dhe shmangien e tyre.

Neni 5

Zv.drejtori i përgjithshëm dhe Kapiteni i Porteve

1. Zv.drejtori i përgjithshëm zëvendëson drejtorin e përgjithshëm sipas Kodit të Procedurave Administrative.

2. Kapiteni i porteve ushtron këto detyra:

a) Drejton, organizon dhe menaxhon të gjithë punën e kapitanerive të porteve, të Sektorit të QNOD-së dhe Sektorit të KSHP-së për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me respektimin e disiplinës portuale të trafikut detar, garantimin e sigurisë së mjeteve në porte dhe në rada, në zbatimin e ligjshmërisë detare;

b) Bashkërendon punën me drejtoritë e tjera të Drejtorisë së Përgjithshme Detare;

c) Jep asistencë në nxjerrjen e akteve ligjore në zbatim të Kodit Detar të Republikës së Shqipërisë që kanë lidhje me funksionin dhe detyrat e kapitanerive;

d) Propozon urdhra dhe udhëzime në varësi të situatave që krijohen, për përmirësimin e punës të kapitanerive, të Sektorit të QNOD-së dhe Sektorit të KSHP-së;

e) Në bazë të njoftimeve të marra nga ana e Shërbimit Hidrografik Shqiptar, njofton kapitaneritë e Porteve mbi ndryshimin e regjimit të lundrimit përgjatë ujërave territoriale të Republikës



së Shqipërisë me qëllim marrjen e masave për sigurimin e lundrimit;

f) Informon periodikisht drejtorin e përgjithshëm mbi problematikën e kapitanerive të porteve, të Sektorit të QNOD-së dhe Sektorit të KSHP-së;

g) Ndjek situatën lundrimore në të gjithë ujërat e brendshme të lundrueshme të Republikës së Shqipërisë;

h) Drejton Komisionin e Atestimit të Pilotëve që ushtrojnë aktivitet në portet e hapura të Republikës së Shqipërisë;

i) Ndjek problematikat që delegohen nga drejtori i përgjithshëm në lidhje me aktivitetin e kapitanerive të porteve Sektorit të QNOD-së dhe Sektorit të KSHP-së;

j) Dhe çdo detyrë të ngarkuar me urdhër.

Neni 6

Kapiteni i Portit

a) Organizon dhe ndjek aktivitetin e Kapitanerisë ku ai drejton;

b) Përcakton detyrat për personelin e Kapitanerisë sipas situatave të ndryshme që mund të krijohen në port e radë;

c) Propozon instruksionet përkatëse të shërbimit në Kapitaneri;

d) Ndjek zbatimin e detyrave të inspektorit të Kapitanerisë sipas rregulloreve të miratuara;

e) Kryen komunikimin ditor me Kapitenin e Porteve në lidhje me situatën në radë dhe në portë;

f) Bashkëpunon me organet e tjera portuale si Autoritetin Portual, Portet, Policinë Kufitare, Doganën, Shërbimin Sanitar, për zbatimin e ligjshmërisë detare në porte dhe në rada;

g) Merr pjesë në komisione të posaçme, komitetin e sigurisë së portit, në hetimin e incidenteve dhe aksidenteve të ndryshme detare që mund të ndodhin në porte, rada, detin e brendshëm dhe detin territorial të Republikës së Shqipërisë;

h) Legalizon ose refuzon protestat detare të paraqitura nga ana e kapitenëve të anijeve;

i) Programon punën mbi bazë mujore dhe vjetore dhe përgatit raportet e ndryshme për këtë program;

j) Ndjek problematikat që delegohen nga Kapiteni i Porteve që lidhen me aktivitetin e Kapitanerisë respektive;

k) Dhe çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me urdhër.

Neni 7

Inspektori i Kapitanerisë

a) Ndjek aktivitetin e Kapitanerisë lidhur me anijet që ndodhen në port dhe radë, si dhe në raste të veçanta sipas situatës së krijuar ndjek lundrimin e anijeve brenda ujërave territorialë të Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim me Kapitaneritë e tjera të vendit, njëkohësisht mban të informuar Kapitenin e Portit për të gjitha situatat detare në port, radë dhe det;

b) Ndjek manovrimin e anijeve gjatë hyrje-daljeve të anijeve nga porti dhe rada dhe njofton QNOD-në për çdo nisje / mbërritje;

c) Vrojton gjendjen e anijeve në port e radë, gjithashtu mban kontakte në radio me anijet dhe pilotët të cilët manovrojnë për t'u afruar në radën e portit apo që manovrojnë për t'u futur apo dalë nga porti;

d) Kryen formalitetet e nisjes dhe të mbërritjes së mjeteve lundruese duke kontrolluar të dokumentacionin e mjetit dhe detareve;

e) Në rast parashikimi të kushteve të këqija meteorologjike zbaton instruksionet e Kapitenit të Portit, si dhe bën njoftimin e të gjitha subjekteve që operojnë në port për marrjen e masave të sigurimit portual;

f) Në rast të ndonjë zjarri ose situatë emergjence në bordin e një mjeti lundrues në port dhe radë, jep sinjalin e alarmit dhe merr të gjitha masat duke aktivizuar dhe anije të tjera që ndodhen në afërsi për dhënie ndihmë anijes për fikjen e zjarrit, si dhe shpëtimin e njerëzve;

g) Kryen veprimtaritë e imbarkimit dhe zbarkimit të detarëve në dokumentacionin e detarëve në përputhje me listat e miratuara të ekuipazheve të anijes;

h) Autorizon pilotët për kryerjen e manovrimeve të anijeve për hyrje/dalje nga porti në përputhje me planin e dërguar nga dispeçeria e portit;

i) Në bazë të njoftimeve të marra nga Kapiteni i Portit, inspektori merr masa dhe bën njoftimet përkatëse për të gjithë subjektet që bëjnë nisjen nga kapitaneria (anijet pasagjere, tregtare, peshkatore, ato të turizmit etj.), për ndryshimin e situatës lundrimore përgjatë bregdetit shqiptar;



j) Kontrollon respektimin e masave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe kushteve të sigurta për jetën gjatë operacioneve të ngarkimit, shkarkimit ose operacioneve të përpunimit të ngarkesave;

k) Kontrollon vijën e ngarkesës së anijeve përpara se anijet të nisen nga porti në mënyrë që të jenë ngarkuar brenda limiteve të përcaktuara të vijës së ngarkesës;

l) Bën plotësimin e saktë dhe pa korrigjime të dokumentacionit të shërbimit të kapitanerisë, si: ditarin e shërbimit, regjistrat e hyrje-daljes së anijeve shqiptare apo të huaja dhe të gjithë dokumenteve të tjera;

m) Zbaton me përpikëri të gjitha rregulloret, udhëzimet dhe instruksionet në funksion të zbatimit të ligjshmërisë detare sipas lëndës së Kapitanerisë së Portit.

n) Me urdhër të drejtorit të përgjithshëm merr pjesë në komisione të ndryshme, si edhe hetimin e aksidenteve detarë;

o) Dhe çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me urdhër.

Neni 8

Inspektorit i Kontrollit të Ngarkesave të Rrezikshme në Kapitanerinë e Portit Durrësit

a) Mban lidhjen me Kapitenin e Portit, Autoritetin Portual, Operatorët Terminalë, IMOP-në në lidhje me monitorimin trajtimin dhe ruajtjen e mallrave të rrezikshme, përgatitjen e vlerësimit të rrezikut dhe planet e emergjencës;

b) Kontrollon kushtet për pranim, kufizimet sasiore, trajtimin, magazinimin dhe ndarjen e ngarkesave sipas Kodit IMDG;

c) Monitoron zbatimin e rregullave dhe akteve nënligjore për transportin, trajtimin e dhe ruajtjen e mallrave të rrezikshme Kodit IMDG;

d) Vlerëson situatën në porte në lidhje me trajtimin dhe ruajtjen e ngarkesave të rrezikshme periodikisht dhe ndryshimin / duke shtuar rregullat / aktet nënligjore sipas nevojës;

e) Raporton te Kapiteni i Portit, në lidhje me monitorimin trajtimin dhe ruajtjen e mallrave të rrezikshme Kodit IMDG;

f) Përgatitjen e vlerësimit të rrezikut dhe planet e emergjencës gjatë operacionit të ngarkim/shkarkimit në anije dhe bunkerazhi;

g) Dhe çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me urdhër.

Neni 9

Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit Shtetëror Portual

a) Drejton bashkërendon dhe kontrollon punën e Sektorit të Kontrollit Shtetëror Portual;

b) Programon plane për inspektimin e anijeve me flamur të huaj që prekin portet e hapura të Republikës së Shqipërisë;

c) Organizon grupet e inspektimit mbi bazën e vlerësimit të profilit të riskut që paraqesin anijet objekt inspektimi;

d) Përgatit plane vjetore inspektimi për anijet pasagjere që operojnë në linja të rregullta ndërkombëtare në portet e hapura të Republikës së Shqipërisë;

e) Analizon rezultatet e inspektimit në bashkëpunim me grupin e inspektimit, duke marrë masat e duhura sipas rasteve të paraqitura;

f) Monitoron të gjithë veprimtarinë e Sektorit të Inspektimit dhe Kontrollit Shtetëror Portual;

g) Informon kapitenin e porteve;

h) Dhe çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me urdhër.

Neni 10

Inspektor/ specialist i kontrollit shtetëror portual

1. Inspektorët dhe specialistët e Sektorit të Kontrollit Shtetëror Portual ushtrojnë kontroll në mjetet lundruese me flamur të huaj që prekin portet shqiptare, në drejtim të:

a) Zbatimit të ligjshmërisë për inspektimin e certifikimin e sigurisë teknike të mjeteve, që mbajnë flamur të huaj;

b) Parandalimit të shkeljeve të ligjit;

c) Zbulimit të shkeljeve;

d) Vënies para përgjegjësi së ligjit të shkelësve;

e) Mbrojtjes së mjedisit dhe rregullave shëndetësore;

f) Rregullsisë dhe kushteve të punës së ekuipazhit të anijes.

2. Inspektorët dhe specialistët e Sektorit të Kontrollit Shtetëror Portual mund të ushtrojnë kontroll në mjetet lundruese të instalimet larg bregut.



3. Mban evidenca të sakta për inspektimet dhe masat e marra.

4. Informon përgjegjësin e sektorit për masat e marra në rastet e shkeljes së ligjit për bashkërendimin e veprimeve me kapitenët e porteve.

Neni 11

Përgjegjës i Sektorit të Koordinimit Ndërinstitucional

a) Drejton bashkërendon dhe kontrollon punën për mbarëvajtjen e aktivitetit të Sektorit të QNOD-së;

b) Përcakton detyrat për personelin e Sektorit në raste të situatave të ndryshme që mund të krijohen;

c) Propozon instruksionet përkatëse të shërbimit në sektor;

d) Ndjek zbatimin e detyrave të inspektorit të sektorit sipas instruksioneve të miratuara;

e) Përgatit informacion mujor për kapitenin e porteve dhe kapitaneritë e porteve në lidhje me situatën detare;

f) Bashkëpunon me organet e tjera portuale, si: Rojën Bregdetare, Policinë Kufitare, Doganën, Shërbimin Sanitar dhe Inspektoratin e Peshkimit për zbatimin e ligjshmërisë detare;

g) Merr pjese në komisione të posaçme, në hetimin e incidenteve dhe aksidenteve të ndryshme detare që mund të ndodhin në porte, rada, detin e brendshëm dhe detin territorial të Republikës së Shqipërisë;

h) Programon punën mbi baza mujore dhe vjetore dhe përgatit raportet e ndryshme për këtë program;

i) Dhe çdo detyrë tjetër të ngarkuar me urdhër.

Neni 12

Inspektori/ Specialisti i Sektorit të Koordinimit Ndërinstitucional

a) Kryen monitorimin radionavigacional për gjendjen e anijeve në lundrim;

b) Bashkëpunon me të gjitha institucionet e tjera brenda sallës operationale në QNOD;

c) Në rast parashikimi të situatave të përkeqësuar detare njofton dhe bashkëpunon me kapitaneritë e porteve;

d) Në raste të marrjes së sinjaleve të fatkeqësisë nga radiostacionet bregdetare ose nga mjetet lundruese dhe avionët në fatkeqësi, njofton strukturat e operationeve SAR dhe bashkëvepron për dhënien e ndihmës së anijes në varësi të situatës së krijuar duke i dhënë prioritet shpëtimit të jetës së njerëzve;

e) Njofton në kohë dhe përgatit informacion ditor për kapitenin e porteve, sallën operationale të QNOD-së dhe kapitaneritë e porteve në lidhje me situatën detare;

f) Në rast të ndonjë emergjence në mjetet lundruese, jep sinjalin e alarmit dhe merr të gjitha masat duke aktivizuar të gjitha strukturat përkatëse për dhënie ndihme.

Neni 13

DREJTORIA E (AUTORITETI SHTETËROR) SIGURISË DETARE DHE ADMINISTRIMI TË KONTROLLIT SHTETËROR TË FLAMURIT

Drejtori i Drejtorisë (Autoriteti Shtetëror) Sigurisë Detare dhe Administrimi të Kontrollit Shtetëror të Flamurit

a) Drejton, organizon dhe menaxhon të gjithë punën e Drejtorisë për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë në anije dhe në porte, çështjet që lidhen me standardet e sigurisë teknike dhe sigurisë së jetës të mjeteve lundruese me flamur shqiptar, çështjet që lidhen me Regjistrimin e mjeteve lundruese me flamur shqiptar, si dhe me Regjistrin e Detarëve shqiptarë;

b) Bashkërendon punën me drejtoritë e tjera të Drejtorisë së Përgjithshme Detare;

c) Jep asistencë në nxjerrjen e akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e sigurisë detare dhe portuale, standardet ndërkombëtare detare të sigurisë së mjeteve lundruese me flamur shqiptar si dhe Regjistrimin e mjeteve lundruese me flamur shqiptar dhe të detarëve shqiptarë;

d) Bashkërendon punën e sektorëve për plotësimin e kuadrit ligjor detar në përputhje me zbatimin e Strategjisë së Zhvillimit dhe Integritetit të standardeve të kërkuara nga Konventat Ndërkombëtare Detare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë;

e) Organizon punën për kryerjen e studimeve për çështjet që mbulon Drejtoria;



f) Auditon aktivitetin e sektorëve, në zbatim të planit vjetor të punës të Drejtorisë dhe të objektivave të Drejtorisë së Përgjithshme Detare;

g) Ndjek të gjitha problemet që lindin në vazhdimësi për zgjidhje;

h) Informon drejtorin e përgjithshëm, si dhe jep propozime për përmirësimin e drejtimit, organizimit dhe efektivitetit të sektorëve që mbulon;

i) Vlerëson programet e trajnimit të sigurisë dhe eficiencën e zbatimit të tyre;

j) Ndjek të gjithë korespondencën shkresore që delegohen në kuadrin e Drejtorisë;

k) Dhe çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me urdhër.

Neni 14

Përgjegjësi i Sigurisë Detare në Anije dhe Porte

a) Organizon të gjithë punën e Sektorit të Autoritetit Shtetëror të Sigurisë në Anije dhe Porte për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë në anije dhe në porte;

b) Programon punën mbi bazë vjetore dhe mujore dhe organizon punën e Sektorit të Autoritetit Shtetëror të Sigurisë në Anije dhe Porte për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë në anije dhe në porte;

c) Bashkëpunon me sektorët e Drejtorisë, strukturat e tjera të Drejtorisë së Përgjithshme Detare dhe Kompanitë e Menaxhimit të anijeve me flamur shqiptar për monitorimin e sigurisë në anije dhe porte sipas kërkesave të Kodit ISPS;

d) Jep asistencë për përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore për sigurinë portuale në portet e hapura të Republikës së Shqipërisë dhe sigurinë e anijeve me flamur shqiptar;

e) Kryen vlerësimin e sigurisë në porte, kur kërkohet nga Autoriteti Shtetëror i Sigurisë Portuale.

f) Jep asistencë për përgatitjen dhe përmbajtjen e planit të sigurisë së anijes dhe planit të sigurisë së portit/objektit portual, kur kërkohet;

g) Organizon dhe kryen kontrole të efektshmërisë gjithë përfshirëse, specifike dhe të paprogramuara për sigurinë portuale, për secilin port/objekt portual;

h) Informon për çdo ditë eprorin direkt mbi situatën dhe gjendjen e sigurisë në anije dhe porte;

i) Ndjek të gjithë korespondencën që i delegohet në kuadrin e Sektorit;

j) Dhe çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me urdhër.

Neni 15

Specialisti i sigurisë detare

a) Jep asistencë dhe ndihmon në përgatitjen vlerësimit të sigurisë në anije dhe porte, si dhe në hartimin e planit të sigurisë së anijes dhe të porteve;

b) Merr pjesë në kryerjen e kontroleve të efektshmërisë gjithëpërfshirëse, specifike dhe të paprogramuara për sigurinë portuale, për secilin port/objekt portual;

c) Plotëson evidencat, raportet e vlerësimeve, formularëve dhe të çdo dokumenti tjetër që duhet dhe mund të plotësohen në funksion të administrimit të dokumentacionit në tërësi për sigurinë në anijet me flamur shqiptar dhe portet e hapura të Republikës së Shqipërisë;

d) Ndjek të gjithë korespondencën që i delegohet në kuadrin e Sektorit;

e) Dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me urdhër.

Neni 16

Përgjegjësi i Sektorit të Regjistrimit të Mjeteve Lundruese dhe Detarëve

a) Drejton, organizon dhe menaxhon të gjithë punën e Sektorit për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me regjistrimin e mjeteve lundruese me flamur shqiptar dhe të detarëve shqiptarë;

b) Bashkërendon punën me kapitanerite e porteve Vlorë, Shëngjin dhe Sarandë në lidhje me çështjet e regjistrimit të mjeteve lundruese dhe regjistrimin e detarëve të Republikës së Shqipërisë;

c) Bën propozime për përmirësimin e drejtimit, organizimit dhe efektivitetit të sektorit që mbulon;

d) Kontrollon miraton procedurën për regjistrimin përfundimtar provizor dhe çregjistrimin e anijeve të transportit, e anijeve të kultivimit ose shfrytëzimit të flotës e faunës dhe të burimeve të tjera detare (anijeve të peshkimit), anijeve në ndërtim, mjeteve lundruese me karakter kërkimor e shkencor, anijeve të shërbimeve portuale, anijeve me kontratë “Bareboat”, si edhe mjeteve të vogla lundrues, skafe, jahte, motor deti;



e) Lëshon certifikatën e regjistrimit, dëshminë e pronësisë dhe flamurit, dëshminë e aftësisë së mjeteve të vogla lundruese;

f) Kryen zgjatjen e afatit të dëshmisë së mjeteve të vogla lundruese;

g) Kontrollon dhe miraton praktikën për regjistrimin dhe pajisjen me pasaporta lundrimi për marinar të flotës tregtare, pasaporta lundrimi për peshkatarë si edhe zgjatjen e afatit të pasaportave të detarëve;

h) Kontrollon miraton praktikën dhe lëshon certifikatën e kompetencës në përputhje me Konventën e STCW-1978 e ndryshuar dhe zgjat afatin certifikatës së kompetencës;

i) Kontrollon miraton praktikën dhe lëshon dëshminë për regjistrimin dhe pajisjen me leje drejtimi për mjete të vogla lundruese;

j) Lëshon certifikatën e minimumit për anijet e transportit të mallrave;

k) Lëshon certifikatën në përputhje me Konventën Wreck Removal;

l) Lëshon certifikatën në përputhje me Konventën MLC;

m) Regjistron hipotekat, kontratat e kredisë dhe privilegjeve të tjera mbi mjetet lundruese;

o) Lëshon vërtetime mbi pronësinë e mjeteve dhe vërtetime për kualifikimin e detarëve në emër të Republikës së Shqipërisë;

n) Dhe çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me urdhër.

Neni 17

Inspektori i regjistrimit të mjeteve lundruese dhe detarëve

a) Pranon dhe plotëson praktikën për regjistrimin përfundimtar provizor dhe çeregjistrimin e anijeve të transportit, anijeve të kultivimit ose shfrytëzimit të flotës e faunës dhe të burimeve të tjera detare.(anijeve të peshkimit),.anijeve në ndërtim, mjeteve lundruese me karakter kërkimor e shkencor, anijeve të shërbimeve portuale, anijeve me kontratë “Bareboat”, si edhe mjeteve të vogla lundrues, skafe, jahte dhe motor deti;

b) Plotëson certifikatën e regjistrimit, dëshminë e pronësisë dhe flamurit, dëshminë e aftësisë së mjeteve të vogla lundruese, zgjatjen e afatit të dëshmisë së mjeteve të vogla lundruese;

c) Pranon dhe plotëson praktikën për regjistrimin dhe pajisjen me pasaporta lundrimi për marinar të flotës tregtare, pasaporta lundrimi për peshkatarë dhe zgjatjen e afatit të pasaportave të lundrimit të detarëve shqiptar;

d) Pranon dhe plotëson praktikën për lëshimin e certifikatës së kompetencës në përputhje me Konventën e STCW-1978 e ndryshuar dhe zgjatjen e afatit të certifikatës së kompetencës;

e) Pranon dhe plotëson praktikën për pajisjen me leje drejtimi për mjete të vogla lundruese;

f) Pranon dhe plotëson praktikën për zgjatjen e afatit të lejeve të drejtimit për mjetet e vogla lundruese;

g) Plotëson certifikatën e minimumit për anijet e transportit të mallrave;

h) Plotëson certifikatën në përputhje me Konventën MLC;

i) Plotëson certifikatën në përputhje me Konventën Wreck Removal;

j) Plotësojnë vërtetime mbi pronësinë e mjeteve dhe vërtetime për kualifikimin e detarëve në emër të Republikës së Shqipërisë;

k) Verifikon subjektet në drejtimin të pronësisë së mjeteve lundruese;

l) Dhe çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me urdhër;

Neni 18

Përgjegjësi i Sektori të Administrimit dhe Kontrollit të Flamurit

a) Programon punën mbi bazë vjetore dhe mujore për kryerjen e kontrolleve të inspektimit mbi standardet e sigurisë teknike për mjetet lundruese, që mbajnë flamurin shqiptar, në përputhje me kërkesat e vendosura nga legjislacioni kombëtar dhe ndërkombëtar;

b) Bashkëpunon me sektorët e Drejtorisë dhe strukturat e tjera të Drejtorisë së Përgjithshme Detare për kryerjen e kontrolleve të mjetet lundruese që lundrojnë në flamurin;

c) Jep asistencë në përgatitjen e projekteve ligjore dhe nënligjore për implementimin dhe zbatimin e konventave, kodeve, protokolleve dhe qarkoreve të ratifikuara me ligj nga Republika e Shqipërisë;

d) Jep asistencë në përgatitjen e kriterëve dhe procedurave për zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi të cilat janë përgjegjësi të



administrimit dhe kontrollit shtetëror të flamurit shqiptar;

e) Ndjek zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore të fuqi lidhur me plotësimin dhe implementimin e standardeve për sigurinë teknike dhe lundrimore, mjeteve dhe pajisjeve për sigurinë e jetës së njeriut në det, mbrojtjes së mjedisit detar nga ndotja në rada dhe porte, si dhe ujërat e brendshme ku kryhet aktivitet lundrimor;

f) Përgatit plane vjetore inspektimi për mjetet lundruese që operojnë në linja të rregullta ndërkombëtare në portet e hapura të Republikës së Shqipërisë;

g) Analizon rezultatet e inspektimit në bashkëpunim me grupin e inspektimit, duke marrë masat e duhura sipas rasteve të paraqitura;

h) Informon eprorin mbi aktivitetin e punës së sektorit;

i) Dhe çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me urdhër.

Neni 19

Inspektori i Kontrollit Shtetëror të Flamurit

a) Ndjek punën mbi bazën e programit vjetor dhe mujor për kryerjen e inspektimeve të mjetet lundruese me flamur shqiptar, përgatit raportin e inspektimit dhe informon eprorin për çdo rast;

b) Kontrollon mjetet lundruese mbi kompletimin me dokumentacionin e regjistrimit, të certifikimit të detarëve, të klasifikimit teknik, të menaxhimit të sigurt të mjetet lundruese në zbatim të kërkesave konventave dhe kodeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë;

c) Informon eprorin direkt mbi statusin e mjetet lundruese me flamur shqiptar për inspektimet e kryera nga KSHP-ja në portet e vendeve të tjera, si dhe inspektimet e kryera në portet shqiptare;

d) Ndjek zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore të Republikës së Shqipërisë nga subjektet publike dhe private për regjistrimin e mjeteve lundruese, certifikimin e detarëve, klasifikimin teknik, sigurinë e jetës në det dhe menaxhimin e sigurt të mjetet lundruese në zbatim të kërkesave të konventave dhe kodeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë;

e) Bashkëpunon me sektorët e Drejtorisë dhe strukturat e tjera të Drejtorisë së Përgjithshme Detare për kryerjen e kontrolleve të mjetet

lundruese që lundrojnë nën flamurin shqiptar në zbatim të konventave dhe kodeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë;

f) Bashkëpunon me strukturat e kompanive të menaxhimit të mjetet lundruese që lundrojnë nën flamurin e Republikës së Shqipërisë për kontrollet periodike dhe joperiodike mbi kontrollin e gjendjes së anijeve sipas kërkesave të konventave dhe kodeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë;

g) Dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me urdhër.

Neni 20

Inspektori (MARPOL)

a) Ndjek punën mbi bazë vjetore dhe mujore për zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore për mbrojtjen e mjedisit detar në porte dhe rada;

b) Të bashkëpunojë me sektorët e Drejtorisë dhe strukturat e tjera të Drejtorisë së Përgjithshme Detare për administrimin e dokumentacionin për zbatimin e Konventës Marpol me 6 anekset e saj që lidhen me parandalimin e ndotjes së mjedisit në porte dhe rada;

c) Ndjek zbatimin e kërkesave të akteve ligjore dhe nënligjore për mbrojtjen e mjedisit detar në porte dhe rada;

d) Vlerëson në mënyre periodike situatat në porte dhe radë në lidhje me mbrojtjen e mjedisit detar dhe rekomandon ndryshime përkatëse nëse nevojitet;

e) Mban lidhje të vazhdueshme me të gjitha institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare përgjegjëse dhe të përfshira në mbrojtjen e mjedisit detar;

f) Ndjek dhe zbaton udhëzimet dhe instruksione të ndryshme të eprorit që lidhen me garantimin dhe mbrojtjen e mjedisit detar;

g) Merr pjesë në inspektimet e mjetet lundruese me flamur shqiptar në bashkëpunim me inspektorin e kontrollit shtetëror të flamurit;

h) Informon eprorin direkt lidhur me situatën e mjedisit detar në porte dhe rada dhe inspektimet e kryera në porte dhe anije;

i) Dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me urdhër.



Neni 21
Specialisti

a) Zhvillon, në bashkëpunim me strukturat e tjera të Drejtorisë së Përgjithshme Detare dhe Ministrisë së Mjedisit, aktet nën ligjore dhe rregullat që lidhen me mbrojtjen e mjedisit detar në zonat portuale dhe jo vetëm;

b) Ndërvepron me kapitaneritë e porteve, portet, operatorët terminal, Ministrinë e Mjedisit, për sa i përket monitorimit të mbrojtjes së mjedisit në porte dhe rada;

c) Mban të gjithë dokumentacionin sipas Konventës së Marpolit të cilat lidhen me analizat e mostrave të marra nga anijet dhe facilitetet përpunuese në rast ndotje;

d) Bashkëpunon me organet kompetente për marrjen dhe analizimin e mostrave nga anijet, sipas parashikimeve të Konventës Marpol;

e) Dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me urdhër.

Neni 22
Specialisti i administrimit dhe kontrollit të flamurit

a) Ndjek, përditëson dhe informon strukturat e tjera të Drejtorisë mbi ndryshimet e legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar të ratifikuar me ligj;

b) Ndjek punën mbi bazë vjetore dhe mujore për nivelin e zbatimit të legjislacionin kombëtar detar në fuqi dhe të plotësimit të tij me akte nënligjore;

c) Bashkërendon punën me funksionet e tjera të sektorit;

d) Informon për kriteret dhe procedurat për zbatimin e akteve ligjore ndërkombëtare dhe kombëtare të cilat janë përgjegjësi të administrimit të flamurit;

e) Harton dhe mban *database*-t mbi konventat ndërkombëtare në fuqi, aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për funksionimin e strukturave të administratës detare;

f) Dhe çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me urdhër.

DREJTORIA E SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE

Neni 23
**Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve
Mbështetëse**

a) Ndjek dhe bashkërendon veprimtarinë për përmbushjen e procedurave dhe planifikimin e kërkesave buxhetore të DPD-së, si dhe ndjekjen raportimin sipas ligjit, sigurimin dhe zbatimin e buxhetit të miratuar, për realizimin e fondeve;

b) Garantimin para miratimit të shkresave/urdhrave me karakter financiar, lidhur me ligjshmërinë, rregullshmërinë dhe respektimin e parimeve të ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit;

c) Ndjek detyrat që lidhen me asistencë dhe këshillim ligjor për të gjithë drejtoritë, aktivitete dhe proceset gjyqësore;

d) Koordinon dhe ndjek punën për zbatimin e rregullave dhe dispozitave ligjore në menaxhimin e burimeve njerëzore;

e) Ndjek realizimin e veprimtarive financiare të DPD-së, si dhe hartimin e pasqyrave financiare vjetore. Rakordimin dhe përgatitjen e situacioneve progresive me degën e thesarit mbi shpenzimet dhe të ardhurat;

f) Ndjek kontabilizimin dhe likuidimin në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore;

g) Prokurimin e fondeve buxhetore, duke zbatuar me rigorozitet ligjin “Për prokurimin publik” dhe gjithë legjislacionin në fuqi;

h) Administrimi dhe inventarizimi i pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme të DPD-së;

i) Merr masa për funksionimin e mjeteve të komunikimit, si dhe përmbushjen e shërbimeve të tjera të nevojshme për veprimtarinë e strukturave të DPD-së;

j) Përgatit dokumentin përfundimtar të buxhetit, koordinimin e punës gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit të njësisë në rolin e sekretarit të ekipit të menaxhimit të programit;

k) Kryen llogaritjen e kostove të aktiviteteve të përcaktuara nga drejtuesit e programeve;

l) Identifikon dhe krijon regjistrin e riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë;



m) Respekton parimet e ligjshmërisë, menaxhimit të shëndoshë financiar dhe transparencës së fondeve publike në përputhje me ligjin për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë;

n) Dokumenton të gjitha transaksionet financiare dhe transaksionet e tjera dhe garanton gjurmën e auditit për proceset kryesore të njësisë.

Neni 24

Përgjegjës i Sektorit Juridik, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve

a) Organizon dhe mbikëqyr veprimtarinë e Sektorit Juridik, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve.

b) Siguron dhe identifikon informacionin për vendet vakante, lëvizjet paralele, si dhe të ngritjes në detyrë në organikë dhe ndjek plotësimin e tyre me personel në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike.

c) Siguron dhe evidenton zbatimin korrekt nga punonjësit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Kodin e Etikës dhe rregullat për konfidencialitetin e të dhënave personale.

d) Ndjek procesin e rekrutimit të stafit nëpërmjet evidentimit të nevojave të institucionit për burime njerëzore;

e) Administron regjistrin e personelit, dosjet teknike të punonjësve dhe librezat e punës të punonjësve;

f) Merr pjesë në procesin e planifikimit, në bashkëpunim me drejtuesit e sektorëve/drejtore;

g) Siguron menaxhimin e proceseve që lidhen me çështjet gjyqësore;

h) Asiston dhe bashkëpunon me eprorët direkt, drejtorët e drejtorive, për realizimin e vlerësimeve individuale, konfirmimin e nëpunësve, procedurave disiplinore, përshkrimet e punës për vendet vakante dhe shpalljen e tyre brenda afateve kohore të përcaktuara në ligj;

i) Kontrollon dokumentacionin për emërimin, transferimet, pezullimet, masat disiplinore;

j) Dhe çdo detyrë tjetër të ngarkuar me urdhër.

Neni 25

Specialist (jurist)

a) Zbaton detyrat e ngarkuara dhe informon eprorin mbi rezultatet e punëve të marra në ngarkim;

b) Merr pjesë në grupet e punës gjatë hartimit, rishikimit dhe ndryshimit të ligjit dhe akteve të tjera nënligjore;

c) Përfaqëson institucionin me autorizim/prokurë të drejtorit të DPD-së, në të gjitha shkallët e gjykimit;

d) Përgatit prapësime, ankime, rekurse në emër të institucionit sipas rastit;

e) Ndjek ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;

f) Merr pjesë ngritjen e Autoritetit Përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesit;

g) Merr pjesë në komisionet e prokurimeve të blerjeve me vlerë të vogël me urdhër të titullarit dhe në hartimin e kontratave duke zbatuar legjislacionin në fuqi;

h) Ndjek zhvillimin e kuadrit ligjor dhe informon drejtorin e përgjithshëm dhe drejtoritë respektive për të gjitha akte të reja ligjore dhe nënligjore të cilat kanë të bëjnë me sferën e veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme Detare;

i) Merr pjesë në komisione të ndryshme për hetimin e incidentet detare, si dhe në komisione të tjera;

j) Bën interpretimin ligjor të çështjeve të ndryshme që lindin nga puna dhe aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme Detare, si dhe nga përplasjet e ndryshme institucionale;

k) Dhe çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me urdhër.

Neni 26

Specialisti

a) Zbaton detyrat e ngarkuara dhe informon eprorin mbi rezultatet e punëve të marra në ngarkim;

b) Mban lidhje me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë;

c) Përgatit materiale dhe informacione sa herë që i kërkohen nga Ministria, DAP-i, Komisioneri i Shërbimit Civil etj.;



d) Administron, evidenton të dhënat personale të punonjësve në Regjistrin Qendror të Personelit, si dhe bën azhurnimin e tij me ndryshimet sipas strukturës së miratuar;

e) Administron, sistemon dhe azhurnon dosjen e personelit sipas VKM-së përkatëse me procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë;

f) Identifikimin e vendeve vakante në organikë dhe ndjek plotësimin e tyre me personel, përgatit, përditëson e *database*-n për përpunimin e të dhënave të ndryshme;

g) Në bashkëpunim me DAP-in, siguron dhe identifikon informacion për vendet vakante, lëvizjet paralele, si dhe të ngritjes në detyrë në organikë dhe ndjek plotësimin e tyre me personel;

h) Plotëson dosjen e punonjësve, përditëson dosjet personale të punonjësve;

k) Plotëson librezat e punës dhe pasqyron të gjitha ndryshimet e pozicioneve;

i) Paraqet te specialisti i financës të dhënat për vjetërsinë në punë të punonjësve për pagesën e tyre konform rregullave, raportet mjekësore dhe llogarit dhe ndjek lejet vjetore për çdo punonjës;

j) Përgatit urdhrat për fillimin e marrëdhënieve financiare në zbatim të urdhrave të emërimit të lëshuara nga Departamenti i Administratës Publike;

k) Përgatit vërtetimet mbi të ardhurat nga paga dhe plotësimi i vërtetimeve për pension pleqërie;

l) Plotëson në formë elektronike të rubrikave me të dhënat që përmban deklarata “Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna;

m) Dhe çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me urdhër.

Neni 27 Magaznier

a) Administron dhe dokumenton lëvizjen e vlerave materiale dhe harton dokumentacionin përkatës;

b) Mban përgjegjësi direkte për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e materialeve të magazinës qendrore të Drejtorisë së Përgjithshme Detare;

c) Mban në regjistër të veçantë të gjithë inventarët personalë të nëpunësve të Drejtorisë së Përgjithshme Detare;

d) Shoqëron materialet që futen në magazinën e Drejtorisë së Përgjithshme Detare nëpërmjet faturave të shitjes apo aktdhurimi me fletëhyrje në magazinë;

e) Në bazë të urdhër veprimit të firmosur nga drejtori i Shërbimeve Mbështetëse dhe të miratuar nga drejtori i përgjithshëm, bën fletëdaljen e materialeve nga magazina qendrore të firmosur dhe nga marrësi materialeve;

f) Furnizon me materiale dhe kontrollon materialet në inventarin e kapitanerive të porteve;

g) Në fund të çdo muaji dorëzon dokumentacionin e hyrje daljeve të magazinës në sektorin e financës;

h) Në fillim të çdo muaji bën kuadrumin e materialeve të magazinës me sektorin e financës;

i) Mban në inventar personal materialet e ndryshme të administratës dhe asetet në ndërtesën që nuk janë në inventar të nëpunësve të tjerë;

j) Kryen detyra të ndryshme lidhur me mirëmbajtjen e godinës dhe territorit, si dhe kontrollin e përditshëm të furnizimit me energji elektrike dhe ujë të godinës,

k) Mirëmban dhe furnizon gjeneratorin dhe ndjek ecurinë e tij gjatë punës;

l) Evidenton në kartelat e magazinës fletëhyrjet dhe fletëdaljet dhe bën rakordimin e tyre me kartelat e llogarisë;

m) Ndan sipas planit dhe normativave të miratuara karburantin e skafeve dhe ndjek procedurën e furnizimit të skafeve të DPD-së dhe çdo muaj përpilon pasqyrën përmbledhëse të shpërndarjes;

n) Evidenton mallrat me qarkullim të ngadalshëm dhe informon në lidhje me to;

o) Për mallrat me përdorim të gjerë, informon vazhdimisht mbi gjendjen e tyre në magazinë;

p) Përgjigjet për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe sistemin e vlerave materiale që ka në ngarkim;

q) Në bashkëpunim me Sektorin e Financës dhe Shërbimeve, nxjerr dhe evidenton për materialet e konsumit shpenzimet e tyre faktike;

r) Dhe çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me urdhër.

Neni 28 Shoferi i institucionit

a) Përgjigjet për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e automjetit të marrë në ngarkim;



b) Zbaton me përpikëri kërkesat e parashikuara në urdhrat e brendshëm të drejtorit, për përdorimin dhe lëvizjen e automjetit gjatë dhe jashtë orarit zyrtar të punës;

c) Përgjigjet për gatishmërinë teknike të automjetit, zbatimin e grafikut të shërbimeve, plotësimin e fletudhëtimeve çdo ditë.

Neni 29

Përgjegjësi i Financës

a) Përgjigjet për realizimin e planit të buxhetit dhe kryen rakordime periodike mujore me Degën e Thesarit dhe zbaton planin ekonomik të Drejtorisë së Përgjithshme Detare;

b) Përgjigjet dhe jep llogari për veprimtarinë e sektorit që mbulon para eprorit direkt;

c) Harton në bashkëpunim me eprorit direkt planin mujor të punës;

d) Evidenton dhe kontrollon shpenzimet buxhetore sipas zërave. Nxjerr të dhënat mujore dhe 4-mujore mbi bazën e dokumenteve financiarë të shpenzimeve, si dhe t'i raportojë ato në institucionin qendror;

e) Kontrollon për pasqyrimin saktë të evidencës kontabile, në përputhje me planin kontabile dhe ligjin për kontabilitetin;

f) Kontrollon miradministrimin e pasurisë së institucionit për kryerjen në afat të inventarizimit të vlerave monetare e materiale;

g) Kryen rregullisht rakordimet e të dhënave me degën e thesarit për përdorimin e buxhetit.

h) Kryen kontrollin periodik të gjendjes së arkës;

i) Kontrollon dhe mbyll brenda afateve shpenzimet për udhëtim e dieta të punonjësve;

j) Kontrollon shpenzimet ditore për rastet e prokurimeve, si dhe të gjitha llojet e shpenzimeve të bëra nëpërmjet arkës dhe bankës;

k) Drejton dhe organizon hartimin për projektbuxhetit afatmesëm (PBA) në bashkëpunim me departamentet dhe drejtoritë e institucionit, duke përcaktuar nevojat sipas klasifikimit buxhetor;

l) Ndjek dhe dërgon për ekzekutim në thesar dhe bankë çdo pagesë të institucionit;

m) Nxjerr bilancin vjetor kontabile për aktivitetin financiar të institucionit;

n) Përgjigjet për administrimin e fondeve për blerjet dhe investimet, duke zbatuar procedurat ligjore;

o) Dhe çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me urdhër.

Neni 30

Specialist (buxhet/finance)

a) Kontabilizon faturat e taksës portuale dhe rakordon me agjencitë;

b) Kontabilizon veprimet e bankës, arkës në valutë dhe thesarit;

c) Përgjigjet për pasqyrimin saktë të evidencës kontabile, në përputhje me planin kontabile dhe ligjin për kontabilitetin;

d) Përgatit situacionin e shpenzimeve dhe të ardhurave;

e) Kontabilizon faturat e “klientë për shërbime”/kontabilizimi i arkës/kontabilizimi i pagave/ kontabilizimi i faturave të furnitorëve;

f) Mbajtja e planit buxhetor;

g) Merr pjese në përgatitjen e projektbuxhetit financiar;

h) Rakordon bankë-thesar, për të ardhurat dhe shpenzimet;

i) Merr pjesë në hartimin e bilancit vjetor;

j) Përgatit urdhëreshpenzimet për likuidimin e faturave të shërbimeve nga të tretët, si dhe të detyrimeve kontraktuale që ka DPD-ja;

k) Dhe çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me urdhër.

Neni 31

Specialist për shërbimet

a) Përgatit listëpagesat dhe borderotë e punonjësve, sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat;

b) Plotëson librin e pagave dhe librezat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve;

c) Regjistron dhe azhuron dokumentacionin e magazinës, siguron në çdo kohë gjendjen kontabile të mallrave e materialeve të magazinës;

d) Mban arkën;

e) Mban llogaritë materiale dhe mjetet kryesore (fletëhyrje, fletëdalje magazine, kartelat e mjeteve kryesore) kartelat e konsumit të karburantit, gomave;

f) Mban inventarët ekonomikë dhe përgjigjet për miradministrimin e pasurisë së institucionit për



kryerjen në afat të inventarizimit të vlerave monetare e materiale;

g) Përpilon dhe dërgon në afat evidencat tremujore statistikore sipas formularëve përkatës;

h) Përgatit borderotë e pagave dhe dietat dhe raportin *on-line* çdo muaj pagat dhe sigurimet në degën e tatimeve;

i) Llogarit dhe mban normat e amortizimit të aktiveve të institucionit;

j) Ndjek normativën e uniformave për punonjësit;

k) Dhe çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me urdhër.

KREU III AKTET ADMINISTRATIVE, HARTIMI DHE QARKULLIMI

Neni 32

Trajtimi i dokumenteve administrative dhe siglimi

a) Dokumentet hyrëse regjistrohen në regjistrin e korrespondencës nga specialisti i protokollit i cili bën shënimin e numrit të protokollit dhe datës së marrjes;

b) Dokumentet i përcillen drejtorit të përgjithshëm me kartelën shoqëruese dhe sipas përkatësisë shpërndahen brenda 24 orëve në strukturat që kanë lidhje me problematikën e tij, kundrejt firmës. Kur në dokumentet hyrëse specialisti konstaton mungesa, mbahet procesverbal dhe njoftohet subjekti që e ka dërguar;

c) Brenda afatit të përcaktuar në kartelë materiali pasi është siglur nga përpiluesi, përgjegjësi i sektorit, drejtori i drejtorisë, dorëzohet në protokoll;

d) Ekzemplari i dokumentit që mbahet në protokoll dhe trajtohet nga drejtori i përgjithshëm, siglohet nga përpiluesi, përgjegjësi i sektorit dhe drejtori i drejtorisë sipas rastit.

Neni 33

Elementet e kartelës shoqëruese të dokumenteve

Kartela përmban:

a) dërguesin, ku specifikohet emërtesa e plotë e institucionit prej nga vjen materiali duke shënuar

numrin e protokollit dhe datën e daljes nga ky institucion;

b) marrësin, ku specifikohet emërtesa DPD-së, duke shënuar numrin e protokollit dhe datën e hyrjes në këtë institucion;

c) rubrikën “përmbajtja”, në të cilën përshkruhet në mënyrë koncize objekti i materialit;

d) rubrikën “shënimi”, në të cilën sipas hierarkisë institucionale bëhen shënime të ndryshme lidhur me trajtimin e praktikës;

e) rubrikën në vijim, në të cilën përcaktohet emri mbiemri i personit të ngarkuar për trajtimin e materialit si dhe data e daljes së materialit nga drejtoritë;

f) rubrikën afati, në të cilën trajtohen afatet brenda të cilave duhet të trajtohen materialet.

Afatet sipas prioritetit të shkresave, janë:

a) afati normal, nënkupton afatin prej 10 ditë pune, i llogaritur që nga data e shpërndarjes nga drejtori i përgjithshëm;

b) afati prej 5 ditë pune, është afat prioritar dhe nënkupton 5 ditë pune i llogaritur që nga data e shpërndarjes nga drejtori i përgjithshëm;

c) afati “urgjent”, nënkupton trajtimin e materialit brenda ditës, ose në raste të veçanta shoqëruar me shënimin përkatës brenda një afati tjetër kohor.

Rubrikën “marrë në dorëzim”, në të cilën evidentohet emri, mbiemri i drejtorit të drejtorisë, dhe për raste të veçanta të personit direkt përgjegjës për trajtimin e materialit, duke specifikuar dhe datën kur materiali është marrë në dorëzim, kundrejt firmës nga ky i fundit.

Tri rubrikat në vijim, me shënimin “dorëzuar për trajtim”, në të cilat evidentohet respektivisht emri, mbiemri i personit i cili ngarkohet për trajtimin e materialit, sipas shkallës së hierarkisë kundrejt firmës dhe duke specifikuar datën nga dorëzuesi. Në shënimin “dorëzuar eprorit porosites”, evidentohet emri mbiemri i eprorit porosites, kundrejt firmës së personit të ngarkuar me përgatitjen e materialit duke specifikuar dhe datën e dorëzimit.

Rubrikën e fundit, në të cilën evidentohet data kur materiali i nënshkruar nga drejtori i përgjithshëm i dorëzohet specialistit të protokollit.



Neni 34

**Dokumentet administrative që nuk
evidentohen dhe nuk dorëzohen në
Arkiv-Protokoll**

a) Nuk evidentohen dhe nuk dorëzohen në Protokollin, dokumentet me karakter të thjeshtë si për lëvizje automjetesh, dokumente masive të llogarisë, magazinës, fatura mandat pagesa, fletë hyrje-dalje, fletë udhëtimesh dhe dokumente të tjera me natyrë të tillë;

b) Këto dokumente ruhen në sektorët përkatës të Drejtorisë dhe mbasi humbasin vlerën operative të ruajtjes nxirren për asgjësim sipas rregullave në fuqi nga vetë sektorët.

KREU IV

**MARRËDHËNIET NDËRMJET
STRUKTURAVE DHE ETIKA NË PUNË**

Neni 35

Marrëdhëniet ndërmjet strukturave

a) Struktura e DPD-së përcakton shkallën e hierarkisë dhe të përgjegjësisë së funksioneve në marrëdhënie me njëri-tjetrin.

b) Marrëdhëniet ndërmjet strukturave paralele janë marrëdhënie bashkëpunimi. Gjatë ushtrimit të detyrës vartësit duhet të zbatojnë dhe t'i raportojnë me përgjegjësi për detyrat e ngarkuara eprorit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

c) Në rastet kur e njëjta çështje është caktuar të shqyrtohet nga dy struktura paralele, është eprori direkt, më i lartë, i të dyja strukturave përgjegjës për koordinimin dhe zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

Neni 36

Përditësimi i faqes së internetit

a) Të gjitha strukturat e institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme Detare, sipas fushave dhe problematikave që mbulojnë, kanë përgjegjësinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në funksionimin, mirëmbajtjen dhe rifreskimin në mënyrë të vazhdueshme të faqes zyrtare të institucionit, nëpërmjet ofrimit të informacioneve të ndryshme në shërbim të publikut.

Neni 37

**Orari i punës dhe qëndrimi ndaj kohës së
punës**

a) Orari zyrtar për Administratën e Drejtorisë së Përgjithshme Detare është ai që përcaktohet sipas rregullave në fuqi për administratën publike nga e hëna në të enjte 08.00–16.30 dhe ditën e premte 08.00–14.00. Ky orar zgjatet në mënyrën e parashikuar në ligj sipas nevojave të institucionit. Për raste emergjente, fatkeqësive natyrore, incidenteve detare nëpunësit sipas funksionit duhet të paraqiten në detyrë;

b) Për rastet kur ka nëpunës që në mënyrë të përsëritur dhe të pajustificuar nuk zbatojnë orarin zyrtar të punës të fillojë procedimi disiplinor në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi;

c) Gjatë orarit zyrtar nëpunësi është i detyruar ta shfrytëzojë kohën vetëm për qëllime pune dhe detyrat e tij funksionale. Gjatë orarit zyrtar të punës nëpunësi mund të largohet për arsye pune, shëndetësore ose arsye të tjera të justifikueshme, me miratim/leje të eprorit direkt;

d) Në rast se nëpunësi ka raport mjekësor që justifikon mosardhjen në punë, duhet të lajmërojë eprorin direkt, brenda ditës në të cilën nuk do të paraqitet në institucion;

e) Raporti mjekësor duhet të depozitohet në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse/Sektori Juridik Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve brenda 3 ditësh, duke filluar nga dita në të cilën nëpunësi nuk është paraqitur në institucion;

f) Listëprezenca për çdo punonjës, përgatitet, dhe depozitohet pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore nga përgjegjësi i sektorit dhe miratohet nga drejtori përkatës;

g) Përgjegjësit e sektorëve, hartojnë planet mujore dhe vjetore të punës dhe i dorëzojnë drejtorit përkatës i cili ja përcjell Drejtorit të Përgjithshëm.

Neni 38

Parime të përgjithshme të etikës

a) Nëpunësit gjatë kryerjes së detyrave funksionale duhet të respektojnë parimet e përgjithshme të etikës sipas ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;



b) Nëpunësit duhet të ruajë konfidencialitetin që buron nga ligji në lidhje me informacionin dhe materialin që njihet dhe merr dijeni gjatë kryerjes së detyrës. Ky konfidencialitet nuk është i kufizuar në kohë;

c) Në kryerjen e detyrave duhet të jetë i ndershëm, i paanshëm, efikas, duke pasur parasysh vetëm interesin publik;

d) Të jetë i sjellshëm në marrëdhënie me qytetarët që u shërben dhe me eprorët, kolegët e vartësit e tij;

e) Të sigurojnë për publikun e gjerë, palët e interesuara dhe institucionet publike, informacionin e kërkuar, me përjashtim të rasteve kur ky informacion është sekret shtetëror, konfidencial ose për përdorim të brendshëm në përputhje me ligjet dhe aktet e tjera nënligjore;

f) Të mos kërkojnë apo pranojnë asnjë përfitim moral apo material, për kryerjen e detyrave;

g) Të mos kryejnë punë apo veprimtari të cilat paraqesin konflikt interesash me detyrën e tyre zyrtare ose pengojnë përmbushjen e saj;

h) Ndalohet pirja e duhanit në mjediset e punës. Këto mjedise pajisen me shenjën dalluese që identifikon këtë ndalesë;

i) Veshja duhet të jetë në përputhje me etikën zyrtare të qëndrimit në administratën shtetërore;

j) Logoja e institucionit të jetë sipas shtojcës 1;

k) Inspektorët/specialist të KSHP-së, KSHF-së gjatë kryerjes së inspektimeve në bord të mjeteve lundruese duhet të kenë kartë identifikimi dhe uniformë të posaçme të miratuar sipas karakteristikave në shtojcën 2;

l) Kapitenët e Porteve, Inspektorët e Kapitanerisë së Porteve dhe Inspektorët/Specialistët e QNOD-së gjatë orarit të punës duhet të jenë të veshur me uniformën përkatëse, ndërsa në festat ceremoniale duhet të veshin uniformën ceremoniale;

m) Karakteristikat e veshjes dhe shenjat dalluese të kapitenëve, inspektorëve të kapitanerive, përgjegjësve të sektorëve dhe inspektorët/specialist të KSHP-së, KSHF-së dhe QNOD-se janë të përshkruara në shtojcën nr. 2;

n) Nëpunësit të mbajnë përgjegjësi të plotë për ligjshmërinë e veprimeve të tyre gjatë kryerjes së detyrës dhe kur nuk janë të bindur për ligjshmërinë e urdhrave dhe vendimeve që zbatojnë, duhet të informojnë menjëherë organet ose nivelet urdhërdhënëse, si dhe organet ose nivelet eprorë të këtyre të fundit. Nëpunësi nuk është i detyruar të zbatojë një urdhër të paligjshëm.

KREU V DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 39 Njohja me rregulloren

a) Të gjithë punonjësit e DPD-së duhet të njihen individualisht me këtë rregullore dhe nëse e shohin të nevojshme të kërkojnë sqarime dhe interpretime për këtë të fundit, pranë Sektorit Juridik, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve;

b) Kriteret dhe përmbajtja e kësaj rregulloreje janë të detyrueshme për zbatim nga të gjithë punonjësit e DPD-së;

c) Pranimi në punë nënkupton njohjen dhe pranimin e kërkesave të kësaj rregulloreje;

d) Drejtori i Përgjithshëm nxjerr urdhra për zbatimin e kësaj rregulloreje;

e) Çdo punonjës pajiset me një kopje të rregullores së brendshme.

Neni 40 Sanksione

a) Mosrepektimi i rregullores përbën shkak për procedim disiplinor për çdo punonjës, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi (kur nuk përbën veprë penale). Në sa më sipër, shkelja e rregullores, do të sjellë vendosjen e sanksioneve administrative në bazë të ligjit nr. 152/2013 të “Nëpunësit civil” i ndryshuar, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi;

b) Mosnjohja e rregullores, nuk e çliron punonjësin nga përgjegjësia dhe sanksionet e lartpërmendura.

Shtojcë nr. 1

LOGO e INSTITUCIONIT



SHTOJCË NR. 2

Uniformat verore 1 maj deri më 30 tetor

Uniformat dimërore 1 nëntor deri më 30 prill.

- Shenjat dalluese në veshje

Shenjat dalluese në veshje të Kapitenit të Porteve nr. 3

Shenjat dalluese në veshje të Kapitenit të Portit, Përgjegjës sektori të QNOD-së, përgjegjës sektori të KSHP-së, përgjegjës sektori të KSHF-së nr. 2

Shenjat dalluese në veshje të inspektorit të Kapitanerisë së Portit, inspektorët e KSHP-së dhe KSHF-së dhe inspektorët e QNOD-së nr. 1

.....

1.....

2.....

3



- Kapela

Kapela e Kapitenit të Porteve



2. Kapela e Kapitenit të Portit. Përgjegjësit të sektori të QNOD-së



3. Kapela e inspektorëve të Kapitanerisë së Portit dhe sektorit të QNOD-së



Kopsat e kostumit ceremonial



Kostumi ceremonial

1. Kostum ceremonial blu i errët



2. Kostum ceremonial i bardhë



KARAKTERISTIKAT PËR UNIFORMË PUNE PËR SEKTORËT E KSHP-së DHE KSHF-së

I. Pantallona Pune

- Material - dok trikoton me përzierje 65% poliestër

- Ngjyra gri e errët
- Me xhepa të përparme dhe anësore
- Rrip pantallonash ngjyra gri

Xhakëtë pune

- Material - dok trikoton me përzierje 65% poliestër

- Ngjyra - gri e errët
- Me mëngë të gjata.
- Me zinxhir
- Me shenjë dalluese:

- Mbrapa me shkrim PSC ALBANIA për sektorin e KSHP-së dhe (KSHF) për sektorin e KSHF-së

- Mënga krahu i majte stema e flamurit shqiptar
- Mënga krahu i djathë stema e Drejtorisë së

Përgjithshme Detare

II. Kominoshe pune

- Ngjyrë gri e errët
- Me shenjë dalluese:
- Mbrapa me shkrim PSC ALBANIA për sektorin e KSHP-së dhe (KSHF) për sektorin e

KSHF-së

- Mënga krahu i majte stema e flamurit shqiptar
- Mënga krahu i djathë stema e Drejtorisë së

Përgjithshme Detare

III. Këpucë me gjysmëqafë (*safety shoes*)

- Ngjyra e zezë
- Materiali lëkurë
- Me astar meshini
- Taban soletë, gomë e presuar me shollë
- Me mbrojtëse metalike në pjesën e përparme
- Me lidhëse

IV. Bluza dimërore pune

- Material pambuk
- Ngjyra gri e errët
- Me mëngë të gjata
- Me jakë të hapur me dy komça
- Me shenjë dalluese PSC ALBANIA në krahun e majtë.

V. Bluza verore pune

- Material pambuk
- Ngjyra gri e errët
- Me mëngë të shkurtra
- Me jakë të hapur me dy komça
- Me shenjë dalluese PSC ALBANIA për sektorin e KSHP-së dhe (KSHF) për sektorin e KSHF-së

- Në krahun e majtë.

VI. Kokore plastike (*helmetë*)

- Ngjyra e bardhë
- Me shenjë dalluese PSC për sektorin e KSHP-së dhe (KSHF) për sektorin e KSHF-së

VI. Të tjera

- Doreza pune
- Kufje antizhurmë



- Jelek flourishent (ngjyra e kuqe me shkrim mbrapa PSC ALBANIA për sektorin e KSHP-së dhe (KSHP) për sektorin e KSHP-së

- Çekiç metalik

- Kapelë dok, ngjyra gri e errët, me strehë, me shenjë dalluese ballore PSC për sektorin e KSHP-së dhe (KSHP) për sektorin e KSHP-së

- Mushama kundër shiut-ngjyra e kuqe

- Elektrik dore me bateri

- Çantë për mbajtje dokumentesh- materiali lëkurë

URDHËR

Nr. 593, datë 31.12.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 344, DATË 19.8.2013, “PËR NGRITJEN E NJËSISË SË SHËRBIMIT PSIKOSOCIAL”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 20, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të vendimit nr. 194, datë 22.4.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës së pagës së punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 344, datë 19.8.2013, “Për ngritjen e njësisë së shërbimit psikosocial”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 3 bëhet si më poshtë:

“3. Numri i psikologëve/i punonjësve socialë, në njësinë e shërbimit psikosocial në çdo DRAP, përfshihet brenda numrit të punonjësve buxhetorë të miratuar.”.

2. Pika 4 shfuqizohet.

3. Pika 5 bëhet si më poshtë:

“5. Numri i psikologëve/i punonjësve socialë, në njësinë e shërbimit psikosocial në çdo DRAP, përcaktohet si vijon:

a) një psikolog/punonjës social për çdo shkollë me 500–700 nxënës;

b) dy psikologë/punonjës social për çdo shkollë me mbi 700 nxënës;

c) një psikolog/punonjës social për çdo shkollë që ka të paktën 10 nxënës me aftësi të kufizuara të përcaktuar me raport të Komisionit Mjekoligjor;

d) një psikolog/punonjës social për çdo shkollë të arsimit special;

e) në rastet kur shkollat janë me numër të vogël nxënësish, një psikolog/punonjës social do të mbulojë disa shkolla dhe numri i nxënësve do të jetë nga 500–700.”.

4. Pika 7 bëhet si më poshtë:

5. “7. Titullari i DRAP-së emëron psikologun/punonjës social në njësinë e shërbimit psikosocial me konkurrim të hapur, sipas procedurave të emërimit të specialistëve të DRAP-së dhe nevojave specifike të shkollave.”.

6. Pika 10 bëhet si më poshtë:

“10. Një psikolog/punonjës social mund të mbulojë një ose disa shkolla në vartësi të numrit të nxënësve të këtyre institucioneve arsimore parauniversitare.”.

7. Në çdo pikë të urdhrit nr. 344, datë 19.8.2013, “Për ngritjen e njësisë së shërbimit psikosocial”, ku citohet “Drejtoritë Arsimore Rajonale (DAR)/Zyra Arsimore Rajonale (ZA)” të zëvendësohet me “Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP)”.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini



VENDIM

Nr. 213, datë 20.12.2019

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
PËR BASHKËPUNIM MIDIS ENTIT
RREGULLATOR TË ENERGJISË TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (ERE)
DHE ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR
ENERGJINË (ZRRE) TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 18 dhe nenit 19, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.12.2019, pasi shqyrtoi relacionin nr. 116/2 prot., datë 12.12.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Çështjeve Ligjore, në lidhje me miratimin e Marrëveshjes për Bashkëpunim midis Entit Rregullator të Energjisë (ERE) të Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Rregullatorit për Energjinë (ZRRE) të Republikës së Kosovës,

konstatoi se:

- bashkëpunimi, midis Entit Rregullator të Energjisë, të Republikës së Shqipërisë (ERE) dhe Zyrës së Rregullatorit për Energjinë, të Republikës së Kosovës (ZRRE), krijon avantazhe dypalëshe në funksion të ndërveprimit mes entiteteve, me qëllim përmbushjen e misionit të tyre;

- palët shohin një mundësi për të përqendruar përpjekjet e tyre të përbashkëta, në zhvillimin e një kornize të qëndrueshme rregullatore, në sektorët e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, si në nivel rajonal, ashtu dhe në atë dypalësh;

- nënshkrimi i Marrëveshjes për Bashkëpunim, do të shërbejë si një kornizë për zhvillimin e bashkëpunimit afatgjatë në kuadër të *Western Balkan 6* për shkëmbimin e informacionit mbi bazën e barazisë, reciprocitetit dhe përfitimeve të ndërsjella.

VENDOSI:

1. Të miratojë Marrëveshjen për Bashkëpunim midis Entit Rregullator të Energjisë (ERE), të Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Rregullatorit për Energjinë (ZRRE), të Republikës së Kosovës. (Marrëveshja përkatëse bashkëlidhur këtij vendimi).

Faqe | 17502

2. Kryetari i ERE-s nënshkruan këtë Marrëveshje për Bashkëpunim.

Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Entit Rregullator të Energjisë për ndjekjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIM
MIDIS
ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (ERE)
DHE
ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR
ENERGJINË TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
(ZRRE)**

Zyra e Rregullatorit për Energjinë dhe Enti Rregullator i Energjisë (këtu dhe më poshtë palët), shohin avantazhin e forcimit të veprimit sienergjik, po ashtu përmes bashkëpunimit dypalësh. Në mënyrë të veçantë palët shohin mundësinë për të përqendruar përpjekjen e tyre të përbashkëta mbi zhvillimin e një strukture të qëndrueshme rregullatore në sektorët e energjisë elektrike dhe gazit në nivel rajonal dhe në nivel dypalësh,

duke marrë parasysh nënshkrimin e Marrëveshjes për Bashkëpunim si një strukturë për zhvillimin e bashkëpunimit afatgjatë dhe shkëmbimin e informacionit mbi bazën e barazisë, reciprocitetit dhe përfitimeve të ndërsjella,

palët ranë dakord për të bashkëpunuar si më poshtë:

Neni 1

Palët do të bashkëpunojnë mbi baza dypalëshe dhe shumëpalëshe për të harmonizuar kornizat rregullatore dhe për të promovuar zhvillimin dhe integrimin e tregjeve.

Neni 2

Palët do të bashkëpunojnë për të favorizuar aktivitetet e përbashkëta të përqendruara në iniciativat e ngritjes së kapaciteteve, shkëmbimin e njohurive dhe praktikave më të mira, seminare të posaçme (*ad hoc*), *workshop*-e dhe trajnime.



Neni 3

Palët duhet të shkëmbejnë eksperiencat në zbatimin e analizës ekonomike dhe juridike të procedurave për përcaktimin e të ardhurave rregullatore të lejuara dhe çmimet e ndërmarrjeve të rregulluara.

Neni 4

Palët në Marrëveshje nuk do të vënë në dispozicion ose nuk do t'u japin palëve të treta asnjë informacion që ata kanë shkëmbyer me njëri-tjetrin pa miratimin paraprak të nënshkruesit të Marrëveshjes.

Neni 5

Kjo Marrëveshje nuk do të cenojë dhe/ose ndikojë te të drejtat dhe detyrimet e nënshkruesve të Marrëveshjes, të drejta që rrjedhin nga memorandume të tjera ndërkombëtare te të cilat marrin pjesë.

Neni 6

Palët mund të caktojnë nëpunës, që të zbatojnë Marrëveshjen, si persona kontakti për çdo aktivitet në të ardhmen, bazuar te kjo marrëveshje.

Neni 7

Marrëveshja nënshkruhet për një periudhë të pakufizuar.

Marrëveshja mund të ndërpritet nga secila palë duke paraqitur një njoftim me shkrim për palën tjetër.

Neni 8

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pas miratimit nga Bordi i ERE-s.

Nënshkruar në Prishtinë,
Kosovë,
në datën __ dhjetor 2019.

Për ERE-n:
Petrit Ahmeti,
KRYETAR I BORDIT

Për ZRRE-në:
Arsim Janova,
UD KRYESUES I
BORDIT

VENDIM
Nr. 214, datë 20.12.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË
“RREGULLOREN PËR PROCEDURAT E
BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE
PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NË
RRJETET E SHPËRNDARJES DHE TË
TRANSMETIMIT DHE PËR BLERJEN E
ENERGJISË ELEKTRIKE PËR TË
SIGURUAR PËRMBUSHJEN E
DETYRIMEVE TË SHËRBIMIT
PUBLIK”

Në mbështetje të nenit 16, nenit 19, germa l, nenit 69, germa “ë”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 5, të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016 “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar, dhe “Rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 139, datë 15.8.2016, nenit 21, të “Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 20.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 119/6, prot., datë, 18.12.2019 të hartuar nga drejtoritë teknike, mbi shqyrtimin e kërkesës së OSHEE sh.a., për një ndryshim në “Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 123, datë 29.7.2019, ka filluar procedurën për shqyrtimin e kërkesës së OSHEE sh.a., për një ndryshim në “Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë



elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”.

- Pas kësaj vendimmarrje me shkresën nr. 436/1 prot., datë 14.8.2019, u është kërkuar palëve të interesit Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Autoriteti i Konkurrencës (AK), Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, Shoqatës së Furnizuesve të Energjisë (AAES) e për dijeni të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSHEE) sh.a. mendimi mbi propozimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSHEE) sh.a., si dhe është caktuar si detyrë për OSHEE sh.a., “të japë sqarime që lidhen me ndryshimet e propozuara, në lidhje me kushtet e shpalljes së ofertës për blerjen e energjisë elektrike, si dhe kushtet e negocimit të afatit të pagesave, duke garantuar një proces të drejtë e të ligjshëm për të gjithë tregtarët pjesëmarrës”.

- Në vijim të sa më sipër dhe detyrave të lëna në pikën 2, të vendimit sipërcituar, OSHEE sh.a. me të sajën 14321/3, i është përgjigjur kërkesës së ERE-s, duke riformuluar propozimin e saj e duke shpjeguar se “Bazuar në kostot e parashikuara të energjisë nga analiza që do të bëhet lidhur me koston e blerjes së energjisë në treg të lirë (pas konfirmimit nga Shoqëria KESH sh.a. të sasisë së energjisë elektrike për klientët tariforë (dhe për humbjet nëse do të ketë mundësi), OSHEE-ja do të kryejë analizat financiare për periudhat në vijim me qëllim vlerësimin e aftësisë paguese të OSHEE-së, duke vlerësuar të ardhurat dhe shpenzimet e pritshme. Bazuar në këtë analizë, OSHEE-ja do të përcaktojë afatet e mundshme për pagesën e detyrimeve të blerjes së energjisë elektrike në treg të parregulluar, afat i cili do të variojë nga 30–180 ditë, nga dita e fundit e lëvrimit të energjisë elektrike”.

- Për sa më sipër, shpjeguar nga OSHEE-ja sh.a., kjo e fundit ka kërkuar riformulimin e propozimit për të cilin Bordi i ERE-s ka filluar procedurën me vendimin nr. 123/2019 si më poshtë:

“Pagesa do të bëhet në përputhje me afatin e përcaktuar në ftesën për pjesëmarrje, afat i cili do të vendoset rast pas rasti në përputhje me mundësitë financiare likuiduese të shoqërisë”.

- Në vijim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 123/2019, në zbatim të rregullores së organizimit,

funksionimit dhe procedurave të ERE-s, me shkresën nr. 436/1 prot., datë 14.8.2019, u është kërkuar palëve të interesit Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Autoriteti i Konkurrencës (AK), Operatorit të sistemit të transmetimit (OST) sh.a., Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Shoqatës së Furnizuesve të Energjisë (AAES) e për dijeni të Operatorit të sistemit të shpërndarjes (OSHEE) sh.a., mendimi mbi propozimin e riformuluar të OSHEE-së.

- Në përfundim të afatit 15-ditor për marrjen e opinioneve dhe komenteve të palëve të interesit në lidhje me këtë vendimmarrje në ERE janë paraqitur opinionet e Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) dhe Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë (AAES), dhe jashtë afatit të pritjes së komenteve është përcjellë edhe opinionin e Autoritetit të Konkurrencës, të cilët shprehen si në vijim.

- Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. shprehet se nuk ka kundërshtim për ndryshimet e propozuara nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSHEE) sh.a. për sa u përket procedurave të blerjes së energjisë elektrike nga subjekti në fjalë.

- Shoqata AAES, me shkresën nr. 15 prot., datë 29.8.2019, parashtrohet qëndrimin e saj si në vijim:

- Blerja e energjisë elektrike që realizohet nga OSHEE sh.a. nga kompanitë tregtare të energjisë elektrike realizohet me rregulla të miratuara nga ERE, por kjo blerje nuk është një blerje e rregulluar pasi çmimi që ofrojnë kompanitë tregtare të energjisë elektrike është një çmim i lirë tregu dhe jo subjekt i rregullimit. Në këto kushte konstatohet se rregullat e miratuara nga ERE për blerjen e energjisë elektrike nga tregu i parregulluar kanë garantuar, konkurrencën, transparencën dhe trajtimin e barabartë të ofertuesve.

- Çdo ndryshim i rregullores së blerjes së energjisë elektrike që aplikon OSHEE sh.a. duhet të përcaktojë se afatet për pagesat duhet të jenë të njohura për kompanitë tregtare, në mënyrë që të sigurohet transparenca e procesit, të jenë të njëjta për të gjithë pjesëmarrësit, në mënyrë që të mos lejohet diskriminimi i pjesëmarrësve në procedurë dhe të nxitet konkurrenca ndërmjet pjesëmarrësve në këto procedura.

- Më tej, AAES-ja ka pretenduar se marzhet mesatare në tregtimin e energjisë elektrike në rajon (Evropa Juglindore) janë më shumë se dhjetë herë



më të ulëta se ato në tenderët e OSHEE-së, që do të thotë se nivelet e marzheve të çmimit të blerjes të OSHEE-së nuk mund t'u atribuohen faktorëve të tjerë ekonomikë, përveç afateve të gjata të paarsyeshme të pagesave të vendosura nga OSHEE-ja.

- Analiza e bërë nga AAES-ja është pjesore dhe vlerësimet e dhëna për tregun rajonal të energjisë nuk janë shoqëruar me dokumentacion mbështetës për të mundësuar verifikim e vërtetësisë së këtyre shifrave dhe të dhënave të paraqitura nga AAES-ja. Në këto kushte, nuk mund të vlerësohet nëse të dhënat e paraqitura dhe analiza e tregut rajonal e bërë nga AAES-ja është e bazuar në shifra me burime të njohura dhe të konfirmuara.

- AAES-ja, pretendon se OSHEE sh.a. gjatë periudhës 2017–2019 (janar–shtator) ka blerë energji elektrike në tregun e parregulluar nga kompanitë më shumë se shifra e analizuar nga AAES-ja, dhe që arrijnë dhe në 40 % të gjithë energjisë elektrike të hedhur në rrjetin e shpërndarjes, duke bërë që të ketë ndikime negative në çmime, pasi ndikojnë në rritjen e tyre. Të dhënat ku bazohet ERE për këtë analizë duhet të jenë të publikuara në faqen zyrtare të ERE-s.

- AAES-ja shprehet se “pjesëtarët e tregut nuk do të mundën të menaxhojnë rreziqet që burojnë nga pjesëmarrja në procedurat e OSHEE-së, dhe mundet që, në mënyrë të arsyeshme, të prezumojmë që numri i pjesëmarrësve në këto procedura, në terma afatgjatë pagese, do të ulët ndjeshëm”.

- Vlerësimi i shprehur nga AAES-ja lind për konkurrencën në procedurat blerjes së energjisë elektrike në tregun e parregulluar. Në këto kushte vlen të theksojmë se konkurrenca lidhet ngushtë me transparencën dhe aplikimin e rregullave të barabarta për të gjithë pjesëtarët në procedurat e blerjes së energjisë elektrike në tregun e parregulluar. Aktualisht rregullorja e miratuar nga ERE për procedurat e blerjes së energjisë elektrike garanton transparencën dhe trajtimin e barabartë të shoqërive tregtare që marrin pjesë në procedurat e shit/blerjes së energjisë elektrike në OSHEE sh.a., dhe kjo del qartë në të dhënat e publikuara në faqen zyrtare të ERE-s për periudhën janar 2017–shtator 2019 ku numri i shoqërive tregtare të cilat kanë furnizuar me energji elektrike OSHEE sh.a. nga tregu i parregulluar është mbi 10. Në këto kushte vlerësojmë se rregullorja e miratuar nga

ERE për procedurat e blerjes së energjisë elektrike nga OSHEE sh.a. ka garantuar konkurrencën.

- AK-ja, me shkresën nr. 796 prot., datë 6.12.2019 bën me dije vendimin nr. 659, datë 21.11.2019 të autoritetit, duke u shprehur si në vijim:

- “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike është operatori i vetëm në tregun e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, pra, është monopol natyror dhe si i tillë tarifat e aplikuar prej tij duhet të pasqyrojnë drejt parashikimet ligjore lidhur me afatin e kontratave për çmimin e blerjes së energjisë, bazuar në një kthim të arsyeshëm, një kohëzgjatje të arsyeshme të përcaktuar dhe të miratuar nga ERE”.

- Në kuptim të sa më sipër, pozita dominuese së cilës i referohet AK-ja, lidhet me administrimin e rrjetit të shpërndarjes, i cili është monopol shtetëror, por edhe detyrimit të ngarkuar në mënyrë ekskluzive për sigurimin e shërbimit universal, në kuptim të VKM-së nr. 244/2016, i ndryshuar.

- Sa i përket sqarimit lidhur me tarifat e aplikuar nga OSHEE sh.a., sqarohet se tarifat e aplikuar nga OSHEE sh.a., me qëllim shërbimit e furnizimit në cilësinë e Furnizuesit të Shërbimit Universal, janë ato që përcakton ERE në zbatim të parashikimeve të nenit 85, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.

- Lidhur me kërkesën e AK-së për një kthim të arsyeshëm sqarohet se operatorët e tregut të energjisë elektrike që operojnë në kushtet e tregut të parregulluar, nuk operojnë mbi bazat e një çmimi të rregulluar nga ERE, por kanë të gjithë lirinë tregtare për të caktuar apo negociuar çmimin e shitjes së energjisë elektrike. Në lidhje me impaktin që rritja e çmimit, do të ketë me vendosjen e çmimeve të padrejta të blerjes apo shitjes së energjisë elektrike apo kushteve të tjera të padrejta të tregutit, sqarojmë siç sjellë në vëmendje në shpjegimet e dhëna më sipër mbi pretendimet e shoqatës së furnizuesve AAES, se vendosja e kushteve dhe afateve të njëjta për blerjen e energjisë elektrike nga tregtarët në treg të parregulluar, nuk vendos në kushte diskriminuese asnjërin prej tyre. Në kuptim edhe të praktikave më të mira tregtare, por edhe parimeve të përgjithshme mbi të cilat zhvillohen prokurimet publike, në kuptim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, me shpalljen e kushteve dhe



afateve të ftesës për ofertë, nga ana e OSHEE-së, synohet të sigurohet një trajtim i barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

- Në vendimin e saj nr. 659, datë 21.11.2019, AK-ja ka vendosur t'i rekomandojë ERE-s që gjatë procedurës së miratimit të një ndryshimi në rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen e energjisë elektrike, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik, të marrë në konsideratë:

1. Shqyrtimin e procedurave të aplikimit për blerje të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen e energjisë elektrike, konform parashikimeve dhe afateve të përcaktuara në pikën 1, neni 21 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s".

2. Të kërkohet dhe të përcaktohet qartë periudha tranzitore për aplikimin e ndryshimit të kërkuar nga ana e OSHEE sh.a. në blerjen e energjisë në përputhje me parashikimet ligjore të lidhura me afatin e kontratave për çmimin e blerjes së energjisë, bazuar në një kthim të arsyeshëm, një kohëzgjatje të arsyeshme të përcaktuar dhe brenda afatit të periudhës tranzitore 30.9.2019 të miratuar nga ERE."

- Në lidhje me pikën 1 të këtij rekomandimi, konstatohet se neni 21, pika 1, së cilës i referohet AK-ja, lidhet me: përcaktimin e tarifave dhe çmimeve të shërbimeve të energjisë elektrike dhe të gazit natyror për vitin pasardhës...

- Çmimi me të cilin OSHEE-ja blen në treg të parregulluar, është i përcaktuar nga oferta më e mirë, dhe nuk rregullohet nga ERE.

- Në lidhje me pikën 2 të këtij rekomandimi, konstatohet se: nuk lidhet me objektin e shqyrtimit nga ERE. Fundi i periudhës tranzitore të përcaktuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 146, datë 4.10.2019, është data 31.12.2019. ERE i është drejtuar AK-së, me kërkesën për opinion në lidhje me vendimin nr.123, datë 29.7.2019, mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OSHEE sh.a. për një ndryshim në "Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen e energjisë elektrike

për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik".

- Sa më sipër, në vijim edhe të arsytimit të vendimit i cili shpreh qartë qëllimin e kërkesës së OSHEE sh.a., jo për një periudhë tranzitore, por edhe sa shpjeguar më lart e në këtë pikë të dispozitivit të vendimit, është e qartë që nuk jemi në kushtet e trajtimit të kësaj kërkesë për një periudhë tranzitore.

- ERE, e ka të gjithë lirinë, në kuptim të rregullatorit të sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, si dhe për shkak të kompetencave me të cilat e ka veshur ligji, që të shprehet edhe përtej objektit të kërkesës nëse konstaton se vetë kërkesa nuk adreson edhe problematikat që ajo mund të gjenerojë. Pikërisht për këtë arsye, në këtë vendimarrje, ERE nuk është ndalur vetëm në trajtimin e kërkesës objekt shqyrtimi, qëndrimin për të cilën e ka dhënë në pikën e parë të vendimit nr. 123/2019, por në pikën 2 të tij, pikërisht për shkak të gjetjeve të veta dhe konstatimeve se kërkesa siç ishte paraqitur, nuk adresonte problematikat që mund të gjeneronte, është shprehur si në vijim:

"OSHEE sh.a. të japë sqarime që lidhen me ndryshimet e propozuara në pikën 1 të këtij vendimi, në lidhje me kushtet e shpalljes së ofertës për blerjen e energjisë elektrike, si dhe kushtet e negocimit të afatit të pagesave, duke garantuar një proces të drejtë e të ligjshëm për të gjithë tregtarët pjesëmarrës".

- Pikërisht në vijim të sa lënë detyrë në këtë pikë të vendimit të sipërcituar, OSHEE sh.a. me të sajën 14321/3, i është drejtuar ERE-s me sqarimet e nevojshme dhe saktësimin e objektit të kërkesës.

- Për gjithë sa më sipër shpjeguar, konstatohet se për AK-në, ka qenë i paqartë trajtimi i kërkesës së ERE-s për opinion në lidhje me vendimin nr. 123/2019, e konkluzionet apo rekomandimet e përcjella, adresojnë çështje që nuk lidhen me këtë vendimarrje.

- Enti Rregullator i Energjisë, me qëllim sigurimin e një vendimarrje sa më të drejtë, transparente e gjithëpërfshirëse, me shkresën nr. 610, ka njoftuar të gjitha palët e interesit urdhrin e kryetarit të ERE-s nr. 119/2019 për zhvillimin e një seance dëgjimore ku palët të marrin e të japin sqarime në lidhje me kërkesën e OSHEE sh.a. për të cilën ERE ka filluar procedurën me vendimin e Bordit nr. 123/2019.



- Në këtë seancë të organizuar në ERE, në datën 14.10.2019, kanë marrë pjesë përfaqësues të OST-së, OSHEE-së, KESH-it, MIE-së, AK-së, Devoll Hydropower, Shoqatës së Furnizuesve AAES.

- Gjatë diskutimeve në seancën dëgjimore u shprehën qëndrimet e palëve të interesit pjesëmarrës në këtë seancë të cilat po i përmbledhim në mënyrë sintetike në vijim.

- Shoqata e Furnizuesve të Energjisë AAES përcolli një përshkrim më të detajuar të qëndrimeve për të cilat ka bërë me dije më herët ERE-n shkresërisht, shpjegimet për të cilat i kemi dhënë më sipër.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë mbështeti propozimin e OSHEE-së për ndryshimet në rregullore.

- KESH sh.a. dhe OST sh.a. nuk kishin komente apo kundërshtime mbi këtë propozim.

- Nga ana e OSHEE sh.a. u dhanë shpjegime mbi legjitimitimin e kërkesës për ndryshime duke vendosur theksin në faktin që liria kontraktore në këtë marrëdhënie duhet të jetë e garantuar, por sigurisht brenda kornizave ligjore që përcakton ERE në këtë rregullore, por duke saktësuar që në çdo rast, me miratimin e kërkesës së tyre nga ana e ERE-s asnjë tregtar nuk do të trajtohet në mënyrë diskriminuese e të diferencuar.

Konkluzione:

- Mbështetur në nenin 19, germa “I”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ERE l) miraton, me propozim të të licencuarve rregullat për shitjen, blerjen dhe shkëmbimin e energjisë elektrike, që kryhen nga prodhuesit dhe furnizuesit, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik;

- Në nenin 62, pika 2, si dhe nenin 69, germa “ë”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, parashikohet se procedurat e prokurimit të energjisë elektrike miratohen nga ERE, pas propozimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

- Me vendimin nr. 103, datë 23.6.2016 është miratuar “Rregullorja për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”.

- Mbështetur në nenin 2, pika 1, të kësaj rregulloreje, objekti i saj është të përcaktojë procedurat e blerjes dhe shitjes së energjisë elektrike sipas nenit 6 më poshtë nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe çdo kompani tjetër e energjisë elektrike për të cilën janë vendosur detyrimet e shërbimit publik (PSO) nga kompanitë e licencuara për tregtimin e energjisë elektrike.

- Mbështetur në nenin 2, pika 2, të kësaj rregulloreje, parashikohet se:

Qëllimi i kësaj rregulloreje, është:

a) të përcaktojë procedura eficiente dhe praktike për kompanitë e energjisë elektrike, të cilave u jemi referuar në paragrafin 1, të këtij neni, për blerjen e energjisë elektrike nga tregtarët;

b) të sigurojë blerje të energjisë elektrike me çmime sa më të ulëta;

c) të nxisë pjesëmarrjen e tregtarëve në procesin e blerjes së energjisë elektrike;

d) të nxisë konkurrencën në procesin e blerjes së energjisë elektrike;

e) të sigurojë transparencë, si dhe një trajtim të barabartë për të gjithë tregtarët dhe pjesëmarrësit në procedurat e blerjes së energjisë elektrike;

f) të përputhet me legjislacionin në fuqi.

- Në kuptim të sa më sipër, është e qartë që përcaktimi i afateve të shlyerjes së pagesave siç parashikuar në nenin 20 të rregullores, nuk lidhet thelbësisht me konceptin e rregullimit të procedurës.

- Ligji, në vetvete parashikon ngushtësisht detyrimin kryesor për përcaktimin e procedurave, me të cilat të kryhen transaksionet për qëllimet për të cilat është hartuar kjo rregullore.

- Ndryshe nga akte të tjera nënligjore të parashikuara si detyrim për miratim nga ERE, ligjbërësi në nenin 19, germa “I” të ligjit, është kufizuar në përcaktimin e procedurave, duke vlerësuar këto të fundit si thelbësore për të garantuar transparencën, mbrojtjen e konkurrencës së ndershme, trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues të tregtarëve të energjisë elektrike, në këtë marrëdhënie.

Në vlerësim të analizës së mësipërme, dhe shpjegimeve të dhëna nga OSHEE sh.a., dhe të palëve të përfshira në këtë proces, si dhe të ERE-s në lidhje me kërkesën për ndryshimin e nenit 20 të rregullores së miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, parimet e



mësipërme, të cituara edhe nenin 2, pika 2, të kësaj rregulloreje, janë të mbrojtura dhe të garantuara për sa kohë, procedura, termat dhe afatet e prokurimit të energjisë elektrike për pjesëtarët e tregut të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik nga tregtarët në tregun e parregulluar janë të njëjta dhe transparente.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së OSHEE sh.a., për ndryshimin e nenit 20, germa “a” të “Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”, duke përcaktuar:

Afatet e pagesës që i ngarkuari me detyrimin e shërbimit publik do të aplikojë për tregtarët në procedurat për prokurimin e energjisë elektrike do të përcaktohen në ftesën për pjesëmarrje.

2. Pas nenit 20, germa “a”, shtohen pikat 1, 2, 3 dhe 4, me përmbajtje:

1. Blerësi duhet të realizojë një analizë të argumentuar dhe dokumentuar për të përcaktuar afatet e pagesës në përputhje me mundësitë financiare likuiduese të vetë blerësit. Në çdo rast blerësi duhet të përcaktojë afate të pagesës, të tilla që të sigurojnë parimet e blerjes së energjisë elektrike në tregun e parregulluar me kosto sa më të ulët.

2. Afati i pagesës, i vendosur në ftesën për ofertë, duhet të jetë i njëjtë për të gjitha shoqëritë tregtare të ftuara në procedurën që do të realizohet nga i ngarkuari me detyrimin e shërbimit publik.

3. Kushtet, termat dhe afatet e parashikuar në ftesën për pjesëmarrje të të ngarkuarit me detyrimin e shërbimit publik, duhet të jenë të njëjta me kontratën e nënshkruar me shoqërinë fituese.

4. Pagesa e faturave të shoqërive tregtare pjesëmarrëse në procedurat e blerjes së energjisë elektrike të jetë proporcionalisht e njëjtë për çdo shoqëri që ka fatura të lëshuara ndaj blerësit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për të njëjtën periudhë lëvrimi. Pagesa e plotë e faturave të shoqërive tregtare për të njëjtën periudhë lëvrimi, të realizohet në të njëjtën periudhë kohore nga blerësi i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik.

3. Pas nenit 19, shtohet pika 6, me përmbajtje: Blerësit e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, të informojnë periodikisht çdo muaj në ERE mbi ecurinë e zbatimit të kësaj rregulloreje si dhe zbatimin e parimeve të

transparencës, trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues të tregtarëve të energjisë elektrike, si dhe të argumentojnë për çdo procedurë blerjeje afatet e pagesës të përcaktuara në përputhje me mundësitë financiare likuiduese të të ngarkuarit me detyrimin e shërbimit publik.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

5. Drejtorja e Çështjeve Ligjore të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2020.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 215, datë 20.12.2019

MBI RISHIKIMIN E “RREGULLORES PËR PROCEDURAT DHE AFATET PËR DHËNIEN, MODIFIKIMIN, TRANSFERIMIN, RINOVIMIN OSE HEQJEN E LICENCEVE NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 39, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 15 dhe nenit 26, të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016, si dhe të nenit 21, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 20.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionet e hartuara nga drejtoritë teknike me nr. 79/6 prot., datë 23.8.2019 dhe nr. 119/4 prot., datë 18.12.2019, në lidhje me rishikimin e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 239, datë 2.11.2018, filloi procedurën për rishikimin e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie,



modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016.

- ERE, me njoftimin nr. 55/66 prot., datë 2.11.2018, ka publikuar në medien e shkruar fillimin e kësaj procedure.

- Me shkresën nr. 706 prot., datë 6.11.2018, u është drejtuar palëve të interesit: MIE, AK, Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha (KKDM), KESH sh.a., OST sh.a., OSHEE sh.a., AAES, FIAA, AREA, ACERC dhe Shoqatës së Prodhuesve të Vegjël për marrje mendimi rreth ndryshimeve të propozuara.

- Po ashtu, me *email*-in e datës 12.11.2018, ERE i është drejtuar Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për marrje mendimi për ndryshimet e propozuara.

- Në përfundim të afatit të pritjes së komenteve nga palët rezulton se OST sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 706/1, datë 21.11.2018; OSHEE sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 706/2, datë 23.11.2018; Sekretariati i Komuniteti të Energjisë, me *email*-in e datës 30.11.2018; MIE, me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 706/4, datë 3.12.2018 dhe Komiteti i Digave të Mëdha, me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 706/5, datë 3.12.2018, kanë dërguar në ERE opinionet e tyre, si më poshtë, të cilat u morën kryesisht në konsideratë dhe u reflektuan në rregullore.

- ERE iu drejtua palëve të interesit: MIE, AK, KESH sh.a., OST sh.a., OSHEE sh.a., KKDM, FIAA, AREA dhe AAES, duke zhvilluar disa seanca dëgjimore për të diskutuar në lidhje me propozimet e palëve për ndryshimet në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Në këtë seancë morën pjesë përfaqësues nga: AREA, ENERGJI ASHTA, AAES, KESH sh.a., OST sh.a. dhe AK.

- Palët u shprehën në seancë se nuk kanë komente për propozimet e gjithsecilit prezent në seancë.

- Ndryshimet e propozuara në këtë rregullore vijnë kryesisht si rezultat i ndryshimeve që pësoi ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, me atë nr. 7/2018, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e

energjisë elektrike”, sa i përket veprimtarisë së operatorit të tregut, si dhe çeljes së Tregut të Organizuar të Energjisë (Bursës Shqiptare të Energjisë). Për këtë arsye lindi nevoja e reflektimit të këtyre ndryshimeve në përmbajtjen e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Po ashtu, në këtë Rregullore janë përfshirë edhe parashikimet e pikës 8, të VKM-së nr. 519, datë 13.7.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Gjatë zbatimit të kësaj rregulloreje, në punën e përditshme të sektorit të licencimit, janë konstatuar mangësi të cilat bënë të nevojshëm rishikimin e saj në kuadër të përmirësimit të disa termave, kushteve apo afateve që kjo rregullore përcakton, si dhe përshtatjen e saj me parashikimet që solli ligji nr. 7/2018, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

- Për propozimin e MIE-s, në lidhje me dhënien e licencave të prodhimit vetëm pas kryerjes së procedurave për marrjen në shfrytëzim të objektit, palët prezente shprehën mosdakordësinë e tyre, duke deklaruar se ky propozim ishte absurd dhe përbënte pengesë për investitorët. Ata gjykuan se nuk duhet të merret në konsideratë nga ana e ERE-s gjatë miratimit të ndryshimeve.

Ndryshimet e propozuara në këtë rregullore bëhen në kuadër të përmirësimit të saj, duke marrë në konsideratë komentet e palëve të interesit dhe saktësimet apo plotësimet e kryera nga vetë ERE në zbatim të parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë rishikimin e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 109, datë 29.6.2016, me shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

- kudo në rregullore do të zëvendësohet termi “aktivitet” me atë “veprimtari”;

- kudo në rregullore pas fjalëve, “ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, do të shtohet fjala “i ndryshuar”;

- kudo në rregullore fjala “subjekt” zëvendësohet me fjalën “shoqëri”;



- kudo në rregullore do të zëvendësohet termi “fuqi e instaluar” me “kapacitet i instaluar”.

- Në nenin 4, pas pikës 2 shtohet pika 3, si më poshtë:

“Për atë që e lejon legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë, nuk do të kërkohej aplikimi për licencim për tregtimin e energjisë elektrike ose furnizimin me energji elektrike, në rast se një shoqëri ka një licencë të lëshuar nga një autoritet rregullator i një vendi tjetër, Palë Kontraktore e Komunitetit të Energjisë/një shteti anëtar të Bashkimit Evropian ose një vend tjetër me të cilin është nënshkruar një marrëveshje dypalëshe, për njohjen reciproke të licencave ndërmjet ERE-s dhe autoritetit përkatës rregullator, si dhe me kusht që ato të dorëzojnë në ERE licencën e përkthyer dhe noterizuar, si dhe informacionin e përcaktuar në nenin 9(1) dhe 9(2), germa “c”, të këtyre rregullave.”

- Në nenin 4, pika 3 ekzistuese bëhet pika 4, me përmbajtje:

“Në rast se rregullatori vendos të njohë ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit dhe të furnizimit të energjisë elektrike, shoqëria që do të ushtrojë këto veprimtari do të konsiderohet si e licencuar në mbështetje me legjislacionin në fuqi dhe u nënshtrohet të gjitha detyrimeve dhe të drejtave të të licencuarve nga ERE.”

- Në nenin 4, shtohen pikat 5 dhe 6, me përmbajtje:

“ERE do t’i përgjigjet kërkesës për njohje licence, me miratim ose jo, brenda 30 ditëve pune.”

- Në nenin 4, shtohet pika 6, me përmbajtje:

“Tregtarët dhe furnizuesit e huaj, të cilëve do t’u njihet licenca nga ERE, do të regjistrohen në një seksion të veçantë të Regjistrit të Licencave, të parashikuar në nenin 19 të kësaj rregulloreje.”

- Në nenin 5 shtohet pika 2, me përmbajtje:

“Për aplikimet në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, të cilat paraqiten në ERE më vonë se data efektive e kontratës/autorizimit, llogaritja e afatit të licencimit, bëhet për periudhën e mbetur. Ky rregull vlen edhe për rastet e modifikimit të licencave.”

- Në nenin 7, “Delegimi i të drejtave të aplikuesit”, pika 2 ndryshon:

“Përfaqësuesi ligjor do të paraqesë në ERE:

a) prokurën ose autorizimin e aplikuesit për përfaqësimin e tij;

b) vërtetim që përfaqësuesi dhe i përfaqësuari nuk janë të përfshirë në një proces të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata).”

- Në nenin 7, në pikën 3, togfjalëshi “të deleguarit përgjegjës” zëvendësohet me fjalën “e përfaqësuesit ligjor”.

- Në nenin 8, “Paraqitja e aplikimit”, pika 3 ndryshon:

“Dokumentacioni i paraqitur nga aplikuesi duhet të jetë në gjuhën shqipe, original ose fotokopje e noterizuar dhe një kopje elektronike në CD, USB ose *email* në adresën zyrtare të ERE-s, ndërsa vërtetimet dhe deklaratat nga organe të tjera duhet të jenë lëshuar jo më parë se 1 muaj nga momenti i paraqitjes së aplikimit.”

- Në nenin 8, pika 5 ndryshon:

“5. Dokumentacioni teknik, sipas tipit të licencës duhet të jetë i hartuar dhe i sigluar nga individ apo person juridik i pajisur me licencë profesionale përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi (ing. elektrike, ing. ndërtimi, ing. mekanike, ekspertë kontabël, ing. hidroteknikë etj.).”

- Neni 8, pika 6, shfuqizohet:

- Në nenin 8, pika 7, merr numërtimin 6.

- Në tabelën e nenit 9, pika 1, germa “a”, “Të dhëna për aplikimin” (të plotësohen nga aplikuesi), shtohet opsioni i zgjedhjes “Njohje licence”.

- Në tabelën e nenit 9, pika 1, germa “b”, “Të dhëna identifikuese të aplikuesit” (të plotësohen nga aplikuesi), në pikën 4 zëvendësohet togfjalëshi “i deleguari përgjegjës” me fjalën “përfaqësuesi ligjor”.

- Në tabelën e nenit 9, pika 1, germa “c”, “Të dhëna për aplikuesin (të plotësohen nga aplikuesi)”, në pikën 1 zëvendësohet togfjalëshi “aplikuesit nuk i është refuzuar” me togfjalëshin “nuk më është refuzuar”.

- Në tabelën e nenit 9, pika 1, germa “c”, shtohet pika 4 me përmbajtje: “Deklaratë për kryerjen e pagesës së aplikimit/njohjes për licencim, sipas llojit të veprimtarisë”.

- Në nenin 9, pika 2, “Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor”, germa “b” ndryshon:

“Statuti (nëse është hartuar si dokument i ndryshëm/i veçantë nga akti i themelimit)”.

- Në nenin 9, pika 2, “Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor”, germa “d” ndryshon:

“Vërtetim që shoqëria dhe drejtuesit kryesorë të saj në rastin e personave juridikë, nuk janë të



përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata)”.

- Në nenin 9, pika 2, “Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor”, germa “e” ndryshon:

“Struktura e ndërtimit dhe e funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse. Në rastin e aplikimeve për licencë prodhimi të energjisë elektrike kërkohej paraqitja e licencës për drejtues teknik elektrik”.

- Në nenin 9, pika 2, “Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor”, germa “f” ndryshon:

“Marrëveshje koncesioni apo çdo formë tjetër e marrëveshjes në rastet e aplikueshme të lidhur me institucionet përgjegjëse të ngarkuara me ligj, në përputhje me kuadrin ligjor përkatës, si dhe ndryshim të këtyre akteve”.

- Në nenin 9, pika 3, “Dokumentacioni financiar dhe fiskal”, germa “d” ndryshon:

“Vërtetim për kryerjen e pagesës së regjistrimit për aplikim dhe kërkesë për njohje, në llogari të ERE-s, sipas aneksit A të kësaj rregulloreje”.

- Në nenin 9, pika 4.1.3, “Dokumentacioni teknik dhe grafik”, germa “d” ndryshon:

“Një hartë topografike ku të paraqitet gjurma e linjës transmetuese të energjisë elektrike në shkallë 1:25000”.

- Në nenin 9, pika 4.1.4, “Dokumentacioni tekniko ekonomik”, germa “c”:

Ishte: “Oponencën teknike të projektit”

Bëhet: “Oponencën teknike të projektit nga AKBN-ja”

- Në nenin 9, pika 4.1.4, “Dokumentacioni tekniko-ekonomik”, germa “d” ndryshon:

“d) Miratimi i projektit të Digës nga Komiteti Kombëtar i Digave (në rastet e objekteve me digë)”.

- Në nenin 9, pika 4.1.4, germa “d”, bëhet germa “e”.

- Në nenin 9, pika 4.1.4, germa “e” bëhet germa “f”.

- Në nenin 9, pika 4.1.5, “Lejet nga institucione të tjera”, germa “b” ndryshon:

“Leja e shfrytëzimit të ujit për prodhimin e energjisë elektrike”.

- Në nenin 9, pika 4.2 titulli ndryshon:

“Dokumentacioni teknik për termocentralin (TEC)”.

- Në nenin 9, pika 4.2.5, “Lejet nga institucionet e tjera”, germa “b” ndryshon:

“b) Leja e shfrytëzimit të ujit”.

- Në nenin 9, pika 4.3, titulli ndryshon:

“Dokumentacioni teknik të centraleve për prodhimin e energjisë elektrike nga era”.

- Në nenin 9 pika 4.3.1 nëntitulli, ndryshon:

“Të dhëna teknike të centraleve për prodhimin e energjisë elektrike nga era”.

- Në nenin 9, pika 4.4, titulli ndryshon:

“Dokumentacioni teknik i centraleve për prodhimin e energjisë elektrike nga dielli (fotovoltaike)”.

- Në nenin 9, pika 4.4.1, nëntitulli ndryshon:

“Të dhëna teknike të centraleve për prodhimin e energjisë elektrike nga dielli “fotovoltaike” (të plotësohen nga aplikuesi)”.

- Po këtu, në tabelën e pikës 4.4.1, hiqet përcaktimi i tipi të panelit “solar termik”.

Në nenin 9, pika 4.4.4, germa “c” ndryshon:

“Oponencën teknike të projektit të kryer nga AKBN-ja ose nga një person fizik apo juridik i licencuar”.

- Në nenin 9, pika 4.7, “Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”, germa “b” ndryshon:

“Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare), i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj”.

- Në nenin 9, pika 4.7, “Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”, germa “c” ndryshon:

“Lista e kontratave aktuale dhe të mëparshme (nëse ka), për blerjen dhe sigurimin e energjisë elektrike”.

- Në nenin 9, pika 4.7, “Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”, germa “e” ndryshon:

“Sistemin IT të krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi”.

- Në nenin 9, pika 4.5, germa “h”; pika 4.6, germa “f”; 4.7, germa “f dhe 4.9, germa “c” ndryshon:

“Lista e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës (kur forma e organizimit të shoqërisë e përmban një të tillë)”.

- Në nenin 9, pika 4.7, pas germës “f”, shtohet germa “g”, me përmbajtje si vijon:



“Dokumentacion që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t’u ofrohen klientëve.

- Në nenin 9, pika 4.7, “Tabela ‘a’”, “Të dhëna për klientët dhe energjinë e furnizuar”, merr germëzimin “h”.

- Në nenin 9, pika 4.7, germa “b”, pas tabelës “a”, “Të dhëna për klientët dhe energjinë e furnizuar” bëhet germa “i”.

- Në nenin 9, pika 4.7, germa “c”, pas tabela “a”, “Të dhëna për klientët dhe energjinë e furnizuar” shfuqizohet.

- Në nenin 9, pika 4.8, “Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”. germa “b” ndryshon:

“Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëror me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj”.

- Në nenin 9, pika 4.9, “Dokumentacioni tekniko-ekonomik për veprimtarinë e Operimit të Tregut të energjisë elektrike, ndryshon:

“Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e Operimit të Tregut të energjisë elektrike.

a) dëshmi për krijimin, formën ligjore të subjektit që do të kryejë veprimtarinë e operimit të tregut, sipas legjislacionit në fuqi për këtë qëllim;

b) lista e të punësuarve, profesioni;

c) dëshmi për zotërimin e harduerit dhe softuerit të nevojshëm për operimin e tregut, sipas Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike dhe akteve të tjera për këtë qëllim;

d) lista e anëtareve të Këshillit Mbikëqyrës (kur forma e organizimit të shoqërisë e përmban një të tillë);

e) dëshmi që vërteton mundësinë për të zhvilluar të gjitha procedurat operacionale, kontraktuale ose marrëdhëniet e aksesit, përfshirë shërbimet për likuidimet (*cleaning*) dhe rregullat që lidhen me këto, mekanizmin për mbikëqyrjen e tregut, procedurat dhe kontrollet për mbrojtjen e informacionit konfidencial;

f) dëshmi për kapitalin financiar fillestar të regjistrimit të operatorit të tregut, sipas pikës 2, të VKM-së nr. 322, datë 15.5.2019, “Për krijimin dhe përcaktimin e formës ligjore dhe të strukturës së pronësisë së kapitalit të operatorit të tregut”;

g) çdo dokumentacion tjetër që ka të bëjë me bashkëpunimin në kuadër të veprimtarisë së operimit të tregut të energjisë elektrike.”.

Në nenin 12, pika 1, në fund të paragrafit shtohen fjalët: “apo legjislacionit në fuqi”.

- Në nenin 12, pika 2, zëvendësohet fjala “raport” me fjalën “relacion”.

- Në nenin 13, pika 2, germa “k”, zëvendësohet “Rep.” me “Republika”.

- Në nenin 13, pika 3, germa “c”, zëvendësohet fjala “drejtoritë” me fjalën “drejtoria”.

- Në nenin 14, “Pranimi ose refuzimi për licencim i aplikuesit”, në pikën 1 pas fjalës “prodhimit” shtohen fjalët “të energjisë elektrike”.

- Në nenin 15, “Modifikimi i licencës”, në pikën 2, saktësohet lidhëza “më” me “mw”.

- Në nenin 15, “Modifikimi i licencës”, pika 4, germa “e” ndryshon:

“Të ketë kryer pagesat e aplikimit dhe të rregullimit në ERE.”.

- Në nenin 16, “Rinovimi i licencës”, pika 7 ndryshon:

“Të ketë kryer pagesën e aplikimit dhe atë të rregullimit në ERE.”.

- Në nenin 17, “Transferimi i plotë dhe i pjesshëm i licencës” pika 4, shtohet germa “d” me përmbajtje:

“d) Vërtetimin e pagesës së aplikimit”.

- Në nenin 17, “Transferimi i plotë dhe i pjesshëm i licencës”, pika 4, shtohet germa “e”, me përmbajtje: “e) Vendimin e organeve drejtuese të shoqërisë për miratimin e transferimit të licencës së shoqërisë.”.

- Neni 18, “Heqja e licencave”, ndryshon:

“Me iniciativë të ERE-s dhe mbajtësit të licencës apo të autorizuarit, në kuptim të nenit 4, pika 4 të kësaj rregulloreje, ERE fillon procedurën për heqjen e licencës, në zbatim të parashikimeve të rregullores për procedurat e heqjes së një licence të miratuar nga Bordi i ERE-s.”.

- Neni 19, pika 4, germa “h” ndryshon:

“Vendimi i ERE-s”.

- Neni 20, “E drejta për t’u informuar mbi përmbajtjen e regjistrimit”, pika 1 ndryshon:

“Regjistri i Licencave publikohet në faqen e internetit të ERE-s.”.

- Neni 22 ndryshon titulli:

“Amendimi i rregullores”.

- Në aneksin A, “Pagesa e regjistrimit dhe e procedimit të një aplikimi”, shtohet në kolonën e fundit të tabelës zëri “Njohja e licencës”, për të cilën pagesa e aplikimit është llogaritur në masën 500 000 lekë.



2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë të interesuarit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn nga data 1.1.2020.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM
Nr. 216, datë 20.12.2019

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“AXPO ALBANIA” SHA, NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e” dhe nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 115/3 prot., datë 12.12.2019, për gatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi licencimin e shoqërisë “AXPO Albania” sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 174, datë 7.11.2019, ka filluar procedurën për licencimin e shoqërisë “AXPO Albania” sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria “AXPO Albania” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 459/1 prot., datë 22.10.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, është kryer njoftimi në median e shkruar me shkresën nr.

32/49, datë 8.11.2019, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palë të treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “AXPO Albania” sh.a.

- Me shkresën nr. 459/2 prot., datë 12.11.2019, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Në përgjigje të sa më sipër, me shkresat protokolluar në ERE me nr. 459/3 prot., datë 20.11.2019, dhe nr.459/4 prot., datë 2.12.2019, shoqëria “AXPO Albania” sh.a. ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar.

- Kjo shoqëri është regjistruar pranë QKB-së, në datën 22.4.2005, me statusin e shoqërisë aksionare (sh.a.), konform legjislacionit në fuqi dhe mban numër identifikimi (NUIS) K51628010V.

- Aplikimi i shoqërisë “AXPO Albania” sh.a., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formatit dhe dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1, gjerat: “a”, “b”, “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d”) “e”, është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “AXPO Albania” sh.a. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.



2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM
Nr. 217, Datë 20.12.2019

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ELVA 2001” SHA NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA HEC “MIVAS”, ME
KAPACITET TË INSTALUAR
1940 kW**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37 pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të nenit 4, pika 1, germa “a”, të nenit 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.12.2019 mbasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga shoqëria “Elva 2001” sh.p.k., si dhe pasi shqyrtoi relacionin nr. 115/4 prot., datë 12.12.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Elva 2001” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie, nga HEC “Mivas”, me kapacitet të instaluar 1940 kW,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 151, datë 14.10.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Elva 2001” sh.a., në veprimtarinë e

prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Mivas”, me kapacitet të instaluar 1940 kW.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje u krye njoftimi në median e shkruar, me shkresën nr. 32/42, datë 15.10.2019, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Elva 2001” sh.a.

- ERE, me shkresën nr. 656 prot., datë 21.10.2019, iu drejtua shoqërisë “Elva 2001” sh.a. duke i njoftuar vendimin për fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar, i cili konsistonte në:

- neni 9, pika 2, germa “g” (dokumente që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti);

- neni 9, pika 3, germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit);

- neni 9, pika 4.1.1 (të dhëna teknike për HEC-in, pika 3, pika 8, pika 11, pika 16, pika 19);

- neni 9, pika 4.1.4, germa e (dokumentacioni tekniko-ekonomik).

- Shoqëria “Elva 2001” sh.a, me shkresën e protokolluar në ERE, nr. 656/1 prot., datë 4.11.2019, ka përcjellë në ERE dokumentacionin e kërkuar.

- Duke konstatuar se nuk ishin shteruar të gjitha kërkesat për dokumentacionin e munguar, ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 656/2 prot., datë 12.11.2019 për plotësimin e informacionit dhe dokumentacionit të munguar.

- Shoqëria “Elva 2001” sh.a, me shkresën protokolluar në ERE me numër 656/3, datë 20.11.2019, ka përcjellë në ERE dokumentacionin e kërkuar.

- Shoqëria “Elva 2001” sh.a., është një subjekt tregtar i krijuar me vendimin nr. 25441, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, datë 15.3.2001, në zbatim të ligjit nr. 7512, datë 10.8.1991 dhe mban numër identifikimi (NUI) K12809402J.

- Shoqëria “Elva 2001” sh.a. është mbajtëse e “Miratimit përfundimtar për ndërtimin e objektit, hidrocentralit ‘Mivas’, me kapacitet prodhues 1940 kW, në pellgun ujëmbledhës të lumit të Tomorricës, Bashkia Gramsh, qarku Elbasan, me



nr. 2657/2 prot., datë 27.12.2017”, mbështetur në pikën 2, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe në VKM-në nr. 822, datë 7.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, të ndryshuar.

- Shoqëria ka nënshkruar kontratën me nr. 5 rep., nr. 3/3 kol., datë 25.01.2018 me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE). Kohëzgjatja e kontratës do të jetë 49 vjet, me të drejtë ripërsëritje. Referuar kësaj kontrate, për afatet e vënies në punë të veprës, mbajtësi i miratimit merr përsipër të vë në punë hidrocentralin brenda 21 (njëzet e një) muajve nga data e marrjes së të gjitha lejeve për fillimin e punimeve, siç është parashikuar në grafikun e punimeve të paraqitur në aneksin 2, bashkëlidhur kontratës.

- Afati i aplikimit, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga strukturat shtetërore, për pajisjen me lejet e nevojshme, është jo më shumë se 12 muaj nga data e hyrjes në fuqi të kontratës. Rezulton se shoqëria ka vijuar me aplikimet për pajisjen me lejet në institucionet përkatëse.

- Periudha e vlefshmërisë së lejes së shfrytëzimit të ujit është deri në datën 16.11.2022.

- Shoqëria bën me dije se i ka të gjitha mundësitë për të vënë në punë HEC-in brenda vitit 2019.

- Aplikimi i shoqërisë “Elva 2001” sh.a., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat: “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f” dhe “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.1.1, pika 4.1.2, pika 4.1.3, germat: “a”, “b”, “c”, “d”; pika 4.1.4 germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; pika 4.1.5, germat: “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Në kuptim të nenit 38, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ERE përcakton kushtet që duhet të përmbushen për marrjen e çdo licence, duke marrë në konsideratë, ndër të tjera: a) afatin e vlefshmërisë së licencës, i cili për veprimtaritë e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes nuk mund të jetë më shumë se 30 vjet;

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Elva 2001” sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Mivas”, me kapacitet të instaluar 1940 kW, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria “Elva 2001” sh.p.k të depozitojë në ERE çdo dokument/leje që i nënshtrohet procedurës së rinovimit, nga institucionet që i lëshojnë ato, jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të afatit të parashikuar në këto dokumente/leje.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 218, datë 20.12.2019

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “HEC ARSTI” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-i “ARSTI”

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”,



të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 15, të “Rregullores të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes nr.118/5 prot., datë 16.12.2019, mbi licencimin e shoqërisë “HEC Arsti” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “HEC Arsti” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 600 prot., datë 26.9.2019, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-i “Arsti”.

- ERE, me vendimin nr. 158, datë 29.10.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “HEC Arsti” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në median e shkruar me shkresën nr. 23/45, datë 31.11.2019, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “HEC Arsti” sh.p.k.

- Me shkresën nr. 600/1 prot., datë 4.11.2019, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Në përgjigje të sa më sipër, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 600/2 prot., datë 22.11.2019, shoqëria “HEC Arsti” sh.p.k. ka përcjellë dokumentacionin e munguar.

- Shoqëria “HEC Arsti” sh.p.k., është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i nenit 26, pika 6, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, me kërkesë të autoritetit kontraktues nga operatori ekonomik i zgjedhur si ofertuesi më i suksesshëm, me të cilin lidhet kontrata e koncesionit.

- Kontrata e koncesionit nr. 1129 rep. dhe nr. 351/1 kol., datë 25.5.2016, “Për ndërtimin e HEC-it Arsti”, është lidhur midis subjektit për qëllime të veçanta (SPV), HEC-it Arsti sh.p.k., në cilësinë e koncesionarit, dhe MIE-s, në cilësinë e Autoritetit

Kontraktues. Kjo kontratë ka një afat 35-vjeçar që fillon nga data e hyrjes në fuqi të saj.

- Shoqëria është pajisur me lejen e ndërtimit me nr. 60/4 prot., datë 24.4.2019, dhënë për shoqërinë “HEC Arsti” sh.p.k. me objekt: “Ndërtimin e burimit të ri gjenerues, HEC-it Arsti, në përroin e Arstit, degë e lumit Drin, Bashkia Fushë-Arrëz, Pukë, qarku Shkodër”, me afat 12-mujor, të cilën e ka depozituar edhe në ERE. Shoqëria bën me dije se punimet për ndërtimin e HEC-it kanë filluar në datën 25.4.2019.

- Shoqëria “HEC Arsti” sh.p.k. ka depozituar certifikatat për vërtetim pronësie të lëshuar nga ZVRPP Pukë, në datën 30.5.2019, për numrat e pasurive 233/1, 234/1, 235/1, 236/1, 237/1, 238/1, në zonën kadastrale 1054, në pronësi të Bashkisë Fushë-Arrëz, nga përmbajtja e së cilës rezulton se në datën 7.9.2019, është bërë regjistrimi i kontratës së koncesionit nr. 1129 rep. dhe nr. 351/1 kol., datë 25.5.2016, “Për ndërtimin e HEC-it ‘Arsti’”, të lidhur midis SPV-ve, “HEC Arsti” sh.p.k. dhe MIE-s. Gjithashtu është depozituar në ERE, vendimi nr. 57, datë 25.4.2018, të Këshillit të Bashkisë Fushë-Arrëz, “Për dhënien e pëlqimit, për dhënien në përdorim të sipërfaqes fond pyjor kullor në administrim të Bashkisë Fushë-Arrëz, në zonën kadastrale nr. 1619, me sipërfaqe 3.7728 ha, njësia administrative Fierzë, në funksion të ndërtimit të HEC-it ‘Arsti’ nga shoqëria ‘HEC Arsti’ sh.p.k.”.

- Shoqëria ka përcjellë në ERE shkresën e OSHEE-së me nr. 30990/3 prot., datë 5.1.2017, me anë të së cilës është miratuar pika e lidhjes për HEC-in “Arsti” në rrjetin elektrik të shpërndarjes për kapacitetin e instaluar 3130 kW (kapaciteti sipas atij të pasqyruar në kontratën e koncesionit). HEC “Arsti” do të lidhet me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet linjës 35 kV, në zbarat 10 kV të nënstacionit Gropaj. Lidhja e HEC-it “Arsti” në linjën 35 kV, në zbarat 10 kV, do të realizohet nëpërmjet një transformatori zbritës 35/10 kV, që do të vendoset pranë nënstacionit Gropaj.

- Shoqëria ka paraqitur lejen e Këshillit të Basenit Ujor Drin–Bunë, “Për përdorim të Burimit Ujor”, me nr. vendimi 2, datë 14.8.2018, lëshuar për shoqërinë “HEC Arsti” sh.p.k. për ndërtimin e HEC-it “Arsti”, duke përdorur burimin ujor të përroit të Arstit.

- Shoqëria ka depozituar në ERE me shkresën nr. 5360/1 prot., datë 27.6.2017, të Ministrisë së



Mjedisit, deklaratën mjedisore me nr. vendimi 26 dhe nr. identifikimi 465, e lëshuar për “HEC Arsti” sh.p.k., për zhvillimin e projektit të HEC-it “Arsti” me kapacitet të instaluar 3401 kW, (kapaciteti sipas atij të pasqyruar në projektin e zbatimit). Kapaciteti i instaluar i HEC-it, i pasqyruar në këtë leje, është i njëjtë me atë të projektit të zbatimit të miratuar nga MIE, me shkresën nr. 143/43 prot., datë 1.8.2017.

- Për gjithë sa më sipër, konstatohet se:

- Shoqëria duhet të depozitojë në ERE kontratën e koncesionit të amenduar, pas nënshkrimit të saj nga palët, ku të reflektohet ndryshimi i fuqisë së instaluar të parashikuar në kontratën e koncesionit, nga ai i miratuar në projektin e zbatimit.

- MIE, me shkresën nr. 13792/1 prot., datë 31.12.2018, bën me dije shoqërinë se është duke shqyrtuar dhe përgatitur amendimin e kontratës së koncesionit të HEC-it “Arsti”, për reflektimin e parametrave hidroenergjetike dhe ndryshimit të programit të punimeve sipas projektit të zbatimit, të miratuar me shkresën nr. 143/43 prot., datë 1.8.2017.

- Shoqëria duhet të depozitojë në ERE lejen e përdorimit të ujit, të rinovuar, në përfundim të afatit të saj, duke iu referuar vlefshmërisë së kësaj leje, deri në datën 13.8.2023.

- Nga analiza e dokumentacionit të depozituar në ERE, nga shoqëria “HEC Arsti” sh.p.k., rezulton se subjekti ka plotësuar tërësisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formatit dhe dokumentacioni për aplikim. Neni 9, pika 1, germat: “a”, “b”, “c”. Plotësuar.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor. Neni 9, pika 2, germat: “a”, “b”, “c”, “d”,

“e”, “f”, “g”. Plotësuar.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal. Neni 9, pika 3, germat: “a”, “b”, “c”, “d”. Plotësuar.

- Dokumentacioni teknik për HEC-in. Neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3, germat: “a”, “b”, “c”, “d”

dhe pika 4.1.4, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”. Plotësuar.

- Leje nga institucione të tjera. Neni 9, pika 4.1.5, germat: “a”, “b”, “c”. Plotësuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “HEC Arsti” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-i “Arsti”, me fuqi të instaluar 3130 kW, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria “HEC Arsti” sh.p.k. të depozitojë në ERE lejen e ujit, të rinovuar, në përfundim të afatit të saj, në datën 13.8.2023.

3. Ky vendim është objekt rishikimi nëse shoqëria “HEC Arsti” sh.p.k., depoziton në ERE, kontratën e ndryshuar të koncesionit, me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për reflektimin e parametrave hidroenergjetikë dhe ndryshimit të programit të punimeve dhe fuqisë së instaluar, sipas projektit të zbatimit.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 219, datë 20.12.2019

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “HYDRO POWER PANARIT” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALI “VILE” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1994 kW

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 10, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”; si dhe nenit 15, të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 20.12.2019, mbasi shqyrtoi



relacionin me nr. 119/1 prot., datë 17.12.2019, të Drejtorisë së Licencimit Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, lidhur me “Licencimin e shoqërisë ‘Hydro Power Panarit’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “Vile” me kapacitet të instaluar 1994 kW,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 157, datë 29.10.2019, “Filloi procedurën për licencimin e shoqërisë ‘Hydro Power Panarit’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-i ‘Vile’ me kapacitet të instaluar 1994 kW, për një afat 30-vjeçar”.

- ERE, me shkresën nr. 32/44 prot., datë 31.10.2019, ka bërë publikimin në median e shkruar për “Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-i ‘Vile’” dhe ka ftuar palët të bëjnë komente dhe sugjerime.

- ERE, me shkresën me nr. 587/1 prot., datë 4.11.2019, ka njoftuar shoqërinë lidhur me vendimarrjen e Bordit, për “Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë ‘Hydro Power Panarit’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-i ‘Vile’, si dhe kërkesën për plotësimin e dokumentacionit të munguar”.

- ERE me shkresat nr. 587/2 prot., datë 20.11.2019, nr. 587/4 prot., datë 11.12.2019, ka rikujtuar subjektin për plotësimin e dokumentacionit të munguar.

Shoqëria “Hydro Power Panarit” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 587/3/4 prot., datë 27.11.2019, ka depozituar dokumentacionin e munguar.

- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Në datën 29.10.2015, është e regjistruar pranë QKB-së, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sh.p.k., konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, me numër identifikimi (NUI) L52229023C.

- Objekt i veprimtarisë së këtij subjekti, ndër të tjera, është edhe: “Ndërtimi, operimi, shpërndarja, shitja e energjisë elektrike të hidrocentralit mbi lumin Panarit. Prodhim dhe shitje energjie elektrike”.

- MIE, me miratimin përfundimtar nr. 2441/7 prot., datë 6.7.2017, ka miratuar ndërtimin e HEC-

it “Vile” me kapacitet prodhues 1994 kW, në ujërat e rrjedhjes së mesme dhe të poshtme të luginës së përroit të Panaritit, degë e lumit Osum, të qarkut Korçë.

- MIE, pas miratimit përfundimtar, ka lidhur me shoqërinë “Hydro Power Panarit” sh.p.k., kontratën me nr. 1951 rep.; nr. 882/2 kol., datë 4.9.2017, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Vile”, me kapacitet prodhues 1994 kW, në ujërat e rrjedhës së mesme dhe të poshtme të luginës së përroit të Panarit, degë e lumit Osum, qarku Korçë”.

- Kohëzgjatja e kontratës do të jetë 49 vjet nga data e hyrjes në fuqi të saj me të drejtë ripërsëritje.

- Në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me vendimin e Bordit nr. 109, datë 29.6.2015, nuk rezultoi të ketë ndonjë vërejtje apo ankesë nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Hydro Power Panarit” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-i “Vile”.

- Aplikimi i shoqërisë “Hydro Power Panarit” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë vijon:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germat: “a”; “b”; “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f” dhe “g”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për HEC-in, (neni 9, pika 4.1.1; pika 4.1.2 ; pika 4.1.3, germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”; pika 4.1.4, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; pika 4.1.5, germat: “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Në kuptim të nenit 38, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ERE përcakton kushtet që duhet të përmbushen për marrjen e çdo licence, duke marrë në konsideratë, ndër të tjera: a) afatin e vlefshmërisë së licencës, i cili për veprimtaritë e prodhimit,



transmetimit dhe shpërndarjes nuk mund të jetë më shumë se 30 vjet;

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Hydro Power Panarit” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-i “Vile” me fuqi 1994 kW, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE lejen e ujit, të rinovuar, jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të afatit, në datën 11.5.2022.

3. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE lejen e mjedisit, të rinovuar, jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të afatit, në datën 3.8.2020.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM

Nr. 220, datë 20.12.2019

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
BORDIT TË ERE-s NR. 187, DATË
10.11.2017, “PËR LICENCIMIN E
SHOQËRISË “ALBGAS” SHA, NË
AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES SË
GAZIT NATYROR”, TË NDRYSHUAR
DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
BORDIT TË ERE-s NR. 188, DATË
10.11.2017, “PËR LICENCIMIN E
SHOQËRISË “ALBGAS” SHA NË
AKTIVITETIN E TRANSMETIMIT TË
GAZIT NATYROR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 16, pika 12; të neneve 46 dhe 56 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”; të nenit 113, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”; të neneve 8 dhe 9 të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe të

miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror”, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes nr. 118/44 prot., datë 16.11.2019, mbi një ndryshim në vendimet e bordit të ERE-s nr. 187 dhe nr. 188, datë 10.11.2017,

konstatoi se:

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 36, datë 4.3.2019, ka vendosur:

- Të miratojë një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”, të ndryshuar, si më poshtë:

“- Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e shpërndarjes së gazit natyror, për një afat 30- vjeçar, me kushtin që brenda datës 20.12.2019, në mbështetje të nenit 24, pika 2, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të plotësojë gjithë dokumentacionin e munguar ...”.

Dhe, me vendimin nr. 37, datë 4.3.2019, vendosi:

1. Të miratojë një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”, të ndryshuar, si më poshtë:

“- Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e transmetimit të gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që, brenda datës 20.12.2019, në mbështetje të nenit 24, pika 2, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të plotësojë gjithë dokumentacionin e munguar ...”.

- Shoqëria “Albgaz” sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 51 prot., datë 17.5.2019, protokolluar në ERE me nr. 266/4 prot., datë 20.5.2019, si dhe shkresës nr. 52 prot., datë 17.5.2019, protokolluar në ERE me nr. 354 prot., datë 20.5.2019, ka bërë me dije ERE-n për mbylljen e procesit të pajisjes me certifikata pronësie dhe ka njoftuar për zmadhimin e kapitalit.

- Në vijim, shoqëria “Albgaz” sh.a. i është drejtuar ERE-s me shkresën nr. 122 prot., datë 2.12.2019, protokolluar në ERE me nr. 196/1 prot., datë 2.12.2019, me anë të së cilës ka kërkuar



shtyrjen e afatit të dërgimit të dokumentacionit të munguar deri në datën 20.6.2020, duke u shprehur se pajisja me dokumentet e kërkuara është një proces që kërkon kohë dhe është në varësi të përgjigjes nga institucionet përkatëse.

- Gjithashtu, me qëllim plotësimin e dokumentacionit, shoqëria “Albgaz” sh.a. informon ERE-n se ka aplikuar për transferimin e lejes mjedisore të (tipi A) pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe është ende në pritje.

- Shoqëria “Albgaz” sh.a. deklaron se ka parashikuar në Programin e Zhvillimit Ekonomik për vitin 2020, pagesën e certifikatës së sigurimit si shoqëri sigurimi.

- Shoqëria “Albgaz” sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 51 prot., datë 17.5.2019, protokolluar në ERE me nr. 266/4 prot., datë 20.5.2019, ka përcjellë dokumentacionin si vijon:

- certifikatë pronësie për Sheq i Madh, me numër pasurie 44/6, me datë lëshimi 9.8.2017;

- certifikatë pronësie për Fier, Drizë, me numër pasurie 93, me datë lëshimi 9.11.2017;

- certifikatë pronësie për Fier, Gjonçë, me numër pasurie 267/10, me datë lëshimi 9.11.2017;

- certifikatë pronësie për Lavdan, Mallakastër, me numër pasurie 549, me datë lëshimi 18.12.2017;

- vërtetim dokument hipotekar nga ZRPP-ja përkatëse për Drenovë, Mallakastër, me numër pasurie 1/6, me datë lëshimi 27.4.2018;

- vërtetim dokumenti hipotekar nga ZRPP-ja përkatëse për Balldren, Elbasan, me numër pasurie A, me datë lëshimi 24.7.2018;

- certifikatë pronësie për Cërrik, Elbasan, me numër pasurie 12/289, me datë lëshimi 24.4.2019.

Sa më sipër, rezulton se kushti i vendosur në vendimet e bordit të ERE-s, përkatësisht nr. 187 dhe nr. 188, datë 10.11.2017, që lidhet me dokumentacionin që tregon titujt e pronësisë mbi asetet që ka, për të kryer funksionet ose për të plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar, është plotësuar tërësisht nga shoqëria “Albgaz” sh.a.

- Dokumentacioni i cili mbetet për t’u plotësuar në vijim deri në datën 20.6.2019, nga ana e shoqërisë “Albgaz” sh.a. është si më poshtë:

- Pajisja me lejet dhe autorizimet mjedisore (neni 9, pika 1, germa “d”, “vi”) e “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror”.

- Depozitimi në ERE i certifikatës së sigurimit të lëshuar nga shoqëri sigurimi (neni 9, pika 1, germa “e”, “iv”) e “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit nr. 187, datë 10.11.2017, si më poshtë:

“Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e shpërndarjes së gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 20.6.2020, në mbështetje të nenit 24, pika 2, e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të plotësojë të gjithë dokumentacionin e munguar ...”.

2. Të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit nr. 188, datë 10.11.2017, si më poshtë:

“Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e transmetimit të gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 20.6.2020, në mbështetje të nenit 24, pika 2, e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të plotësojë të gjithë dokumentacionin e munguar ...”.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 221, datë 20.12.2019****MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
E BORDIT TË ERE-s NR. 179, DATË
8.11.2017, “MBI CERTIFIKIMIN E
SHOQËRISË OPERATORI I
KOMBINUAR I GAZIT NATYROR”
“ALBGAZ” SHA, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 37, 50, 59, 68, dhe 80, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, nenit 53 dhe nenit 113, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”; neneve 6–11 të “Rregullores për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Gazit Natyror”, miratuar me vendimin e Bordit nr. 100, datë 5.8.2015, ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 129, datë 31.10.2015; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 20.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionet me nr. 119/2 dhe me nr. 119/2–1 prot., datë 19.12.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, “Mbi certifikimin e shoqërisë Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror ‘Albgaz’ sh.a.”, të ndryshuar,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 179, datë 8.11.2017, Bordi i ERE-s ka miratuar certifikimin e shoqërisë Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror “Albgaz” sh.a.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje dhe konstatimit të mosplotësimit të disa nga kushteve të vendosura në vendimin sipërcituar, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 63, datë 23.4.2019, ka vendosur ndër të tjera:

2. Pika 3 e vendimit nr. 179, datë 8.11.2017, të Bordit të ERE-s, ndryshon dhe bëhet:

“3. “Albgaz” sh.a. të përfundojë brenda tre muajve procedurat e aplikimit pranë institucioneve përgjegjëse për pajisjen me certifikata pronësie për të gjitha asetet që disponon.

3. Pika 4 e vendimit nr. 179, datë 8.11.2017, të Bordit të ERE-s, ndryshon dhe bëhet: “Shoqëria

“Albgaz” sh.a. të dorëzojë për miratim në ERE deri në datën 31 maj 2019, Programin e përputhshmërisë të përshtatur sipas atij të miratuar nga ERE me vendimin nr. 77, datë 26.5.2017 e Bordit të ERE-s. “Mbi miratimin e programit të përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror”.

4. Pika 5.1 e vendimit nr. 179, datë 8.11.2017, të Bordit të ERE-s, ndryshohet dhe bëhet: “Albgaz” sh.a. të paraqesë në ERE deklaratat e audituesve financiarë dhe pasqyrat financiare të shoqërisë çdo vit ushtrimor.”

5. Afati i përcaktuar në pikën 5.2, të vendimit nr. 179, datë 8.11.2017, të Bordit të ERE-s, të shtyhet deri në datën 20.12.2019.

- Kjo shtyrje u miratua për shkak të pamundësisë së “Albgaz” sh.a. për të përmbushur të gjitha kushtet brenda afatit të përcaktuar në vendimin nr. 179, datë 8.11.2018, “Mbi certifikimin e shoqërisë Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror ‘Albgaz’ sh.a.”.

- Me shkresën nr. 114, datë 11.11.2019, protokolluar në ERE me nr. 661/1 prot., datë 12.11.2019, shoqëria “Albgaz” sh.a. ka njoftuar ERE-n mbi plotësimin e disa prej kushteve të vendimit të sipërcituar dhe ka paraqitur kërkesë për shtyrje të plotësimit të kushteve të mbetura deri më 20.6.2020, për arsye se plotësimi i këtyre të fundit nuk varet nga vullneti i “Albgaz” sh.a.

Paraqitja e analizës për secilin kusht si më poshtë vijon:

- Në lidhje me plotësimin e pikës 3, të vendimit nr. 179, datë 8.11.2017, të ndryshuar, shoqëria “Albgaz” sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 51 prot., datë 17.5.2019, protokolluar në ERE me nr. 266/4 prot., datë 20.5.2019, ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar në të cilin rezulton se kushti i vendosur në pikën 3, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, është plotësuar tërësisht nga shoqëria “Albgaz” sh.a.

- Në lidhje me plotësimin e pikës 4, të vendimit nr. 179, datë 8.11.2017, të Bordit të ERE-s, “Albgaz” sh.a., bën me dije ERE-n se Programi i përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror është miratuar nga Këshilli mbikëqyrës i shoqërisë, me vendimin nr. 18, datë 4.11.2019, “Mbi miratimin e programit të përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror”, sipas seksionit VII, pika 76, e programit të përputhshmërisë. Në



pikën 2 të këtij vendimi citohet se ai hyn në fuqi pas miratimit nga Asambleja e Përgjithshme. Sa më sipër cituar, kushti i vendosur në pikën 4, të vendimit nr. 179, datë 8.11.2017, të Bordit të ERE-s “Mbi miratimin e programit të përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror”, nuk është plotësuar ende nga “Albgaz” sh.a., pasi nuk ka marrë ende miratimin e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

- Në lidhje me plotësimin e pikës 5.1, të vendimit nr. 179, datë 8.11.2017, të Bordit të ERE-s, shoqëria “Albgaz” sh.a., ka përcjellë pasqyrat financiare të vitit 2018, së bashku me deklaratat e audituesve financiarë, të cilët janë të ndryshëm nga ata të emëruar e që kryejnë këtë veprimtari për “Albpetrol” sh.a.

Plotësimi i këtij kushti nuk çliron “Albgaz” sh.a. nga detyrimi për të raportuar në ERE çdo vit për audituesit ligjorë që kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore të vitit, në zbatim të vendimit nr. 179, datë 8.11.2017 dhe ligjit nr. 47/2016, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10091, datë 5.3.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar.

- Në lidhje me plotësimin e pikës 5.2, të vendimit nr. 179, datë 8.11.2017, të Bordit të ERE-s, “Albgaz” sh.a., bën me dije se ka përcjellë pranë MIE-t kërkesën me nr. 125 prot., datë 5.11.2018, ku ndër të tjera ka kërkuar zgjidhje edhe për plotësimin e këtij kushti, por nuk ka ende asnjë përgjigje prej saj edhe pse ka kaluar shumë kohë tashmë.

ERE, me shkresën nr. 354/2 prot., datë 6.11.2019, ka kërkuar mbështetjen e MIE-s për zbatimin e parashikimeve të vendimit të certifikimit të “Albgaz” sh.a., por ende nuk ka marrë një përgjigje. Gjithashtu, ERE, me shkresën nr. 797 prot., datë 5.12.2019, ka njoftuar “Albgaz” sh.a. dhe MIE, në lidhje me zhvillim e një seance dëgjimore më 12.12.2019, ora 10:00, për të diskutuar në lidhje me masat e marra për kushtet e vendimit nr. 179, datë 8.11.2019, të cilat kanë mbetur ende pa plotësuar. Asnjë nga palët e njoftuara nuk u paraqit në këtë seancë.

- Në këto rrethana, kushti i vendosur në pikën 5.2, të vendimit nr. 179, datë 8.11.2019, pavarësisht përpjekjeve të shoqërisë “Albgaz” sh.a., por edhe ERE, mbetet ende pa plotësuar.

Për gjithë sa më sipër cituar konstatojmë:

- Referuar vendimit të Bordit nr. 179, datë 8.11.2017, nga shoqëria “Albgaz” sh.a. rezulton se nuk janë plotësuar ende kushtet si më poshtë:

- “Albgaz” sh.a. nuk ka dorëzuar për miratim në ERE deri në datën 31 maj 2019, Programin e përputhshmërisë të përshtatur sipas atij të miratuar nga ERE me vendimin nr. 77, datë 26.5.2017 e Bordit të ERE-s. “Mbi miratimin e programit të përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror”.

- “Albgaz” sh.a. nuk ka mundur të paraqesë në ERE provat dokumentare që ndryshimet ligjore dhe nënligjore të nevojshme që lidhen me transferimin e kompetencave të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë tek aksionari i “Albgaz” sh.a., Ministria e Ekonomisë dhe Financave, kanë ndodhur dhe janë efektive.

- Në vijim të raportimit dhe konstatimeve sa më sipër, për shkak të rrethanave, të cilat siç shpjeguar nuk varen nga vullneti i “Albgaz” sh.a. për të zbatuar parashikimet e vendimit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, ky i fundit i është drejtuar ERE me kërkesën për shtyrjen e afatit të dërgimit të dokumentacionit të kërkuar nga vendimi nr. 179, datë 8.11.2017, deri në datën 20.6.2020.

- Në lidhje me këtë kërkesë, Kodi i Procedurave Administrative, neni 53 i tij parashikon që: afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.

- Kërkesa e “Albgaz” sh.a. është depozituara në ERE, me shkresën nr. 114, datë 11.11.2019, dhe duke marrë në konsideratë që afati i vendosur në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, i ndryshuar, plotësohet në datën 20.12.2019, shqyrtimi i kësaj kërkesë përpara përfundimit të afatit, plotëson kushtet sa më sipër.

- Përveç kësaj, duke vlerësuar se për shkak të fatkeqësisë natyrore që goditi Shqipërinë, e gjithë qeveria shqiptare është e angazhuar në adresimin e problematikave që lidhen me korrigjimin e pasojave të shkaktuara nga kjo situatë dhe adresimi i çështjeve që lidhen me gjendjen e fatkeqësisë natyrore do të ketë prioritet mbi çështje të tjera, mendojmë se afati 6-mujor i propozuar nga shoqëria “Albgaz” sh.a. për shtyrjen mund të mos jetë i mjaftueshëm që MIE të finalizojë ndryshimet e kërkuara ligjore apo të miratojë në mënyrë



përfundimtare në Asamblenë e Përgjithshme Programin e përputhshmërisë së “Albgaz” sh.a.

- Plotësimi i kushtit të përcaktuar në pikën 5.2, të vendimit nr. 179, datë 8.11.2017, të Bordit të ERE-s, lidhet me bërjen efektive të ndryshimeve në kuadrin ligjor, të cilat për shkak të hapave proceduralë që ndjekin deri në miratim, dhe në kushtet e konstatuara më sipër, kërkojnë një kohë më të gjatë se 6 muaj për t'u realizuar.

- Plotësimi i kushtit të përcaktuar në pikën 4, të vendimit nr. 179, datë 8.11.2017, të Bordit të ERE-s, kërkon mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë, proces që duhet të kryhet jo vetëm në funksion të kësaj vendimmarrje, por edhe për shkak të detyrimeve ligjore që lidhen me miratimin e pasqyrave financiare të shoqërisë, të cilat në përputhje me legjislacionin në fuqi, duhet të depozitohen bilanci vjetor kontabël dhe raportin e auditimit, sipas shkronjës “a”, të nenit 43/3, të ligjit nr. 9723/2007, brenda datës 31 korrik të çdo viti.

- Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e pikës 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 63, datë 23.4.2019.

2. Shtyrjen e afatit të parashikuar në pikën 3, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 63, datë 23.4.2019, deri në datën 20.6.2020.

3. Shtyrjen e afatit të parashikuar në pikën 4, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 63, datë 23.4.2019, deri më 20.12.2020.

4. “Albgaz” sh.a. të paraqesë në ERE deklaratat e audituesve financiarë dhe pasqyrat financiare të shoqërisë çdo vit ushtrimor.

5. “Albgaz” sh.a. të marrë masa brenda datës 20.6.2020, lidhur me zbatimin e ndarjes së pronësisë në përputhje me parashikimet e nenit 36, pika 2, gjerat “a” dhe “b”, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar.

6. Nëse ndarja e pronësisë së “Albgaz” sh.a. nuk është bërë sipas nenit 36, pika 2, gjerat “a” dhe “b”, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, brenda datës 20.6.2020, ERE ka të drejtë të rishikojë vendimin nr. 179, datë 8.11.2017, “Për certifikimin e shoqërisë Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror Albgaz sh.a.”.

7. Drejtoria e Licencimit Autorizimeve dhe e Mbikëqyrjes të përcjellë këtë vendim pranë “Albgaz” sh.a., Ministrisë së Infrastrukturës dhe

Energjisë, Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, Autoritetit të Konkurrencës si dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 222, datë 20.12.2019

MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “NOA ENERGY TRADE” SHPK, NR. 262, SERIA T15, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 7, DATË 2.2.2015

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “e”; nenit 5, pika 1, germa “e”; nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 119/9 prot., datë 18.12.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për rinovimin e licencës së shoqërisë “NOA Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 188, datë 25.11.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “NOA Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.



- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje u krye njoftimi në median e shkruar, me shkresën nr. 32/56, datë 26.11.2019, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “NOA Energy Trade” sh.p.k..

- Me shkresën nr. 727/1 prot., datë 3.12.2019, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Në përgjigje të sa më sipër, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 727/1 prot., datë 13.12.2019, shoqëria “NOA Energy Trade” sh.p.k. ka përcjellë dokumentacionin e munguar.

- Shoqëria “NOA Energy Trade” sh.p.k., është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Në datën 27.9.2014 është regjistruar pranë QKB-së, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.), konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, me numër identifikimi (NUIS) L42203031A.

- Shoqëria “NOA Energy Trade” sh.p.k., është mbajtëse e licencës me nr. 262, seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendim të Bordit të ERE-s nr. 7, datë 2.2.2015, me afat 5-vjeçar.

- Referuar sa më sipër, konstatohet se shoqëria “NOA Energy Trade” sh.p.k., ka aplikuar brenda afatit ligjor për rinovimin e licencës.

Aplikimi i shoqërisë “NOA Energy Trade” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikimit (neni 9, pika 1, germat: “a”, “b”, “c”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat: “a”, “b”, “c”, “d”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germat: “a”, “b”, “c”, “d”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “NOA Energy Trade” sh.p.k., me nr. 262, seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 7, datë 2.2.2015 për një afat 5-vjeçar, duke filluar vlefshmërinë e saj nga data 3.2.2020.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 223, datë 20.12.2019

**MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS
PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË
SHOQËRISË “HYDROPOWER
ELEKTRIK” SHPK, ME NR. 268, SERIA
FK15, NË VEPRIMTARINË E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË TË
KLIENTËVE TË KUALIFIKUAR,
MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT
TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 20,
DATË 11.2.2015**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “d”; 5, pika 1, germa “d”; 10, pikat 1 dhe 3, dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose



heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 119/12 prot., datë 18.12.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes mbi kërkesën e shoqërisë “Hydropower Elektrik” sh.p.k., për rinovim licence në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Hydropower Elektrik” sh.p.k., është mbajtëse e licencës me nr. 268, seria FK15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendim të Bordit të ERE-s nr. 20, datë 10.2.2015, me afat 5-vjeçar.

- Në bazë të nenit 16, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, parashikohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës nga aplikanti bëhet: (jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë, personi mund/duhet të kërkojë në ERE rinovimin e licencës.

- Shoqëria ka aplikuar brenda afatit që parashikon rregullorja e licencimit, për rinovimin e licencës.

- Aplikimi i shoqërisë “Hydropower Elektrik” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar pjesërisht.

Germa “d”, Shoqëria nuk ka depozituar në dosjen e aplikimit vërtetimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, për administratorin dhe për subjektin, dhe as vërtetimin pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për subjektin.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3), është plotësuar pjesërisht.

Germanat “a” (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave), pa plotësuar.

Germa “b” (bilanci financiar i tre viteve të fundit). Pa plotësuar.

Germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit), (administratori ka deklaruar se për aktivitetin do të bëjë vetë financim, mbështetur në shitjen e energjisë së prodhuar nga vetë HEC-i Slabinje 2, po pa specifikuar shumën që vë në dispozicion për këtë aktivitet). Plotësuar pjesërisht.

Germa “d” (vërtetimin e pagesës së regjistrimit për aplikim në llogari të ERE-s). Shoqëria “Hydropower Elektrik” sh.p.k., nuk ka kryer pagesën e regjistrimit për këtë aplikim. Pa plotësuar.

- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7).

Germa “a” (të dhëna për sigurimin e energjisë elektrike për furnizimin e klientëve, subjekti, central prodhues, sasia e energjisë kontraktuar, në GWh sipas viteve); pa plotësuar.

Germa “b” (kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie); pa plotësuar.

Germa “c” (lista e kontratave aktuale dhe të mëparshme, për blerjen dhe sigurimin e energjisë elektrike); Pa plotësuar.

Germa “d” (informacion i detajuar tekniko-financiar, lidhur me përmbushjen e këtyre kontratave); pa plotësuar.

Germa “e” (sistemin IT); pa plotësuar.

Germa “f” (lista e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës); pa plotësuar.

- Të dhëna për klientët dhe energjinë e furnizuar (neni 9, pika 4.7.1).

Germa “a” (kategoritë, nënkategoritë, numri i konsumatorëve, sasia e energjisë në GWh në vitet I, II, III, IV dhe V, lidhja në Un, fuqia e instaluar e konsumatorëve, aktiviteti (familjarë, buxhetorë, privatë); pa plotësuar.

Germa “b” (niveli i tensionit dhe mënyra e realizimit të matjes për klientët); pa plotësuar.

Germa “c” (kapitali financiar i (shprehur në vlera monetare), i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie); pa plotësuar.

- Shoqëria “Hydropower Elektrik” sh.p.k., nuk ka kryer në mënyrë të rregullt pagesat e rregullimit dhe as pagesën për rinovimin e licencës.

- Në bazë të nenit 16, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, parashikohet se



kusht për marrjen e vendimit për rinovimin e licencës, është që aplikanti të ketë kryer pagesat e rregullimit në ERE. Mosplotësimi i këtij kushti përbën shkak për sanksionim sipas parashikimeve të nenit 5, të rregullores “Për vendosjen e gjobave dhe kushtet e lehtësimit prej tyre”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Mosfillimin e procedurës, për rinovimin e licencës së shoqërisë “Hydropower Elektrik” sh.p.k, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike të klientëve të kualifikuar nr. 268, seria FK15, dhënë me vendim të Bordit të Komisionerëve nr. 20, datë 11.2.2015, me afat 5-vjeçar”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 224, datë 20.12.2019

MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “POWER ELEKTRIK SLABINJË” SHPK, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË KLIENTËVE TË KUALIFIKUAR NR. 266, SERIA FK15, DHËNË ME VENDIM TË BORDIT TË KOMISIONERVE NR. 18, DATË 11.2.2015

Në mbështetje të neneve 16; 37 pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “d”; 5, pika 1, germa “d”; 10, pikat 1 dhe 3, dhe nenit 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë

elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 119/11 prot., datë 18.12.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes mbi kërkesën e shoqërisë “Power Elektrik Slabinjë” sh.p.k., për rinovim licence në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Power Elektrik Slabinjë” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 742/1, datë 10.12.2019, ka aplikuar për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike për klientë të kualifikuar.

- Ligji nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, është ndryshuar me ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar. Si rrjedhojë e këtij shfuqizimi, germa “ç”(furnizimi i energjisë elektrike), e nenit 37, e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, është kategoria e aktivitetit për të cilin një subjekt i licencuar më herët në veprimtarinë e furnizimit për klientët e kualifikuar, mund të aplikojë për rinovimin e licencës në këtë aktivitet.

- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i kontratës koncesionare nr. 2326 rep. dhe nr. 669 kol., datë 11.4.2008, lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë, Energjisë me cilësinë e Autoritetit Kontraktues dhe shoqërisë “LNK” sh.p.k., me cilësinë e Koncesionarit për ndërtimin e HEC-it “Slabinjë”, mbi lumin Shkumbin dhe është regjistruar konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Objekt i veprimtarisë së saj është: Projektimi, zbatimi, ndërtimi, shfrytëzimi, transferimi tek Autoriteti Kontraktues i HEC-it “Slabinjë”. Prodhim energjie, tregtim të energjisë elektrike dhe furnizimit të energjisë elektrike për klient të kualifikuar.

- Shoqëria “Power Elektrik Slabinjë” sh.p.k., është mbajtëse e licencës me nr. 266, seria FK15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike të klientit kualifikuar, dhënë me vendim të Bordit të ERE-s, nr. 18, datë 11.2.2015, me afat 5-vjeçar.



- Në bazë të nenit 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, theksohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës nga aplikanti bëhet: (jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë, personi mund/duhet të kërkojë në ERE rinovimin e licencës). Për sa cituar vlefshmëria e licencës së shoqërisë “Power Elektrik Slabinjë” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, përfundon në datën 11.2.2020, për rrjedhojë shoqëria ka aplikuar brenda afatit që parashikon rregullorja e licencimit, për rinovimin e licencës.

- Aplikimi i shoqërisë “Power Elektrik Slabinjë” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formatit dhe dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar pjesërisht.

Germa “d”, Shoqëria nuk ka depozituar në dosjen e aplikimit vërtetimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, për administratorin dhe për subjektin dhe as vërtetimin pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për subjektin.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3), është plotësuar pjesërisht.

Germa “a” (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave). Pa plotësuar.

Germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit), (Administratori deklaron se për aktivitetin do të bëjë vetë financim, mbështetur në shitjen e energjisë së prodhuar nga vetë HEC-i “Slabinjë 1”, po pa specifikuar shumën që vë në dispozicion për këtë aktivitet). Plotësuar pjesërisht.

Germa “d” (vërtetimin e pagesës së regjistrimit për aplikim në llogari të ERE-s). Shoqëria “Power Elektrik Slabinjë” sh.p.k., nuk ka kryer pagesën e regjistrimit për këtë aplikim. Pa plotësuar.

- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7).

Germa “a” (të dhëna për sigurimin e energjisë elektrike për furnizimin e klientëve, subjekti, central

prodhues, sasia e energjisë kontraktuar, në GWh sipas viteve). Pa plotësuar.

Germa “b” (kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie). Pa plotësuar.

Germa “c” (lista e kontratave aktuale dhe të mëparshme, për blerjen dhe sigurimin e energjisë elektrike). Pa plotësuar.

Germa “d” (informacion i detajuar tekniko-financiar, lidhur me përmbushjen e këtyre kontratave). Pa plotësuar.

Germa “e” (Sistemin IT). Pa plotësuar.

Germa “f” (lista e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës). Pa plotësuar.

- Të dhëna për klientët dhe energjinë e furnizuar (neni 9, pika 4.7.1).

Germa “a” (kategoritë, nënkategoritë, numri i konsumatorëve, sasia e energjisë në GWh në vitet I, II, III, IV dhe V, lidhja në Un, fuqia e instaluar e konsumatorëve, aktiviteti (familjarë, buxhetorë, privatë). Pa plotësuar.

Germa “b” (niveli i tensionit dhe mënyra e realizimit të matjes për klientët). Pa plotësuar.

Germa “c” (kapitali financiar i (shprehur në vlera monetare), i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie). Pa plotësuar.

- Shoqëria “Power Elektrik Slabinjë” sh.p.k., nuk ka kryer në mënyrë të rregullt pagesat e rregullimit dhe as pagesën e aplikimit për rinovimin e licencës.

- Në bazë të nenit 16, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, parashikohet se kusht për marrjen e vendimit për rinovimin e licencës, është që aplikanti të ketë kryer pagesat e rregullimit në ERE. Mosplotësimi i këtij kushti përbën shkak për sanksionim sipas parashikimeve të nenit 5 të rregullores “Për vendosjen e gjobave dhe kushtet e lehtësimit prej tyre”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Mosfillimin e procedurës, për rinovimin e licencës së shoqërisë “Power Elektrik Slabinjë” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike të klientëve të kualifikuar nr. 266, seria FK15, dhënë me vendim të Bordit të Komisionerëve nr. 18, datë 11.2.2015, me afat 5-vjeçar.



2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM
Nr. 225, datë 20.12.2019

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “SA’GA-MAT” SHPK, PËR HEQJEN E LICENCËS SË VEPRIMTARISË SË TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE ME NR. 254, SERIA T14P, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERVE NR. 103, DATË 7.11.2014, PËR NJË AFAT 30-VJEÇAR

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa “dh”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 5, germa “dh”; nenit 7, paragrafi 2 dhe nenit 9, germa “d”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me vendimin nr. 58, datë 18.4.2017, nenit 18 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin me nr.119/10 prot., datë 18.12.2019, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes mbi kërkesën e shoqërisë “SA’GA-MAT” sh.p.k., për heqjen e licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike me nr. 254, seria T14P, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 103, datë 7.11.2014, për një afat 30-vjeçar.

konstatoi se:

- Bordi i Komisionerëve të ERE-s, me vendimin nr. 103, datë 7.11.2014, ka licencuar

shoqërinë “SA’GA-MAT” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 30-vjeçar.

- Shoqëria “SA’GA-MAT” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE, nr. 748 prot., datë 14.11.2019, ka kërkuar heqjen e licencës nr. 254, seria T14P, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 103, datë 7.11.2014, për shkak se nuk ushtron veprimtarinë e “tregtimit të energjisë elektrike”, për të cilën është licencuar nga ERE.

- Shoqëria në shkresën e depozituar në ERE me nr. 748 prot., datë 14.11.2019, ka parashtruar argumentet lidhur me kërkesën për heqjen e licencës.

- Shoqëria “SA’GA-MAT” sh.p.k., ka depozituar në ERE kopje të licencës nr. 254, seria T14P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Rezulton se shoqëria “SA’GA-MAT” sh.p.k., ka kryer pagesën e rregullimit, për vitin 2018, në pajtim me pikën 3.8 të kushteve të licencës, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Me vendimin nr. 212, datë 18.12.2019, Bordi i ERE-s është shprehur “Mbi llogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2019 nga të licencuarit”.

- Afati i kësaj licence në zbatim të vendimit nr. 103, datë 7.11.2014, përfundon në datën 17.4.2044.

- Kërkesa e shoqërisë “SA’GA-MAT” sh.p.k., për heqjen e licencës së tregtimit mbështetet në parashikimet e nenit 42, pika 1, germa “dh”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, në të cilin citohet se: ERE heq një licencë me kërkesë të të licencuarit; si dhe nenit 5, germa “dh” të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, e cila parashikon se: “Licenca hiqet me kërkesë të të licencuarit”,

- Rregulloreja për procedurat e heqjes së licencës në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, neni 7, paragrafi 2 përcakton se: “Në rast se nga i licencuarit është propozuar për t’iu hequr licenca për shkak të kushteve të parashikuara në pikat “dh” dhe/ose “e” të nenit 5 të kësaj rregulloreje, ERE do të procedojë menjëherë me zbatimin e parashikimeve të nenit 9 të kësaj rregulloreje”.

- “Rregullorja për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, në nenin 9, germa “d” të saj, përcakton



se: "...Bordi do të vendosë për të hequr licencën subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat "dh" dhe / ose "e" të nenit 5 të kësaj rregulloreje, në përputhje me nenin 7, paragrafi 2, të kësaj rregulloreje".

- Në kushtet kur kërkesa për heqjen e licencës vjen nga vetë i licencuari, dhe legjislacioni në fuqi i sipërcituar, i jep ERE-s të drejtën ligjore për t'u shprehur me një vendim miratimi pa kaluar më parë në fillimin e procedurës.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë "SA'GA-MAT" sh.p.k., për heqjen e licencës së tregtimit të energjisë elektrike me nr. 254, seria T14P, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 103, datë 7.11.2014.

2. Shoqëria "SA'GA-MAT" të shlyejë detyrimet e përcaktuara në vendimin e bordit të ERE-s nr. 212, datë 18.12.2019 brenda afatit të parashikuar në legjislacionin në fuqi.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas përmbushjes së kushtit të parashikuar në pikën 2 të këtij vendimi.

4. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 226, datë 20.12.2019

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "ERS-08" SHPK, PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË VENDIMIT NR. 63, DATË 13.6.2008, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 114, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative", si dhe të nenit 15, të "Rregullave për organizimin, funksionimin dhe

procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionet me nr. 111/3 prot., datë 21.11.2019, nr. 11/3-1 prot., datë 22.11.2019, nr. 115/5 prot., datë 13.12.2019, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, lidhur me "Kërkesën e shoqërisë "ERS-08" sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 63, datë 13.6.2008, ë ndryshuar",

konstatoi se:

- Shoqëria "ERS-08" sh.p.k. i është drejtuar ERE-s me shkresën nr. 33 prot., datë 14.11.2019, protokolluar në ERE, me nr. 694/1, datë 18.11.2019, duke kërkuar shtyrjen e afatit të plotësimit të kushteve, me argumentin se pavarësisht negociatave të vazhdueshme, nuk ka arritur ende të lidhë me MIE-n një kontratë për shitblerjen e energjisë elektrike (PPA). Për këtë arsye, janë pezulluar edhe punimet për zbatimin e projektit. Shoqëria "ERS-08" sh.p.k. i kërkon ERE-s shtyrjen e afatit të realizimit të kushteve të vendimit të licencimit me 18 muaj.

- Shoqëria "ERS-08" sh.p.k. është licencuar nga ERE me vendimin nr. 63, datë 13.6.2008, në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrikë me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga Parku Eolik Kavajë, me kusht zbatimin e sa parashikuar në licencën tip të miratuar nga Bordi i Komisionerëve të ERE-s, për aktivitetin e ndërtimit dhe të prodhimit të energjisë elektrike nga centrale eolike, si dhe kushteve të parashikuara në pikën 1, gerrat "a", "b", "c", "d" dhe "e", të këtij vendimi.

- ERE ka miratuar shtyrjen e afateve të licencës, për: "ndërtimin, instalimin dhe shfrytëzimin e centraleve elektrik me erë për Parkun Eolik Sarandë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike prej tyre", me vendimet nr. 46, datë 28.5.2009 dhe nr. 135, datë 15.11.2013.

- ERE, me vendimin nr. 4, datë 10.1.2018, "Mbi shtyrjen e afatit për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë "ERS-08" sh.p.k., mbajtëse e licencës nr. 59, seria NPM08P, "Për ndërtimin, instalimin, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale eolike", ka vendosur: Shtyrjen e afatit për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE në pikën 2, gerrat "a", "b", "c", "d" dhe "e", të vendimit nr. 63, datë 13.6.2008, "Mbi aplikimin e shoqërisë "ERS-08" sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e ndërtimit,



instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë dhe prodhimin e energjisë elektrike nga Parku Eolik Kavajë”, për shoqërinë “ERS-08” sh.p.k., mbajtëse e licencës nr. 59, seria NPM08P, “Për ndërtimin, instalimin, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale me erë nga Parku Eolik Kavajë, deri në datën 15.11.2019.

- MIE, me shkresën nr. 102/4 prot., datë 27.4.2015, e cila ka ardhur si përgjigje e shkresës së ERE-s nr. 14 prot., datë 7.1.2015, ku iu kërkuar të bëjë me dije, lidhur me kompetencën institucionale të trajtimit të këtyre subjekteve në mbështetje të legjislacionit në fuqi, bën me dije se: VKM-ja nr. 1701, datë 17.12.2008, “Për miratimin e rregullores për procedurat e dhënies së autorizimeve për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese që nuk janë objekt koncesioni”, nuk ka efekt prapaveprues. Vlerësimi i kërkesave lidhur me licencat e miratuara nga ERE duhet të bëhet konform dispozitave ligjore, të cilat kanë qenë në fuqi në kohën e miratimit të këtyre licencave.

- Për shkak të kompleksit të problematikave që i licencuari ka hasur, është shprehur se nuk ka mundur të plotësojë në kohë të gjitha kushtet e vendimit nr. 63, datë 13.6.2008, “Për licencimin e shoqërisë “ERS-08” sh.p.k.”.

- Shoqëria “ERS-08” sh.p.k. ka depozituar në ERE një korrespondencë të OST sh.a. (shkresa nr. 505/1 prot., datë 5.5.2008), në të cilën kjo e fundit shprehet për mundësinë e lidhjes me rrjetin e transmetimit të Parkut Eolik Lezhë, me kapacitet 50 mw, nëpërmjet një linjë 110 kV, me seksion ACSR 240 mm² në nënstacionin e Bushatit dhe Parkun Eolik Kavajë, me kapacitet 40 mw, nëpërmjet një linjë 110 kV, me seksion ACSR 240 mm² në nënstacionin e Bushatit, marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a. Shoqëria nuk ka depozituar në ERE marrëveshje për lidhjen me rrjetin të nënshkruar me OST sh.a.

- Shoqëria nuk ka përcjellë studimin e fizibilitetit.

- Me qëllim shqyrtimin e rrethanave që kanë penguar përmbushjen e detyrimeve në afat, nga ana e shoqërisë është e nevojshme të ushtrohet një monitorim i thelluar pranë subjektit.

- Rezulton se shoqëria “ERS-08” sh.p.k., nuk është debitore ndaj ERE-s dhe ka shlyer të gjitha pagesat e rregullimit.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pezullojë shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “ERS-08” sh.p.k. për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 63, datë 13.6.2008, në aktivitetin e “Ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga Parku Eolik Kavajë, deri në përfundimin e monitorimit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi”.

2. Të ushtrojë monitorim të thelluar pranë subjektit “ERS-08” sh.p.k., për të evidentuar, për të dokumentuar e për të shqyrtuar të gjitha rrethanat të cilat aplikuesi pretendon se i kanë pamundësuar zbatimin e kushteve dhe afateve të parashikuara në vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 63, datë 13.6.2008, “Për licencimin e shoqërisë “ERS-08” sh.p.k., të ndryshuar, si dhe për të analizuar pasqyrat financiare të shoqërisë për të verifikuar shpenzimet e kryera deri më sot.

3. Afati i pezullimit të parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, përfundon jo më vonë se 90 ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

4. Aplikuesi, shoqëria “ERS-08” sh.p.k., është përgjegjëse për marrjen e të gjitha masave për të siguruar çdo dokumentacion të nevojshëm, me qëllim përfundimin e monitorimit të parashikuar në këtë vendim, në afat.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes do të njoftojë palët e interesuara lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

**VENDIM****Nr. 227, datë 20.12.2019****MBI KËRKESËN E SHOQËRISË OSHEE
SHA PËR MIRATIMIN E PLANIT TË
INVESTIMEVE PËR VITIN 2019 DHE
PËRDITËSIMIN E PLANIT TË
ZHVILLIMIT TË RRJETIT TË
SHPËRNDARJES PËR PERIUdhËN
PESËVJEÇARE 2018–2022, TË
SHOQËRISË OSHEE SHA**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, germa “e”, nenit 75, nenit 110, pika 2, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të “Rregullores së procedurave të paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 135, datë 6.9.2017, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 118/2 prot., datë 13.12.2019, të përgatitur nga grupi i punës, mbi shqyrtimin e kërkesës së OSHEE sh.a., për miratim të planit të investimeve për vitin 2019 dhe përditësimin e planit të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes për periudhën pesëvjeçare 2018–2022, të shoqërisë OSHEE sh.a.,

konstatoi se:

- OSHEE sh.a., me shkresën nr. 1708 prot., datë 22.1.2019, ka paraqitur pranë ERE-s “Planin e investimeve për vitin 2019”, ku në strukturë të tij, ndër të tjera, paraqitet edhe Plani 2019–2023 i përditësuar për zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes.

- Grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 14, datë 1.2.2019, të kryetarit të ERE-s, shqyrtoi aplikimin e dërguar nga shoqëria.

- Me shkresën e ERE-s nr. 69/1 prot., datë 5.4.2019, iu kërkuar OSHEE sh.a., që të bëjë me dije çdo komunikim me këshillin mbikëqyrës që lidhet me procesin e miratimit të planit të investimeve dhe planit ekonomik të zhvillimit, si dhe të mbante në konsideratë vendimin nr. 46, datë 19.3.2019, të Bordit të ERE-s dhe sa përcaktuar në pikën 5 të këtij vendimi ku kërkohej rishikimi i programit të zhvillimit ekonomik në funksion të gjendjes financiare dhe dërgimin për shqyrtim në ERE, të: i) “Plani i

investimeve për vitin 2019”; dhe ii) përditësimin e “Planit të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes për periudhën 5-vjeçare 2019–2023”, të rivlerësuar në zbatim të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

- Në vijim të kësaj korrespondence, OSHEE sh.a., me shkresën e saj nr. 1708/2, datë 17.4.2019, ka ripërcjellë në ERE, kërkesën për shqyrtim të “Planit të investimeve për vitin 2019”, pjesë e programit financiar të Shoqërisë OSHEE sh.a., si dhe përditësimin e “Planit të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes për periudhën pesëvjeçare 2019–2023”, së bashku me pezullimin e një pjese të planit të investimeve për vitin 2019, si rezultat i situatës të vështirë hidrologjike për furnizimin me energji elektrike dhe kopje të vendimit nr. 6, datë 8.3.2019, të Këshillit Mbikëqyrës.

- Me urdhrin e kryetarit të ERE-s nr. 31, datë 7.5.2019, është ngritur grupi i punës për shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2019 dhe planit të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes për periudhën pesëvjeçare 2019–2023, të shoqërisë OSHEE sh.a.. Shqyrtimi i planit të investimeve u krye në përputhje me kërkesat e “Rregullores së procedurave të paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 135, datë 6.9.2017.

- Me urdhër të kryetarit të ERE-s, u zhvillua një seancë dëgjimore me specialistë e drejtues të OSHEE-së më datë 29.8.2019, ku u diskutuan problematikat e vërejtura në paraqitjen e kërkesës për shqyrtimin e planit të investimeve të vitit 2019, si dhe Planit të zhvillimit të rrjetit 2019–2023.

- Me anë të shkresës 17915 dhe 17915/1, datë 14.9.2019, u riparaqit kërkesa për shqyrtimin e Planit të investimeve të vitit 2019, si dhe Planit të zhvillimit të rrjetit 2019–2023, ku përveç reflektimit të pjesës më të madhe të sugjerimeve ishin reflektuar edhe ndryshime e rialokime të fondeve në investimet prioritare që kishin dalë nga analiza e gjendjes dhe që ishin miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës me vendimet nr. 24, datë 25.7.2019 dhe nr. 26, datë 21.8.2019.

- Neni 75, pika 4, i ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, parashikon që Operatori i Sistemit të



Shpërndarjes kur aplikon për tarifa, paraqet pranë ERE-s planin e përditësuar të investimeve që i korrespondon periudhës përkatëse rregullatore.

- Me vendimin nr. 182, datë 20.8.2018, Bordi i ERE-s është shprehur për miratimin e planit të

zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, për periudhën 5-vjeçare (2018–2022).

- Në kuptim të sa parashikuar në dispozitën ligjore të sipërcituar, plani i zhvillimit të rrjetit, i cili përditësohet, është ai i miratuar me vendimin e ERE-s nr. 182/2018, dhe shtrihet në periudhën 5-vjeçare 2018–2022.

Më poshtë paraqiten në formë tabelare plani i investimeve për vitin 2019:

PLANI I INVESTIMEVE TË OSHEE sha PËR VITIN 2019 (i rishikuar) Lekë		
Nr.	Emertimi i Investimit	Viti 2019
I	Ndertim/rikonstruksion elektrik per Nenstacionet	311,900,000
II	Ndertim/Rikonstruksion linjash te TL	105,592,034
III	Blerje Paisje makineri per N/Stacione dhe likujdim avarish	1,130,000,000
IV	Ndertim Rrjeti TM	96,040,490
V	Ndertim/Rikonstruksion Rrjeti TM/TU	561,190,999
VI	Ndertim/Rikonstruksion kabinash elektrike	1,254,006,254
VII	INVESTIMET PRIORITARE (Rrjet TU - ABC lines)	344,998,428
VIII	Teknologji Monitorimi	170,000,000
IX	INVESTIME NE MATJE	1,300,000,000
X	Vlera 10 % qe do te paguhet nga OSHEE per investimet Bankes Boterore	179,201,439
XI	Kosto lokale per investimet e Bankes Boterore	1,261,899,163
XII	Oponenc, Supervizion, Kolaudim,shpronesime,leje ndertimore etj	260,000,000
	TOTALI	6,974,828,807

Përditësimi i planit të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike:

PLANI I PËRDITËSUAR I ZHVILLIMIT TË RRJETIT TË OSHEE sha						
Nr.	Grup Investimi	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
I	Ndertim/rikonstruksion elektrik per Nenstacionet	128,528,375	311,900,000			
II	Ndertim/Rikonstruksion linjash te TL	229,340,687	105,592,034			
III	Blerje Paisje makineri per N/Stacione dhe likujdim avarish	1,120,000,000	1,130,000,000			
IV	Ndertim Rrjeti TM	87,991,908	96,040,490			
V	Ndertim/Rikonstruksion Rrjeti TM/TU	2,080,515,922	561,190,999			
VI	Ndertim/Rikonstruksion kabinash elektrike	328,656,171	1,254,006,254			
VII	Investime prioritare ne TU (Rrjet TU - ABC lines)	530,234,107	344,998,428			
VIII	Teknologji Monitorimi	221,921,514	170,000,000			
IX	Investimi ne matje	880,000,000	1,300,000,000			
X	Vlera 10% qe do te paguhet nga OSHEE per investimet Bankes Boterore	83,780,512	179,201,439			
XI	Kosto lokale per investimet e Bankes Boterore	540,457,109	1,261,899,163			
XII	Oponenc, Supervizion, Kolaudim,shpronesime,leje ndertimore etj		260,000,000			
	TOTAL	6,231,426,304	6,974,828,807			



- Sa i përket planit të zhvillimit të rrjetit 5-vjeçar 2018–2022 të përditësuar, konstatohet se:

- paraqitja e tij nuk i plotëson kërkesat e “Rregullores e procedurave të paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 135, datë 6.9.2017;

- Mungojnë argumentimet për investimet në kuadër të procesit të ndarjes së shoqërisë OSHEE sh.a. në përputhje me legjislacionin e sektorit të energjisë elektrike.

- Mungojnë argumentimet lidhur me investimet e parashikuara për t’u realizuar përgjatë periudhës 2020–2023, si rrjedhojë e mosrealizimeve përgjatë periudhës paraardhëse.

- Mungojnë argumentimet e shoqërisë lidhur me aftësinë financiare për realizimin e përgjatë periudhës 2020–2023.

Për gjithë sa më sipër, duke marrë në konsideratë që plani i investimeve dhe ai zhvillimit të rrjetit janë publikuar në faqen e internetit të ERE-s dhe nga palët e interesuar nuk ka pasur opinione, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të investimeve për vitin 2019 të shoqërisë OSHEE sh.a.

2. Të miratojë pjesën e planifikuar dhe të realizuar për vitet 2018–2019 të planit të zhvillimit të rrjetit.

3. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes të paraqesë në ERE përditësimin e periudhës së mbetur të planit të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për pjesën e mbetur të periudhës pesëvjeçare 2018–2022, si dhe të rishikojë këtë plan në funksion të ndarjes së shoqërisë OSHEE sh.a. sipas kriterëve të përcaktuara në “Rregulloren e procedurave të paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 135, datë 6.9.2017 dhe të raportojë në ERE për realizimin e investimeve të vitit 2019, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

4. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 228, datë 20.12.2019

MBI KËRKESËN E OST SHA, PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE PËR VITIN 2019 DHE ATË TË PËRDITËSUAR DHJETËVJEÇAR, 2015–2025, TË ZHVILLIMIT TË RRJETIT TË TRANSMETIMIT TË SHOQËRISË OST SHA

Në mbështetje të nenit 16, të nenit 20, germet “a” dhe “e”, nenit 60, pikat 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 6, 7, 8, 10, 11, 12 dhe 13, të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 62, datë 15.9.2009, si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016. Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 114/8 prot., datë 5.12.2019, mbi miratimin e planit të investimeve për vitin 2019 dhe atë dhjetëvjeçar, 2015–2025, të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST sh.a., të përgatitur nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 19, datë 15.2.2019,

konstatoi se:

- Me anë të shkresave nr. 1217 prot., datë 14.2.2019 dhe nr. 1413 prot., datë 22.2.2019, OST sh.a., ka paraqitur në ERE, “Planin e investimeve për vitin 2019” dhe “Programin e zhvillimit ekonomik për vitin 2019”, me miratimet përkatëse nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Këshilli Mbikëqyrës i OST sh.a., ku parashikohen investimet që OST sh.a. do të kryejë për vitin 2019.



- Me urdhrin nr. 19, datë 15.2.2019, u ngrit grupi i punës për të analizuar aplikimin e dërguar nga shoqëria OST sh.a.

- Grupi i punës përgatiti praktikën mbi shqyrtimin e materialeve të dërguara nga OST sh.a., me shkresat e sipërcituara, për të cilën gjatë shqyrtimit të materialeve të dërguara, konstatoi se plani i investimeve kërkonte plotësimet e të dhënave.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 54, datë 3.4.2019, “Për fillimin e procedurave për shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2019, për shoqërinë OST sh.a.”, vendosi:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2019, për shoqërinë OST sh.a., me kusht që shoqëria të depozitojë në ERE, jo më vonë se 15 ditë nga marrja në dijeni e këtij vendimi, aplikimin sipas kushteve të parashikuara në “Rregulloren e procedurave të paraqitjes dhe të miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 135, datë 6.9.2017, të Bordit të ERE-s dhe të plotësojë mangësitë e konstatuara në këtë vendim.

2. OST sh.a. të depozitojë pranë ERE-s, “Planin e investimeve për vitin 2019”, të rishikuar në përputhje me gjendjen financiare dhe likuiditetin e shoqërisë, duke renditur investimet sipas prioritetit.

3. OST sh.a. të depozitojë për shqyrtim në ERE, “Planin e zhvillimit të rrjetit të transmetimit për periudhën 10-vjeçare, 2015–2025”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 212, datë 28.12.2017, të përditësuar sipas kriterëve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe standardeve të ENTSO-E.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, OST sh.a. ka përcjellë në ERE informacion mbi planin e investimeve për vitin 2019, si dhe informacion në lidhje me përditësimin e “Planit të zhvillimit të rrjetit të transmetimit për periudhën 10-vjeçare, 2015–2025”.

- Në datën 17.7.2019, është zhvilluar një seancë dëgjimore me përfaqësuesit e OST sh.a., në të cilën

u kërkuar sqarime të mëtejshme dhe me anë të shkresës nr. 160/12 prot., datë 10.9.2019 janë përcjellë kërkesat për plotësim dokumentacioni.

- OST sh.a., me anë të shkresës nr. 1217/5 prot., datë 17.9.2019, dhe më pas, me anë të shkresës nr. 1217/7 prot., datë 15.11.2019, ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

- vendimi i Këshillit Mbikëqyrës së OST sh.a., për miratimin e planit të investimeve për vitin 2019;

- informacion i detajuar mbi kostot lokale të alokuara për secilin zë të investimeve me fondet e huaja;

- argumente dhe detajime për mbulimin e investimeve me fondet e veta të OST sh.a.;

- informacion analitik mbi realizimin e investimeve për 6-mujorin e parë të vitit 2019;

- analiza kosto-përfitim;

- informacion mbi procesin e konsultimeve me palët e interesuara;

- informacion mbi ndryshimet e planit të investimeve për vitin 2019;

- informacion mbi realizimin aktual të investimeve për vitin 2019;

- informacion mbi masat e marra për rakordimin midis OST sh.a. dhe OSHEE sh.a.;

- raport mbi realizimin e investimeve për vitin 2018;

- plani 10-vjeçar, 2015–2025, i zhvillimit të rrjetit të transmetimit;

- të dhëna mbi investimet e periudhës 2015–2025.

- Për projektet e propozuara për t’u investuar përgjatë vitit 2019, shoqëria ka bërë me dije se do të ndikojnë në përmirësimin e kapaciteteve transmetuese në drejtim të përmirësimit të performancës së sistemit dhe çështje të tjera që lidhen me performancën e operatorit të transmetimit, së bashku me 2 projekte të parashikuara, të zhvillohen gjatë vitit 2019, në kuadër të përditësimit të planit 10-vjeçar të zhvillimit të rrjetit.

Plani i investimeve për vitin 2019 paraqitet në vijim:



PLANI I INVESTIMEVE TË OST sha PËR VITIN 2019 (Me fondet e veta)			Vlera totale e investimit	Vlera e realuar gjatë vitit 2018	Vlera për t'u realizuar gjatë vitit 2019
2	Furnizim vendosje e Shunt reaktorit 400kV 120 MVar, Sistemit Total te monitorimit te tij, Konfigurimin ne sistemin SCADA, furnizimin dhe vendosjen e Traktit 400 kV ne N/st Zemblak si dhe kryerja e te gjitha punimeve civile ne lidhje me kete projekt.		543,142,511	502,518,427	40,624,084
3	Rikonstruksioni i linjave 110 kV Laç2-Ura e Matit dhe Skuraj Ura e Matit		194,391,996	-	97,195,998
4	Rehabilitimi i trakteve te linjave 110 kV te nenstacionit Jagodine		187,048,800	37,409,760	149,639,040
5	Ndertimi i linjes 110 kV N/st Sallmone – Gjiri i Lalezit		182,877,079	36,575,416	133,575,302
6	Rehabilitimi i trakteve te linjave 110 kV te nenstacionit F.Arrez		156,942,900	31,388,580	113,312,490
7	Rehabilitimi i trakteve te linjave 110 kV te nenstacionit Ibe		97,210,290	19,442,058	77,768,232
8	Rehabilitimi i trakteve te linjave 110 kV te nenstacionit Plamas		95,161,092	19,032,218	76,128,874
9	Rehabilitimi i trakteve te linjave 110 kV te nenstacionit Kajan		105,633,163	21,126,633	84,506,530
10	Rehabilitimi i trakteve te linjave 110 kV te nenstacionit Prenjas		106,934,131	21,386,826	76,646,281
11	Rikonstruksioni i anes 110 kV te nenstacionit Rubik		125,308,324	77,511,061	47,631,371
12	Rehabilitimi i trakteve te linjave 110 kV te nenstacionit Librazhd		99,946,077	19,989,214	79,956,863
13	Aksesi dhe monitorimi i rrjetit te transmetimit te sistemeve te komunikimit me kapacitete		64,119,000	51,295,000	12,824,000
14	Instalimi i OPGW ne linjen 220 kV Burrel – Elbasan 1		60,491,245	12,098,249	48,392,996
15	Implementimi i Sistemit te Analizimit te Rrjetit nepermjet PMU (Phasor Measuring Unit)		39,514,000	27,468,000	12,046,000
16	Ndertimi i Magazines prane N/stacionit Tirana2		36,503,650	7,300,730	29,202,920
17	Furnizim vendosje e traktit te linjes 110-13 ne N/stacionin Lac1 dhe punime civile		31,704,481	6,340,896	25,363,585
18	Plotesimi dhe venia ne pune e Traktit 110 kV ne nestacion Fier per N/stacionin 110/20 kV te OSHEE + trainimi i personelit Inxhiniero –teknik te DSHMT		40,952,000	8,190,400	32,761,600
19	Sistemi i problematikave te drenazhit ne Nenstacionit Tirana2		14,669,675	2,933,935	11,735,740
20	Nderrhyrje ne linjat e transmetimit 110/220 kV te rajonit te Njesise Operative Shkoder		19,205,818	3,841,164	15,364,654
21	Mbikqyrja e punimeve per objektet e reja.		34,637,000	12,536,763	22,100,237
22	Ngritja e nje sistemi per lokalizimin e avarive ne linjat e trasmetimit. Blerje, instalim, konfigurim i serverit per analizatoret e vajit te AT -ve dhe celsave te nivellit 110kV e lart.		158,000,000	52,720,000	105,280,000
23	Furnizim i nje celsi te ri 245 kV me gas SF6 si dhe pjese reserve te tij dhe per celsat aktual, 3(tre) analizatore per celsat e niveleve te ndryshme tensioni si dhe 2(dy) pajise mbrojtjeje, automatizimi dhe monitorimi.		49,086,000	23,122,000	25,964,000
24	Lyerja e shyllave te transmetimit te TL.		74,722,297	-	74,722,297
25	Integrimi i N.st. Elbasan 1 dhe Elbasan 2 ne sistemin e monitorimit dhe programimit online te Sistemit te Mbrojtjes RELE		19,145,000	-	19,145,000
26	Ndertim i linjes 220 kv me dy qarqe Komsit- Shumat				220,000,000
27	Ndertim i N/st 220/110 kV, 1x120 MVA Shumat (Peshkopit)		700,000,000	-	146,132,000
28	Linja 110kv N/St Fiber -Librazhd		450,000,000	-	80,000,000
29	Punime per perfundimin e linjes kablore 110 kV Tirana-Selite dhe lidhja me nenstacionin 110/20 kV Kombinat		100,000,000	-	83,000,000
30	Furnizim dhe vendosje e celave rezerve 20 kV dhe 35 kV per N/st Tirana1 dhe pjese kembimi per keto celsa		45,000,000	-	45,000,000
31	Nderrhyrje per rastet emergjence ne linjat e TL.		40,000,000	-	40,000,000
32	Blerje Paneleve te mbrojtjes dhe komandimit per trakte 110 kV		50,000,000	-	50,000,000
33	Blerje materiale per nenstacione		100,000,000	-	100,000,000
34	Blerje materiale dhe vegla punet e sigurimit teknik si dhe pajset per testimin e mjeteve te sigurimit teknik		30,000,000	-	30,000,000
35	Upgrade i sistemit te kontrollit dhe BCU te N/st 220 kV Koplik		36,000,000	-	36,000,000
36	Upgrade Hardware-Software i sistemit te kontrollit te nenstacionit 400/220/110kV Tirana 2		38,000,000	-	29,488,200
37	Blerje programi kompjuterik per analizen e rrjetit		12,000,000	-	12,000,000
38	Blerjen e dy licensave USB per program kompjuterik PSS/E per analizen e rrjetit		12,000,000	-	8,315,000
39	Mbikqyrje e punimeve gjate zbatimit te kontratave		13,000,000	-	13,000,000
40	Punime civile per rikonstrukson te traktit te linje 110 kV Fier Kuçovë				10,000,000
41	Punime Riparuese për godinën e n/St zemlak				9,000,000
42	Punime Riparuese për godinën e n/St Rashbull dhe magazinën qendrore të OST				5,000,000
					2,328,823,293
Investim i ri i Propozuar					
42	Autotransformatori AT2 300 mva , 400/220 N/Stac. Tirana 2		420,000,000		420,000,000
TOTALI I INVESTIMEVE			4,163,346,529	994,227,330	2,748,823,293

Plani i përditësuar 10-vjeçar, 2015–2025, i zhvillimit të rrjetit të transmetimit:

	OBJEKTET	Tipi i përcjellësit (mm ²)	Gjatësia (km)	Fuqia (MVA)	Viti i Komisionimit	Vlera (Euro)
1	Linja me një qark Skuraj - Laç-1	ACSR 240/40	12.7	-	2019	1,800,000
2	Linja me një qark Skuraj -Laç-2	ACSR 240/40	10.1	-		
3	Linja me dy qarqe Laç2-Laç1	2xACSR 240/40	2.7	-		
4	Linjë e re 110 kV, Sukth-Gj.Lalzit, dy dalje linje 110 kV	ACSR 240/40	18	-	2019	1,900,000
5	Përforcim Linje 110 kV, Elbasan1-Fibër, Fibër-Librazhd	2 x ACSR 240/40	30	-	2019	3,000,000
6					2020	
7					2021	
8					2022	
9					2023	
10					2024	
					2025	



- Mungojnë argumentet për parashikimin e investimeve të nevojshme dhe burimet e financimit lidhur me investimet për fibrat optike në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike për dhënie në përdorim palëve të treta.

Për gjithë sa më sipër, duke marrë në konsideratë që plani i investimeve dhe ai i zhvillimit të rrjetit janë publikuar në faqen e internetit të ERE-s dhe nga palët e interesuar nuk ka pasur opinione, Bordi i ERE-s:

VENDOSI:

1. Të miratojë planin e investimeve të OST sh.a. për vitin 2019.

2. Të miratojë pjesën e planifikuar për vitin 2019 të planit të zhvillimit të rrjetit.

3. OST sh.a. të përditësojë pjesën e mbetur të planit dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit, sipas kriterëve të përcaktuara në “Rregulloren e procedurave të paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 135, datë 6.9.2017, dhe të raportojë në ERE për realizimin e investimeve të vitit 2019, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

4. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë OST sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 229, datë 20.12.2019

MBI MIRATIMIN E “RREGULLORES PËR LËSHIMIN, TRANSFERIMIN DHE ANULIMIN E GARANCIVE TË ORIGINËS PËR ENERGJINË ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA BURIMET E RINOVUESHME”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 16, pika 13, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, si dhe të nenit 26, të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.12.2019, mbasi shqyrtoi draftin dhe relacionin nr. 100/1-1 prot., datë 18.12.2019, të përgatitur nga drejtoritë teknike, në lidhje me miratimin e “Rregullore për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, konstatoi se:

- Neni 16, pika 13, i ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, i jep të drejtën ERE-s të miratojë një rregullore të veçantë për krijimin e një sistemi të saktë, të besueshëm e të mbrojtur nga abuzimet për lëshimin, transferimin dhe revokimin e garancive të origjinës.

- Me vendimin nr. 96, datë 20.4.2018, Bordi i ERE-s ka filluar procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e draftrregullore së veçantë për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës.

- Me shkresën nr. 55/24 prot., datë 30.4.2018, për fillimin e procedurës së miratimit të rregullore së veçantë për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës, u realizua botimi në medien e shkruar, në zbatim të parashikimeve të “Rregullore së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”.

- Me shkresën tonë nr. 362 prot., datë 7.5.2018, iu dërgua palëve të interesit kjo rregullore, me qëllim mbledhjen e mendimeve apo të vërejtjeve të tyre në lidhje me draftin e hartuar.



- Në përfundim të afatit për marrjen e komenteve, kanë mbërritur në ERE komentet e Autoritetit të Konkurrencës, i cili ka bërë më dije se përmbajtja e kësaj draftrregulloreje, nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar.

- Kjo rregullore i është përcjellë gjithashtu edhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, për komente me korrespondencë elektronike zyrtare, nga të cilët nuk ka pasur asnjë koment lidhur me këtë rregullore.

- Me qëllim përgatitjen e një drafti të përmirësuar në përmbajtje, duke iu përmbajtur parashikimeve të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” dhe praktikave të ngjashme bashkëkohore evropiane lidhur me lëshimin e garancive të origjinës, u konstatua nevoja e reflektimit dhe e qasjes së disa parashikimeve që mungonin në draftin fillestar, që lidhen kryesisht me:

- procesin e kualifikimit teknik të impianteve prodhuese, si një fazë që paraprin procesin e certifikimit me garancinë e origjinës për energjinë e prodhuar nga burime të rinovueshme;

- plotësimin e formatit të aplikimit në formë tabelare, duke ndjekur të njëjtën praktikë me atë të rregullores së licencimit, duke qenë se vetë procesi i certifikimit sipas parashikimeve të ligjit 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, kalon në faza të ngjashme të shqyrtimit dhe të dokumentacionit të nevojshëm për depozitim;

- afatet gjatë të cilave do të shtrihet procedura e shqyrtimit të një aplikimi, për të marrë parasysh marrjen e certifikatës së garancisë së origjinës; dhe

- nevoja e krijimit të një *database* për regjistrin e garancive të origjinës, i cili në zbatim të kërkesave të ligjit të reflektojë në kohë reale statusin e çdo certifikate të garancisë së origjinës të lëshuar nga ERE, modifikimit të saj apo transferimit.

- Në vijim të ndryshimeve që ka pësuar draftrregullorja, me shkresën nr. 611 prot., datë 30.9.2019, drafti iu dërgua edhe njëherë MIE-s, Autoritetit të Konkurrencës, OST sh.a., OSHEE sh.a. dhe AKBN-së.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me shkresën 8447/1 prot., datë 8.11.2019, ka sqaruar se është parimisht dakord me përmbajtjen e draftit të propozuar, por ka paraqitur komentet dhe

opinionet të cilat janë pranuar dhe reflektuar në këtë rregullore.

- Shoqëria OSHEE sh.a., me shkresën 8447/1 prot., datë 8.11.2019, ka sugjeruar disa ndryshime të cilat janë reflektuar në këtë rregullore.

- Në vijim u paraqitën komente nga shoqëria OST sh.a., me shkresën nr. 6494/1 prot., datë 14.10.2019, ku sipas saj konstatohet nevoja për një rishikim dhe një bashkërendim të disa pikave, të cilat pasi janë analizuar, janë reflektuar në këtë Rregullore.

- Në këtë Rregullore, janë reflektuar parimet e parashikuara në pikën 12, të nenit 15, të direktivës së BE-së nr. 2009/28/EC, “Mbi nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme dhe ndryshimin dhe më pas shfuqizimin e direktivave 2001/77/EC dhe 2003/30/EC”, e cila është direktiva mbi të cilën është hartuar ligji nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” dhe neni 16 i këtij ligji, i cili trajton garancitë e origjinës.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë “Rregulloren për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme” (bashkëlidhur).

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**RREGULLORE****PËR LËSHIMIN, TRANSFERIMIN DHE
ANULIMIN E GARANCIVE TË ORIGJINËS
PËR ENERGJINË ELEKTRIKE TË
PRODHUAR NGA BURIMET E
RINOVUESHME****PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME****Neni 1
Autoriteti**

Kjo rregullore hartohet në zbatim të nenit 16, pika 13, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, si dhe në përputhje me “Rregulloren e organizimit funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016.

**Neni 2
Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të krijojë kuadrin e nevojshëm rregullator për krijimin e një sistemi të saktë, të besueshëm e transparent për lëshimin, transferimin dhe revokimin e garancive të origjinës, duke siguruar një trajtim të barabartë e të drejtë, për të gjithë prodhuesit e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, lidhur me lëshimin, transferimin apo revokimin e garancive të origjinës.

**Neni 3
Objekti**

Kjo rregullore përcakton kriteret, procedurat dhe afatet për lëshimin e garancisë së origjinës (GO), përfshirë procedurën teknike të kualifikimit dhe, veçanërisht, kufirin kohor, në të cilin ERE përgjigjet për aplikimet e dorëzuara dhe dokumentacionin teknik që do të paraqitet nga aplikuesi.

**Neni 4
Zbatimi**

4.1 Kjo rregullore do të zbatohet në përputhje me direktivën 2009/28/EC për lëshimin e

garancisë së origjinës nga ERE, për prodhuesit që shfrytëzojnë burime energjie të rinovueshme:

a) nga impiante të cilat janë vënë në operim pas datës 25.6.2009;

b) nga kapacitetet e shtuara të impianteve ekzistuese, të cilat janë vënë në operim pas datës 25.6.2009.

4.2 Rregullorja do të zbatohet edhe për aplikimet për regjistrim, revokim dhe transferim të GO-së.

**Neni 5
Përkufizime**

Fjalët dhe frazat e mëposhtme të përdorura në këtë Rregullore do të kenë kuptimet e mëposhtme:

1. “Ligj” do të thotë ligji nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.

2. “Bordi” do të thotë organi vendimmarrës i ERE-s që funksionon sipas dispozitave të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

3. “Enti Rregullator i Energjisë” ose “ERE” është autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe i gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.

4. “I licencuar” do të thotë një person që mban një licencë të dhënë sipas pjesës së katërt të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

5. “Garancia e origjinës (GO)”, është një dokument elektronik, i cili ka funksion të vetëm që t’i provojë konsumatorit fundor, se një pjesë ose e gjithë sasia e energjisë elektrike të përdorur prej tij është prodhuar prej burimeve të rinovueshme.

6. “Energjia nga burimet e rinovueshme” është energjia nga burime të rinovueshme jofosile, përfshirë energjinë nga era, dielli, energjia aerotermike, energjia gjeotermike, energjia hidrotermike dhe energjia e oqeanëve, energjia hidrike, biomasa, gazi i grumbulluar në landfille, gazi që grumbullohet nga trajtimi i ujërave të zeza dhe biogazet.

7. “Biomasa” është pjesa e biodegradueshme e produkteve, mbeturinave dhe mbetjeve me origjinë biologjike nga veprimtaria bujqësore (përfshirë



lëndë bimore dhe shtazore), pyjore dhe nga industri të lidhura me to, përfshirë peshkimin dhe akuakulturën, si edhe pjesa e biodegradueshme e mbeturinave industriale, urbane dhe rurale.

8. “Energji gjeotermike” është energjia e depozituar në formën e nxehtësisë në sipërfaqen e tokës.

9. “Biogazi” është përzierja e gazit metan me dyoksid karboni, e prodhuar nga dekompozimi bakterial i mbetjeve organike dhe që përdoret si lëndë djegëse për prodhimin e energjisë elektrike.

10. “Kërkues” do të thotë prodhues i energjisë elektrike që kërkon të pajiset me garancinë e origjinës për energjinë elektrike të prodhuar.

11. “Implant prodhues i energjisë elektrike nga burime të rinovueshme” është një implant që prodhon energji elektrike nga burime të rinovueshme.

12. “Prodhues hibrid” është implanti elektrik, i cili përdor të dyja llojet e burimeve të energjisë, të rinovueshme e jo të rinovueshme, për prodhimin e energjisë elektrike.

13. “Rezervë pompimi” do të thotë një sistem hidroelektrik në të cilin energjia elektrike prodhohet gjatë periudhave të pikut të kërkesës, nga përdorimi i ujit që është pompuar në një rezervuar në një lartësi më të madhe, gjatë periudhave jo të pikut, me kërkesë më të ulët për energji elektrike.

14. Fjalët dhe frazat e përdorura në këtë rregullore, të cilat nuk janë përkufizuar më sipër, do të kenë kuptimin që parashikohet në ligjin nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, si dhe ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

PJESA E DYTË

PROCEDURAT E APLIKIMIT PËR GO-në

Neni 6

Klasifikimi i impianteve të energjisë elektrike

Tipat e teknologjive prodhuese të cilët mund të përfitojnë GO janë përshkruar në tabelën 1.1.

Tabela 1.1. Klasifikimi i prodhuesve të energjisë, të cilët gjenerojnë energji nga burime të rinovueshme

Tipi i implantit		Nëntipi i implantit	Burimi
Hidro		Rrjedhe lumi Rezervuar Basen Kanal derivacioni	Ujë
Era (eolike)		Të vendosur në det (onshore), në tokë (offshore)	Era
Gjeotermale		-	Energjia gjeotermike
Diellore (fotovoltaik)		Fotovoltaik	Energji diellore
Termale		Avulli Djegia e brendshme Çikël i kombinuar Gazi Të tjera	Biomasa***
			Biogaz
Hibrid*	Bashkëdjegie ** Të tjera	- -	Burime konvencionale Burime të rinovueshme

* Implantet hibride gjenerojnë energji elektrike nga përdorimi i burimeve të rinovueshme dhe jo të rinovueshme dhe përfshijnë implantet me bashkëdjegie.

** Bashkëdjegia përkufizohet si djegia njëkohësisht e lëndëve djegëse dhe trupave të ngurtë jo të rinovueshëm dhe lëndëve të lëngëta ose gazore të përfuara nga burime të rinovueshme. Nëntipi i implantit është i njëjtë me atë të impianteve termike.

*** Biomasa, d.m.th. pjesa e biodegradueshme e produkteve, mbetjeve dhe hedhurinave që vijnë nga bujqësia (përfshirë lëndët bimore, shtazore) pylltaria dhe industrinë e lidhura me to, si dhe pjesa e biodegradueshme e mbeturinave industriale dhe urbane.



Neni 7

Kërkesat për dhënien e GO-së impianteve prodhuese

7.1 Prodhuesi i cili dëshiron të marrë garancinë e origjinës së impiantit prodhues, paraqet në ERE një kërkesë specifike me shkrim, duke përfshirë të gjithë informacionin e kërkuar nga ligji nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” dhe atë të parashikuar në aneksin 1 të kësaj rregulloreje. Aplikuesi duhet të paraqesë dokumente të përshtatshme të certifikuara nga autoritetet publike kompetente.

7.2 Garancia e origjinës për një impiant prodhues të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme lëshohet vetëm një herë në 12 muaj, me përjashtim të rasteve kur janë kryer ndryshime të mëdha në impiantet prodhuese të energjisë elektrike të cilat janë të pajisura me parë me GO.

7.3 Kërkesa për GO-në mund të paraqitet për një impiant prodhues energjie të rinovueshme që ka hyrë në prodhim.

7.4 Kërkesa për lëshimin e GO-së përfshin:

a) burimin e energjisë, nga i cili prodhohet energjia;

b) datën e fillimit e të përfundimit të prodhimit;

c) emrin, vendin, tipin dhe kapacitetin e impiantit ku është prodhuar energjia;

ç) nëse prodhuesi ka përfituar prej mbështetjes me investime ose nga skema të tjera të mbështetjes në nivel kombëtar dhe masën e këtij përfitimi;

d) datën e autorizimit të impiantit dhe kohën kur është futur në punë;

e) një raport teknik specifik që përshkruan tipin e teknologjisë gjeneruese, siç përcaktohet në tabelën (1.1) e sipërpërmendur në nenin 6;

ë) një dokument teknik i cili përshkruan karakteristikat bazë të prodhuesit të energjisë, përfshirë anekset teknike nëse ka;

f) çdo dokument tjetër të lëshuar që dëshmon kolaudimin dhe komisionimin e impiantit prodhues të energjisë;

g) miratimin e pikës së lidhjes nga operatorët e sistemit të transmetimit e të shpërndarjes, bazuar në kërkesën e prodhuesit të energjisë nga burimet e rinovueshme dhe në përputhje me kodet dhe rregulloret e miratuara nga ERE.

7.5 Dokumentacioni teknik përmban

1. Përshkrimin e përgjithshëm i impiantit:

a) burimet e energjisë (të rinovueshme ose fosile në rastet e impianteve hibride);

b) tipi i impiantit;

c) kapaciteti nominal, i cili përbëhet nga shuma e kapacitetit nominal të secilës prej njësive gjeneruese të energjisë;

d) prodhimin e pritshëm vjetor.

2. Dokumentet vijuese grafik:

a) paraqitjen e përgjithshme skematike të impiantit në format A1, planimetria e përgjithshme e impiantit;

b) skema funksionale;

c) skema elektrike ku identifikohen aparatet matës të gjenerimit të energjisë elektrike.

3. Përshkrimi i impiantit duhet të jetë edhe më i detajuar, për:

a) hidrocentralet me sistemin e rezervës së pompimit, prej ujit të pompuar më parë nga poshtë lart, në mënyrë që të llogariten sasitë e energjisë që i përkasin kësaj rezerve pompimi, mbasi kjo sasi energjie përjashtohet nga sasia e energjisë elektrike të prodhuar për të cilën lëshohet GO;

b) impiante që djegin mbetje, me qëllim llogaritjen e pjesës së energjisë elektrike të prodhuar, që i takon pjesës së biodegradueshme të mbetjeve, pasi vetëm për të lëshohet GO.

Neni 8

Procedura teknike e kualifikimit

8.1 Prodhuesi që dëshiron të marrë kualifikimin e impiantit gjenerues të energjisë së rinovueshme duhet të paraqesë në ERE një kërkesë me shkrim, përfshirë të gjitha informacionet e kërkuara nga legjislacioni në fuqi dhe këto rregulla.

8.2 Kualifikimi i një impianti gjenerues bëhet vetëm një herë, përveç nëse kanë ndodhur ndryshime të mëdha në impiantin e energjisë së rinovueshme të kualifikuar më herët.

8.3 Kërkesa për kualifikim përfshin:

a) një raport specifik teknik që përshkruan llojin e teknologjisë së gjenerimit;

b) një dokument teknik që përshkruan karakteristikat themelore të gjeneratorit, përfshirë:

i. anekse teknike, nëse ka;

ii. çdo dokumentacion tjetër i lëshuar, duke siguruar prova të testimit dhe komisionimit të impiantit të gjenerimit;

c) dokumenti teknik përfshin:

Përshkrimi i përgjithshëm i impiantit, siç janë:

i. burimet e energjisë (të rinovueshme ose jo);



ii. lloji i impiantit;

iii. kapacitetin e instaluar që është shuma e kapacitetit nominal të turbinave, paneleve ose motorëve, siç raportohet në targën e tyre;

iv. prodhimi vjetor i pritshëm;

d) dokumentet grafike të mëposhtme:

i. planimetria e përgjithshme;

ii. skema funksionale;

iii. skema elektrike që synon në identifikimin e elementeve të impiantit të certifikuar nga operatori i sistemit përgjegjës;

e) përshkrimi i impiantit duhet të jetë edhe më i detajuar në rastet, kur kemi të bëjmë me:

i. hidrocentrale me sistemin e rezervës së pompuar, prej ujit të pompuar më parë nga poshtë lart, për të llogaritur përqindjen e energjisë së përdorur për këtë qëllim, duke marrë parasysh që kjo sasi e energjisë elektrike është e përjashtuar nga e drejta për GO-në;

ii. impiante hibride, duke pasur parasysh që vetëm për energjinë e prodhuar nga burime të rinovueshme mund të ketë të drejtë për t'u pajisur me GO-në;

iii. impiantet e djegieve të mbetjeve, me qëllim që të llogaritet sasia e energjisë që i përket pjesës së biodegradueshme e mbetjeve, duke pasur parasysh që vetëm kjo mund të jetë e pranueshme për t'u klasifikuar për GO-në.

8.4 Operatori i Sistemit përgjegjës do të përcjellë në ERE çdo të dhënë që i shërben ERE për vlerësimin e kualifikimit teknik të aplikuesit, brenda 30 ditëve nga aplikimi për kualifikim, sipas këtyre rregullave.

Neni 9

Fillimi i procedurave të lëshimit të GO-së

9.1 ERE, në përputhje me “Rregullat e organizimit, funksionimit dhe procedurave të saj”, kur e gjykon të arsyeshme, mbështetur në dokumentacionin e depozituar nga aplikanti, merr vendim për fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës për pajisjen me GO-në.

9.2 ERE në çdo rast i bën me dije aplikuesit pranimin apo refuzimin e kërkesës për shqyrtimin në kuptim të nenit 1, jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e depozitimit të aplikimit.

9.3 ERE mund të kërkojë çdo sqarim, si dhe të japë të gjithë informacionin e nevojshëm për palët në proces.

Neni 10

Shqyrtimi i aplikimit për GO-në

10.1 Pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës së shqyrtimit, sipas nenit 9 të kësaj rregulloreje, brenda 60 ditëve, ERE shqyrton aplikimin dhe informon kërkuarësin për vendimin e Bordit mbi lëshimin GO ose refuzimin e kërkesës së tij. ERE vendos për lëshimin e GO-së të prodhuesit të energjisë së rinovueshme:

a) që furnizohet nga një impiant i prodhimit të energjisë direkt në rrjetin publik të shpërndarjes;

b) përdoret për konsum të vetë prodhuesit të energjisë elektrike.

10.2 Brenda periudhës së përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, Bordi merr vendim, për:

a) lëshimin e GO-së së kërkuar, i cili regjistrohet në regjistrin elektronik të garancive të origjinës që mbahet nga ERE;

b) Refuzimin e lëshimit të GO-së, në rast se subjekti nuk përmbush kërkesat e nevojshme, procedurën apo dokumentacionin e kërkuar, sipas nenit 16, pika 13, germa “b”, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.

10.3 Në çdo rast të vendimit për refuzim të GO-së, ERE arsyeton vendimin për refuzimin. Kur ERE konstaton se kërkesa për pajisje me GO, e paraqitur nga aplikuesi, nuk përmban dokumente të rëndësishme që pengojnë ERE-n në verifikimin e përmbushjes së kriterëve të kësaj rregulloreje, ERE specifikon që dokumentacioni është jo i plotë.

10.4 ERE mund të refuzojë njohjen e garancisë së origjinës kur ka dyshime të bazuara për saktësinë, besueshmërinë ose vërtetësinë e saj. ERE njofton Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për çdo refuzim, së bashku me arsyet për të. Mendimi i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë merret parasysh nga ERE në njohjen e garancive të origjinës.

10.5 ERE mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, kur dokumentacioni nuk është i plotë por jo më shumë se 30 ditë. ERE specifikon dokumentet që mungojnë ose janë jo të plota, të cilat duhet t'i paraqiten ERE-s brenda 30 ditëve në vijim. Në vijim të analizës së dokumentacionit shtesë, kërkesa mund të pranohet ose të refuzohet. Nëse dokumentacioni i munguar apo shtesë nuk



dërgohet brenda 30 ditëve nga data e njoftimit nga ERE, kërkesa refuzohet, për shkak të mosplotësimit të dokumentacionit të nevojshëm.

10.6 ERE, kur e sheh të arsyeshme mund të kërkojë verifikimin e çdo informacioni të nevojshëm nga organet kompetente, duke vënë në dijeni kërkuuesin për këtë.

10.7 Në çdo rast të marrjes së vendimit nga Bordi për refuzimin e kërkesës për pajisje me GO, aplikuesi mund të paraqesë një kërkesë të re, duke marrë në konsideratë udhëzimet e ERE-s.

Neni 11

Lëshimi i garancive të origjinës (GO)

11.1 Prodhuesi mund të paraqesë kërkesë për pajisjen me GO, për sasinë e energjisë elektrike realisht të prodhuar, në bazë vjetore, nga impiantet prodhues të energjisë, siç përshkruhet në nenet 7, 8, 9 dhe 10 dhe pas vënies në punë të impiantit prodhues. Data e operimit të impiantit prodhues për herë të parë, e lidhur me rrjetin elektrik, duhet të jetë pas datës së lidhjes së kontratës për shitblerjen e energjisë elektrike.

11.2 Garancia e origjinës lëshohet, për:

a) një njësi të energjisë elektrike 1 mwh;
b) sasinë e prodhuar në vit, të energjisë elektrike, nga hidrocentralet përveç sasisë që u atribuohet rezervave të pompimit të gjithë prodhimit vjetor të energjisë elektrike nga hidro (ujore), eolike (era), diellore (fotovoltaike), gjeotermike, batica dhe zbatica, biomasa dhe biogazi.

c) sasinë e prodhuar të energjisë elektrike që i takon pjesës së biodegradueshme të mbetjeve urbane dhe industriale, të cilat digjen brenda impianteve termike.

11.3 ERE, sipas kërkesave do të lëshojë çdo vit GO për energjinë elektrike realisht të prodhuar nga impianteve dhe vetëm në rastet se/kur impianti është në punë. Çdo GO i korrespondon 1 mwh energji elektrike të hedhur në rrjet (në muaj), në përputhje me legjislacionin në fuqi.

11.4 Çdo GO e lëshuar nga ERE përmban datën, vendin e lëshimit të garancisë dhe një numër identifikimi unik, si dhe regjistrohet në regjistrin elektronik të garancive të origjinës që mbahet nga ERE të përshkruar në aneksin 2 të kësaj rregulloreje. Çdo përdorim i një garancie origjine bëhet brenda 12 muajve nga data e prodhimit të njësisë korresponduese të energjisë elektrike.

Garancia e origjinës anulohet menjëherë, pasi është përdorur.

Neni 12

Ndryshime në detajet teknike të regjistruara

12.1 Prodhuesi duhet të informojë ERE-n për çdo modifikim të ndodhur në impiantet prodhuese të energjisë, në përputhje me këtë rregullore.

12.2 Në rastet e impianteve në proces modifikimi, qëllimi i komunikimit të sipërpërmendur është të monitorojë realizimin e modifikimit dhe të krahasojë karakteristikat finale teknike të tij me ato të komunikuar fillimisht së bashku me certifikatën e GO-së.

12.3 Prodhuesi duhet t'i komunikojë ERE-s:

a) çdo modifikim të mundshëm të detajeve teknike lidhur me impiantin (si, p.sh., ndryshime të fuqisë së instaluar, lloji i mbetjeve të përdorura etj.) fillimin e punës në rast të një ndërtimi të ri dhe datën e kolaudimit;

b) datën e fillimit të operimit për llogaritjen e periudhës së marrjes së GO-së.

12.4 Data e operimit të impiantit prodhues për herë të parë, të lidhur me rrjetin elektrik duhet të certifikohet nëpërmjet aktit të kolaudimit të mbajtur, në bazë të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, si dhe në përputhje me rregullat e lidhjes së një impianti me sistemin elektroenergjetik, Kodit të Rrjetit mbi kërkesat për lidhjen me rrjetin të gjeneruesve dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi.

12.5 Në rast se modifikimi i përshkruar apo modifikimi, për të cilin vihet në dijeni ERE, e bën projektin jo të përputhshëm me legjislacionin, GO e lëshuar me vendim të Bordit do të anulohet.

12.6 Në çdo kohë për të verifikuar saktësinë e të dhënave të depozituara, ERE ka të drejtë të kërkojë të dhëna shtesë apo dhe të monitorojë në vend impiantin prodhues.

Neni 13

Transferimi i GO-së

13.1 Garancia e origjinës mund të transferohet, veçmas ose së bashku me transferimin fizik të energjisë, dhe nuk do të ketë efekt në vendimin për të përdorur mekanizmin e bashkëpunimit për arritjen e objektivit apo në llogaritjen e konsumit final bruto të energjisë nga burime të rinovueshme,



në përputhje me nenin 4 të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.

13.2 Në çdo rast që një GO transferohet subjekti mbajtës i GO-së njofton ERE jo më vonë se 24 orë nga transferimi.

Neni 14

Afatet kohore kufi të aplikueshme

14.1 Garancia e origjinës lëshohet për një periudhë 12-mujore dhe shteron fuqinë e saj, me përfundimin e këtij afati, të shprehur edhe në certifikatën e lëshuar nga ERE.

14.2 Pas lëshimit të certifikatës së parë të garancisë së origjinës, çdo aplikues që paraqet në ERE një kërkesë për certifikatë garancie origjine, do të depozitojë në ERE, për qëllime të këtij aplikimi vetëm dokumentacionin që ka pësuar ndryshim referuar kërkesave të nenit 7 të kësaj rregulloreje.

14.3 ERE do të shqyrtojë dhe do të shprehet për kërkesën për miratimin e garancisë së origjinës së aplikuesit parashikuar në 14.2, jo më vonë se 30 ditë nga aplikimi.

14.4 ERE, në çdo rast që merr dënim për shkelje të kushteve për të cilat është dhënë certifikata e garancisë, mund të shprehet me vendim për anulimin e certifikatës së garancisë, me të njëjtën praktikë me të cilën ka vendosur për miratimin e saj.

Neni 15

Llogaritja e energjisë

15.1 Paragrafët në vijim përshkruajnë llogaritjen e energjisë neto E_{cv} që përfiton GO. Energjia e llogaritur nga prodhuesit duhet të jetë në përputhje me tipin e prodhuesit të energjisë dhe të dhënat teknike të përshtatshme. ERE ka të drejtë të verifikojë dhe t'i paraqesë prodhuesit një vlerësim të ndryshëm të energjisë.

15.2 Prodhimi neto i një prodhuesi energjie është prodhimi bruto duke zbritur energjinë e marrë për nevojat vetjake dhe humbjet në transformatorët në gjenerim.

15.3 E gjithë energjia neto e prodhuar nga një prodhues i ri energjie i ushqyer plotësisht nga burime energjie të rinovueshme mund të përfitojë GO-në.

Neni 16

Inspektimet teknike

16.1 Për të siguruar përmbushjen e kushteve të lëshimit të garancisë së origjinës dhe se të dhënat, mbi të cilat është lëshuar ajo, janë ta sakta, përfaqësuesit e ERE-s dhe çdo person i autorizuar prej saj, pa paragjykitime lidhur me respektimin e sekretit tregtar, kanë akses të lirë në impiantin përkatës të prodhimit dhe në të gjitha të dhënat dhe informacionin për impiantin në fjalë.

16.2 Prodhuesi është i detyruar të lehtësojë punën e përfaqësuesve të ERE-s dhe të personave të autorizuar prej tij. Në rastet e deklarimit jo të vërtetë kualifikimi anulohet dhe çdo e drejtë e lidhur me këtë humbet. ERE rezervon të drejtën e marrjes së masave administrative, në rastet e konstatimit të përsëritur të deklarimit të të dhënave të rreme.

PJESA E TRETË

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 17

Bashkëpunimin me autoritetet kompetente

Garancia e origjinës e dhënë në Shqipëri do të njihet edhe nga autoritetet kompetente të vendeve anëtare të BE-së dhe vendeve të tjera, me të cilat vendi ynë ka marrëveshje të nënshkruara për njohjen e ndërsjellë të garancive të origjinës.

Neni 18

Amendime të rregullores

Kjo rregullore është objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit, në përputhje me “Rregulloren e organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”.

Neni 19

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore u miratua me vendimin e Bordit të ERE-s nr. __, datë __. __. 2019, dhe hyn në fuqi pas publikimit të saj në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.



ANEKS 1

1. Formati i aplikimit:

a) Të dhëna për aplikimin (të plotësohen nga aplikuesi)

Bazuar në ligjin nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, kërkoj nga ERE procedimin e këtij aplikimi sipas specifikimit të mëposhtëm në tabelë, në bazë të të dhënave të përgjithshme dhe të dhënave teknike të bashkëngjitura këtij aplikimi, në përputhje me kuadrin ligjor.

1	Lloji i aplikimit	Lëshimin e GO ☐	Anulimin e GO-së ☐	Transferimin ☐
2	Tipi i impiantit	☐ Hidro ☐ Erë ☐ Gjeotermal ☐ Diellor (fotovoltaik) ☐ Termal ☐ Hibrid		

a) Të dhëna identifikuese të aplikuesit (të plotësohen nga aplikuesi)

1	Emri i shoqërisë	
	Numri i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit	
2	Selia qendrore	Adresa Cel. Tel. Fax
3	Drejtuksi kryesor/administratori i shoqërisë	Emri Funksioni
4	Përfaqësuesi	Emri Adresa Cel. Tel. Fax
5	Numri i serisë së licencës	

b) Të dhëna për aplikuesin (të plotësohen nga aplikuesi)

1	Deklaroj se nuk me është hequr apo refuzuar më parë një certifikatë garancie	Po ☐	Jo ☐
2	Deklaroj se në cilësinë e aplikuesit jam njohur me kuadrin ligjor, si dhe angazhohem për zbatimin e tij dhe të rregullave dhe rregulloreve të miratuara nga ERE për operimin në sektorin e energjisë elektrike	Po ☐	Jo ☐
4	Deklaroj se kam filluar aktivitetin e prodhimit	Në datë	

Shënim. Shënoni me X në kuadratin PO për të konfirmuar

**VENDIM****Nr. 230, datë 20.12.2019**

**MBI MIRATIMIN E KONTRATËS SË
LIDHUR NDËRMJET SHOQËRIVE
“ALBPETROL” SHA DHE “ALBGASZ”
SHA, PËR SHËRBIMIN E
TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR,
PËR NJË AFAT NJËVJEÇAR,
DUKE FILLUAR NGA DATA
1.1.2019–31.12.2019**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 35 dhe të nenit 36, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 848, datë 7.12.2016. “Për krijimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive: “Albgaz” sh.a. dhe “Albpetrol” sh.a.”, si dhe të nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 20.12.2019, pasi shqyrtoi relacionin nr. 114/15 prot., datë 11.12.2019, të përgatitur nga drejtoritë teknike për miratimin e kontratës për shërbimin e transmetimit të gazit natyror, të lidhur ndërmjet shoqërisë “Albgaz” sh.a. dhe shoqërisë “Albpetrol” sh.a. për vitin 2019, konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 49, datë 27.3.2019, ka filluar procedurën për miratimin e kontratës me nr. 1026 prot., të “Albpetrol” sh.a., datë 4.2.2019, dhe nr. 25 prot., të “Albgaz” sh.a., datë 25.2.2019, të lidhur ndërmjet shoqërive “Albpetrol” sh.a. dhe “Albgaz” sh.a., për shërbimin e transmetimit të gazit natyror, për një afat njëvjeçar, duke filluar nga data 1.1.2019–31.12.2019.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, me shkresën nr. 32/1 prot., datë 27.3.2019, është bërë njoftimi në medien e shkruar dhe me shkresën nr. 222/1, datë 29.3.2019, janë njoftuar palët për fillimin e procedurës dhe është kërkuar prej tyre shpjegim në lidhje me sasinë e parashikuar të gazit natyror që do të transmetohet, duke qenë se nga krahasimi me vitin paraardhës, u konstatua ulje e sasisë së gazit të transmetuar.

- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “Albpetrol” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 222/2, datë 15.4.2019, ka bërë me dije argumentet në lidhje me sasinë e gazit të prodhuar.

- ERE, në datën 2.5.2019, ka organizuar seancë dëgjimore mes përfaqësuesve të ERE-s: “Albgaz” sh.a. dhe “Albpetrol” sh.a., në të cilën u diskutua mbi përcaktimin e sasisë së gazit natyror që do të transmetohet gjatë vitit 2019 dhe fitimin e munguar për “Albgaz” sh.a., në lidhje me realizimin e një sasie transmetimi të gazit natyror më të vogël se ajo e parashikuar në kontratën për shërbimin e transmetimit të vitit 2018.

- Duke qenë se në draftin e paraqitur për miratim në ERE, u konstatua mungesa e parashikimit të penalteteve për palët, në rast të mosperformancës, si dhe nisur nga situata konfliktuale e krijuar mes palëve, për shkak të kësaj mosperformance për vitin 2018, në seancë u dakordësua që palët: “Albgaz” sh.a. dhe “Albpetrol” sh.a. do të përcjellin në ERE propozime konkrete, në lidhje me parashikimin e penalteteve për mosperformancën e palëve, duke kërkuar nga ERE rishikimin e kontratës për vitin 2019 dhe shtyrjen e vendimmarrjes finale për miratimin e saj, deri në shqyrtimin e këtij propozimi.

- Pas seancës dëgjimore dhe kërkesave të vazhdueshme të ERE-s, shoqëria “Albpetrol” sh.a. ka përcjellë shkresën e protokolluar në ERE me nr. 222/7, datë 25.6.2019, me anë të së cilës ka kërkuar shtyrjen e vendimmarrjes finale të bordit të ERE-s për këtë kontratë, duke argumentuar se nga ana e shoqërisë “Albpetrol” sh.a. janë kryer ndryshimet përkatëse në kontratën e transmetimit të gazit natyror për vitin 2019, dhe ky draft i është dërguar shoqërisë “Albgaz” sh.a., për të parashtruar objeksione të mundshme, në lidhje me ndryshimet e bëra në kontratë. Po ashtu, nëpërmjet këtij komunikimi shoqëria “Albpetrol” sh.a. i ka kërkuar shoqërisë “Albgaz” sh.a. paraqitjen sa më shpejt të këtij drafti për nënshkrimin e përbashkët dhe përcjelljen e tij për miratim në ERE.

- Duke qenë se nga ana e “Albgaz” sh.a. nuk pati korrespondencë zyrtare për dhënien e opinionëve mbi këto ndryshime, ERE, në mbështetje të neneve 27 dhe 29 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE”, miratuar me vendimin e bordit nr. 96, datë 17.6.2016, zhvilloi një seancë dëgjimore mes



përfaqësuesve të ERE-s: “Albgaz” sh.a. dhe “Albpetrol” sh.a., në të cilën u diskutua për ndryshimet e bëra nga “Albpetrol” sh.a. në kontratën e shërbimit të transmetimit për vitin 2019, si dhe për parashikimin e penalteteve të mundshme në dispozitat e saj.

- Përfaqësuesit e shoqërisë “Albpetrol” sh.a., gjatë seancës dëgjimore deklaruan se sasia faktike e gazit natyror që disponojnë për t’u transmetuar është 600.000 (gjashtëqind mijë) Nm³ në vit, e cila prodhohet në Cakran, Poligoni i matjes së gazit në Stacionin e Kompresorëve Drenovë. Si e tillë u bë nga ana e tyre korrigjimi i kësaj sasive në kontratë të cilën e konsideruan si lapsus. Ata deklaruan se këto specifikime janë dhënë edhe në nenin 7, pika 7.1 e kontratës.

- Në përfundim të seancës dëgjimore, për palët u la detyrë që, brenda datës 12.7.2019, të përcjellin në ERE kontratën e dakordësuar dhe të nënshkruar, në mënyrë që ERE të vijojë pa vonesë me miratimin e saj. Palëve iu bë me dije, gjithashtu, se: “nëse nuk do të ketë një amendim të dakordësuar të sa më sipër, ERE do të vlerësojë e shprehet në lidhje me miratimin ose jo të kontratës për të cilën ka filluar procedurën me vendimin nr. 49, datë 27.3.2019”.

- Duke qenë se në ERE nuk mbërriti asnjë korrespondencë nga shoqëritë “Albgaz” sh.a. dhe “Albpetrol” sh.a., në lidhje me sa lënë detyrë në seancë dhe risjellë në kujtesë në vijim nga ERE, me shkresën nr. 222/9 prot., datë 10.7.2019, ERE iu drejtua sërish palëve: “Albgaz” sh.a., “Albpetrol” sh.a. dhe MIE-s, me shkresën nr. 222/13 prot., datë 30.8.2019, duke i ftuar në një seancë tjetër dëgjimore në datën 2.9.2019, për të diskutuar ndryshimet e propozuara në të nga “Albpetrol” sh.a.

- Pas diskutimeve në seancë me palët për sasinë e gazit natyror dhe të orientimeve që dha MIE, u dakordësua midis palëve, që, brenda 10 ditëve të përcjellin për miratim në ERE draftin final të dakordësuar, duke mbajtur në konsideratë reflektimin e rekomandimit të MIE-s, në lidhje me sasinë faktike të gazit natyror të prodhuar/të transmetuar gjatë 8-mujorit të parë të vitit 2019 dhe sasinë e parashikuar për 4-mujorin e mbetur të këtij viti, referuar programit ekonomik të miratuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, të shoqërisë “Albpetrol” sh.a. në kontratën e dakordësuar.

- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “Albgaz” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 576, datë 20.9.2019, ka përcjellë në ERE draftkontratën e transmetimit të gazit natyror midis “Albgaz” sh.a. dhe “Albpetrol” sh.a., për vitin 2019, nga analizimi i së cilës rezultoi, se: “Drafti bashkëlidhur kësaj shkrese nuk mban nënshkrimin e asnjë prej palëve të saj”.

- Në lidhje me sa më sipër, duke qenë se nuk pati asnjë përgjigje apo kontratë të depozituar në ERE nga palët për konfirmimin e dakordësisë së këtyre ndryshimeve, u vijua me analizimin e draftkontratës së përcjellë nga “Albgaz” sh.a., me shkresën nr. 576, datë 20.9.2019.

- Bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 848, datë 7.12.2016, “Për krijimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive: “Albgaz” sh.a. dhe “Albpetrol” sh.a., shoqëria “Albgaz” sh.a., ushtron aktivitetin si Operator i Kombinuar i Sistemit të Transmetimit dhe Shpërndarjes së Gazit Natyror në Shqipëri.

- Shoqëria “Albgaz” sh.a. është licencuar në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 188, datë 10.11.2017, për një afat 30-vjeçar.

- Me vendimin e bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, shoqëria “Albgaz” sh.a. është certifikuar si Operator i Kombinuar i Gazit Natyror, si dhe me vendimin e bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2018, është licencuar në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror, për një afat 30-vjeçar.

- Shoqëria “Albpetrol” sh.a., kryen aktivitetin e prodhimit dhe të shitjes së gazit natyror, ndërsa shoqëria “Albgaz” sh.a., realizon transmetimin e gazit natyror me anë të linjave të “Albpetrol” sh.a.

- Shoqëria “Albgaz” sh.a., në cilësinë e transmetuesit, funksionon si operator i kombinuar i gazit natyror dhe ka depozituar në ERE kontratën e lidhur ndërmjet shoqërisë “Albpetrol” sh.a. dhe shoqërisë “Albgaz” sh.a. dhe gjen mbështetje në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9901, datë 1.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar; në ligjin nr. 7582, datë 3.7.1992, “Për ndërmarrjet shtetërore”; në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës dhe gazit natyror dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar; në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”; në vendimin e bordit të ERE-s nr. 97,



datë 23.4.2018, “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a., për vitin 2018”.

- Objekti i kontratës midis “Albgaz” sh.a. dhe “Albpetrol” sh.a. është transmetimi i gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a., kundrejt një tarife transmetimi për llogari të shoqërisë “Albpetrol” sh.a.

- Çmimi i ofrimit të shërbimit të transmetimit të gazit natyror, sipas kësaj kontrate është ai i vendosur në bazë të vendimit të ERE-s nr. 97, datë 23.4.2018, i ndryshuar me vendimin nr. 60, datë 15.04.2019, për tarifat e shërbimit të transmetimit. Tarifa aktuale për “Albgaz” sh.a., me cilësinë e transmetuesit të gazit natyror dhe “Albpetrol” sh.a., me cilësinë e prodhuesit të gazit natyror, është 28 lekë/m³, pa TVSH.

- ERE i është drejtuar shoqërisë “Albgaz” sh.a., me shkresën nr. 206 prot., datë 7.3.2019, me anë të së cilës i ka kërkuar këtij të fundit paraqitjen sa më shpejt të të ardhurave të kërkuara për të mundësuar zhvillimin normal të aktivitetit të shoqërisë “Albgaz” sh.a. për vitin 2019 ose ndjeshmërinë/pritshmërinë e “Albgaz” sh.a., në lidhje me mjaftueshmërinë e tarifës në fuqi të miratuar me vendimin 97, datë 23.4.2018, të bordit të ERE-s.

- Kjo kontratë rregullon të gjithë marrëdhënien e shërbimit të transmetimit të gazit natyror ndërmjet palëve, duke përfshirë, por pa u kufizuar, edhe programin, normimin, livrimin dhe pranimin e gazit natyror për periudhën kohore 1.1.2019–31.12.2019.

- Të gjitha kushtet e kësaj kontrate konsiderohen thelbësore dhe mund të shtohen ose të ndryshohen nëse vullneti i të dyja palëve është shprehur paraprakisht me shkrim dhe me miratimin nga bordi i ERE-s.

- Kjo kontratë përbën marrëveshjen e vetme dhe të plotë midis palëve, në lidhje me ofrimin e shërbimit të përcaktuar në objektin e saj dhe zëvendëson çdo marrëveshje verbale ose të shkruar të mëparshme ndërmjet palëve.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi të ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kontratën me nr. 1026 prot., të “Albpetrol” sh.a., datë 4.2.2019 dhe nr. 25 prot., të “Albgaz” sh.a., datë 25.2.2019, të lidhur ndërmjet

shoqërive “Albpetrol” sh.a. dhe “Albgaz” sh.a., për shërbimin e transmetimit të gazit natyror, për një afat njëvjeçar, duke filluar nga data 1.1.2019–31.12.2019, me ndryshimet, si në vijim:

a) Neni 1, “Baza ligjore”

Kjo kontratë lidhet në bazë të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 9901, datë 1.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar; të ligjit nr. 7582, datë 13.7.1992, “Për ndërmarrjet shtetërore”, të ndryshuar; të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”; të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës dhe të gazit dhe të nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar; të vendimit nr. 848, datë 7.12.2016, “Për krijimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive “Albpetrol” sh.a. dhe “Albgaz” sh.a., të ndryshuar, ku Këshilli i Ministrave ka miratuar krijimin e autoritetit publik që është përgjegjës për transmetimin, shpërndarjen dhe depozitimin e gazit natyror në Republikën e Shqipërisë; të Vendimit të ERE-s nr. 269, datë 21.12.2018, si dhe të vendimit nr. 60, datë 15.4.2019, si dhe të akteve nënligjore të dala në zbatim të tyre.

b) Neni 3, “Qëllimi i kontratës”

3.3.2 “... Kjo kontratë rregullon, kushtet dhe afatet për realizimin e këtij bashkëpunimi midis prodhuesit dhe operatorit”.

c) Neni 4, “Afati i kontratës”

Kjo kontratë lidhet për një afat 1-vjeçar (njëvjeçar), duke filluar nga data 1.1.2019, që është dhe data e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate (data efektive).

d) Neni 5, “Tarifa e shërbimit”

5.1 Për transmetimin e gazit natyror tarifa do të jetë 28 (njëzet e tetë) lekë/m³, pa TVSH, në bazë të vendimit të ERE-s nr. 269, datë 21.12.2018, si dhe të vendimit nr. 60, datë 15.4.2019.

e) Neni 6, “Faturimi dhe mënyra e pagesës”

6.1 “... mënyrën e përlllogaritjes së tarifës për t’u paguar ...” është zëvendësuar fjala “tarifë” me fjalën “detyrim”, si vijon “... mënyrën e përlllogaritjes së detyrimit për t’u paguar ...”.

f) Neni 10, “Leximi dhe faturimi”

10.5 Diferenca e krijuar midis sasisë së livruar, sipas pikës 7.1 dhe sasisë së transmetuar, sipas pikës 7.2, të nenit 7, të konvertohet në vlerë nga Prodhuesi Sasia* (çmim shitje + kosto transmetimi).



g) Neni 12, “Planifikim dhe ndërprerja e livrimit”

“Sasia e parashikuar për t’u livruar nga prodhuesi, shoqëria “Albpetrol” sh.a., që do të transmetohet nga operatori, shoqëria “Albgaz” sh.a. është 600.000 (gjashtëqind mijë) Nm³, për periudhën 1.1.2019–31.1.2019.

h) Neni 14, “Përgjegjësia për dëmet”

14.2 Operatori është përgjegjës për çdo çlirim të gazit gjatë procesit të transmetimit të tij.

i) Neni 17, “Të ndryshme”

17.5 Zgjidhja e kësaj kontrate nuk do t’i lehtësojë palët nga detyrimet që kanë përkundrejt njëra-tjetrës deri në datën e miratimit të zgjidhjes së saj nga ERE ose nga detyrimet të cilat lindin nga veprimet e kryera përpara kësaj date.

2. Palët kontraktore të depozitojnë në ERE, “Kontratën për shërbimin e transmetimit të gazit natyror”, të lidhur ndërmjet shoqërisë “Albgaz” sh.a. dhe shoqërisë “Albpetrol” sh.a., për periudhën 1.1.2019– 31.12.2019, të nënshkruar nga palët.

3. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë palët për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1.1.2019.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga data e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 231, datë 20.12.2019

**MBI MIRATIMIN E “KODIT TË
RRJETIT QË HARMONIZON
STRUKTURAT TARIFORE TË
TRANSMETIMIT TË GAZIT”**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 33, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, përcaktimeve të vendimit nr. 2018/07/PHGL –EnC datë 28.11.2018 të grupit të përhershëm të nivelit të lartë të komunitetit të energjisë, si dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të

ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 20.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 119/13 prot., datë 18.12.2019 të përgatitur nga drejtoritë teknike mbi miratimin e “Kodit të rrjetit që harmonizon strukturat tarifore të transmetimit të gazit”,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 168, datë 4.11.2019, Bordi i ERE-s vendosi të fillojë procedurën për miratimin “Kodit të Rrjetit që Harmonizon Strukturat Tarifore të Transmetimit të Gazit”.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, me shkresën nr. 32/50 prot., datë 8.11.2019, vendimi u publikua në median e shkruar duke u mbështetur në përcaktimet e nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s” miratuar me vendimin nr. 96 prot., datë 17.6.2016 të Bordit të ERE-s,

- Me shkresën nr.787 prot., datë 5.12.2019 vendimi iu dërgua edhe Autoritetit të Konkurrencës.

- Me shkresën nr. 708 prot., datë 6.11.2019, Anio Oil & Gas sh.p.k.; Phoenix Petroleum sh.a.; C.G.C sh.p.k.; Balkgaz sh.p.k.; TAP AG Albania sh.p.k. si dhe Shoqata së Mbrojtjes së Konsumatorit u njohën me këtë vendimmarrje dhe u kërkua të shprehnin opinionet dhe komentet e tyre mbi këtë akt, brenda 15 ditëve nga dita e publikimit.

- Shoqëria “Albgaz” sh.a., me shkresën nr. 708/1 prot., datë 20.11.2019, dhe MIE, me shkresën nr. 708/2 prot., datë 26.11.2019 kanë bërë me dije se parimisht shprehin dakordësinë e tyre në lidhje me fillimin e procedurave të të miratimit të “Kodit të rrjetit që harmonizon strukturat tarifore të transmetimit të gazit”.

- Nuk ka pasur propozime konkrete nga palët e interesit dhe janë ezauruar të gjitha përpjekjet dhe afatet procedurale për miratimin e kësaj rregulloreje.

- Ky Kod do të bëhet i detyrueshëm për të gjithë pjesëmarrësit e tregut. Transpozimi do të bëhet pa ndryshime në strukturën e tekstit të rregullores (EU) nr. 2017/460, përveç përkthimit dhe përshtatjes të bërë sipas këtij vendimi.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

Neni 3

Përkufizime

1. Të miratojë “Kodin e rrjetit që harmonizon strukturat tarifore të transmetimit të gazit”. (Bashkëlidhur.)

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KODI I RRJETIT QË HARMONIZON
STRUKTURAT TARIFORE TË
TRANSMETIMIT TË GAZIT

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky kod i rrjetit pasqyron rregullat mbi strukturat e tarifave të harmonizuara të transmetimit të gazit, duke përfshirë rregullat për aplikimin e metodologjisë së çmimit të referencës, të shoqëruara me kërkesat për konsultime dhe publikime, si dhe llogaritjen e çmimeve të rezervës për produktet të kapacitetit standard.

Neni 2
Fusha e veprimit

Ky kod zbatohet për të gjitha pikat e hyrjes dhe të gjitha pikat e daljes së rrjeteve të transmetimit të gazit me përjashtim të kreut III, V, VI, Neni 28, neni 31 (2) dhe (3) dhe kreut IX, të cilat zbatohen vetëm për pikat e interkonjeksionit. Kreu III, V, VI, neni 28 dhe kreut IX do të zbatohen për pikat hyrëse nga vendet e treta ose pikat e daljes në vendet e treta, ose të dyja, ku autoriteti rregullator kombëtar merr vendim për të zbatuar rregulloren (EU) 2017/459 në ato pika.

Për qëllimet e këtij kodi do të zbatohen, përkufizimet në nenin 2 të rregullores (KE) nr. 715/2009, neni 3 i Rregullores së Komisionit (BE) 2017/459, neni 2 i rregullores së Komisionit (BE) 2015/703, si dhe neni 2 i direktivës 2009/73/ EC. Për më tepër, do të zbatohen dhe përkufizimet e mëposhtme:

1. “Çmim referencë” nënkupton çmimin e një produkti të kapacitetit të përcaktuar për një periudhë 1 vjeçare, i cili është i aplikueshëm në pikat hyrëse dhe dalëse dhe që përdoret për vendosjen e tarifave të transmetimit të bazuara në kapacitete.

2. “Metodologjia e çmimit të referencës” nënkupton metodologjinë e aplikuar për pjesën e të ardhurave të shërbimeve të transmetimit, që duhet të mbulohen nga tarifat e transmetimit të bazuara në kapacitete me qëllim përcaktimin e çmimeve të referencës.

3. “Regjimi i kufizuar “jo sipas çmimeve tavan (*non-price cap regime*)” nënkupton një regjim rregullator, siç është kufizimi i të ardhurave, shkalla e kthimit dhe kostoja plus regjimi, sipas së cilës të ardhurat e lejuara për operatorin e sistemit të transmetimit përcaktohen në përputhje me nenin 41 (6)(a) të direktivës 2009/73/EC.

4. “Të ardhura nga shërbimet që nuk lidhen me transmetimin” nënkupton pjesën e të ardhurave të lejuara ose të synuara që mbulohen nga tarifat e shërbimeve që nuk lidhen me transmetimin.

5. “Periudhë rregullatore” nënkupton periudhën kohore për të cilën rregullat e përgjithshme për të ardhurat e lejuara apo të synuara janë vendosur në përputhje me nenin 41(6)(a) të direktivës 2009/73/EC.

6. “Të ardhura nga shërbimet e transmetimit” nënkupton pjesën e të ardhurave të lejuara ose të synuara që mbulohen nga tarifat e transmetimit.

7. “Tarifat e transmetimit” nënkupton tarifat që duhet të paguhën nga përdoruesit e rrjetit për shërbimet e transmetimit që u ofrohen atyre.

8. “Përdorimi i rrjetit brenda sistemit” do të thotë transportimi i gazit brenda një sistemi hyrje-dalje për konsumatorët e lidhur me të njëjtin sistem të hyrjes-daljes.

9. “Përdorimi i rrjetit ndërsistemor” do të thotë transportimi i gazit brenda një sistemi hyrje-dalje



për konsumatorët e lidhur me një sistem tjetër hyrje-dalje.

10. “Grup homogjen i pikave” nënkupton një grup të njërës nga pikat e mëposhtme: pikat hyrëse të interkonjeksionit, pikat dalëse të interkonjeksionit, pikat hyrëse të brendshme, pikat dalëse të brendshme, pikat hyrëse nga sistemet e depozitimit, pikat dalëse të sistemeve të depozitimit, pikat hyrëse nga impiantete gazit natyror të lëngshëm (tani e tutje: impiantet GNL), pikat e daljes në impiantete GNL dhe pikat hyrëse nga impiantet e prodhimit.

11. “Të ardhura të lejuara” nënkupton shumën e të ardhurave të shërbimeve të transmetimit dhe të ardhurave nga shërbimet që nuk lidhen me transmetimin për ofrimin e shërbimeve nga operatori i sistemit të transmetimit për një periudhë të caktuar kohore brenda një periudhe rregullatore të caktuar që një operator i tillë i sistemit të transmetimit ka të drejtë të marrë nën një regjim që nuk mbështetet në çmimin tavan dhe i cili është vendosur në përputhje me nenin 41(6)(a) të direktivës 2009/73/EC.

12. “Shërbime të transmetimit” nënkupton shërbimet e rregulluara që sigurohen nga operatori i sistemit të transmetimit brenda sistemit të hyrjes dhe daljes për qëllime të transmetimit.

13. “Tarifat jo të transmetimit” nënkupton tarifat që duhet të paguhet nga përdoruesit e rrjetit për shërbimet që nuk lidhen me aktivitetin e transmetimit që u ofrohen atyre.

14. “Të ardhurat e synuara” do të thotë shuma e të ardhurave të pritshme të shërbimeve të transmetimit të llogaritura në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 13(1) të rregullores (KE) nr. 715/2009 dhe të ardhurave të pritshme të shërbimeve që nuk lidhen me transmetimin për ofrimin e shërbimeve nga operatori i sistemit të transmetimit për një periudhë të caktuar kohore brenda një periudhe rregullatore të caktuar nën regjimin për çmimet tavan.

15. “Shërbime që nuk lidhen me transmetimin” nënkupton shërbimet e tjera të rregulluara të ndryshme nga shërbimet e transmetimit dhe të ndryshme nga shërbimet që lidhen me balancimin e rrjetit të transmetimit që sigurohen nga operatori i sistemit të transmetimit;

16. “Koeficient” nënkupton faktorin e zbatuar në proporcionin përkatës të çmimit referencë për të

llogaritur çmimin e rezervimit për një kapacitet standard jovjetor të produktit.

17. “Regjimi i për çmimet tavan (*price cap regime*)” nënkupton një regjim rregullator sipas të cilit një tarifë maksimale e transmetimit bazuar në të ardhurat e synuara është vendosur në përputhje me nenin 41(6)(a) të direktivës 2009/73/EC.

18. “Indikator kostoje (*cost driver*)” nënkupton një përcaktues kyç të veprimtarisë së operatorit të sistemit të transmetimit i cili lidhet me kostot e atij operatori të sistemit të transmetimit, siç është distanca ose kapaciteti teknik.

19. “Grupimi i pikave hyrëse ose dalëse” do të thotë një grup homogjen i pikave ose grupit të pikave hyrëse apo pikave dalëse të vendosura në afërsi të njëra-tjetrës dhe që konsiderohen si, përkatësisht, një pikë hyrëse apo një pikë dalëse për aplikimin e metodologjisë së çmimit të referencës.

20. “Skema e flukseve (*flow scenario*)” nënkupton kombinimin e një pike hyrëse dhe një pikë dalëse që pasqyron përdorimin e sistemit të transmetimit sipas modeleve të mundshme të furnizimit dhe kërkesës, për të cilat ekziston të paktën një rrugë e tubacionit që lejon rrjedhjen e gazit në rrjetin transmetues si në pikën hyrëse dhe jashtë rrjetit të transmetimit në atë pikë dalëse, pavarësisht nëse kapaciteti është kontraktuar në atë pikë hyrje dhe atë pikë dalje.

21. “Faktor sezonal” nënkupton faktorin që pasqyron ndryshimin e kërkesës brenda vitit që mund të jetë e zbatueshme kombinuar me koeficientin përkatës.

22. “Çmim fiks i pagueshëm” nënkupton një çmim të llogaritur në përputhje me nenin 24 (b) kur çmimi rezervë nuk është objekt rregullimi.

23. “Periudhë tarifore” nënkupton periudhën kohore gjatë së cilës aplikohet deri në një nivel të caktuar çmimi i referencës, ku kohëzgjatja minimale është një vit dhe kohëzgjatja maksimale është kohëzgjatja e periudhës rregullatore.

24. “Llogari rregullatore” nënkupton llogarinë që akumulon së paku nën- dhe mbirikuperimin e të ardhurave të shërbimeve të transmetimit sipas një regjimi kufizues që nuk lidhet me çmimet tavan;

25. “Primi i ankandit” nënkupton diferencën midis çmimit të ekuilibrit dhe çmimit të rezervës në ankand.

26. “Çmimi variabël i pagueshëm (*floating payable price*)” nënkupton një çmim të llogaritur në përputhje me nenin 24(a) ku çmimi i rezervës është



objekt rishikimi siç është rishikimi i të ardhurave, rishikimi i të ardhurave të lejuara ose rishikimi kapacitetit të parashikuar të kontraktuar.

Neni 4

Shërbimet dhe tarifat për aktivitetet e transmetimit dhe aktivitetet që nuk lidhen me transmetimin

1. Një shërbim i caktuar do të konsiderohet si një shërbim transmetimi kur plotësohen të dy kriteret e mëposhtme:

a) kostot e një shërbimi të tillë shkaktohen nga indikatorët e kostove të dy kapaciteteve teknik ose të kapacitetit të kontraktuar të parashikuar dhe distancës;

b) kostot e këtij shërbimi lidhen me investimin dhe funksionimin e infrastrukturës që është pjesë e bazës së aseteve të rregulluar për ofrimin e shërbimeve të transmetimit.

Nëse ndonjë nga kriteret e përcaktuara në pikat “a” dhe “b” nuk është përmbushur, një shërbim i caktuar mund t’i atribuohet ose shërbimeve të transmetimit ose shërbimeve që nuk lidhen me transmetimin, që kanë të bëjnë me rezultatet nga konsultimet e zhvilluara nga operatori/ët i/e sistemit të transmetimit ose autoriteti rregullator kombëtar dhe me vendim nga autoriteti rregullator kombëtar, siç përcaktohet në nenet 26 dhe 27.

2. Tarifat e transmetimit mund të vendosen në atë mënyrë që të marrin parasysh kushtet për produktet e kapacitetit të garantuar.

3. Të ardhurat nga shërbimet e transmetimit do të rikupërohen nga tarifat e transmetimit të bazuara në kapacitete.

Si përjashtim, me miratimin paraprak të autoritetit rregullator kombëtar, një pjesë e të ardhurave nga shërbimet e transmetimit mund të rikupërohen vetëm nga tarifat e mëposhtme të transmetimit të bazuara në mallra *commodity based*, të cilat janë vendosur veçmas nga njëra-tjetra:

a) fluksin bazë të pagesës, i cili duhet të jetë në përputhje me të gjitha kriteret e mëposhtme:

i. të vendosura për qëllimin e mbulimit të kostove të shkaktuara kryesisht nga sasia e rrjedhës së gazit;

ii. llogaritur në bazë të flukseve të parashikuara ose historike, ose të dyja, dhe të vendosura në mënyrë të tillë që të jenë të njëjta në të gjitha pikat hyrëse dhe të njëjta në të gjitha pikat dalëse;

iii. shprehur në terma monetarë ose në natyrë.

b) një pagesë plotësuese për rikuperimin e të ardhurave, e cila duhet të jetë në përputhje me të gjitha kriteret e mëposhtme:

i. të vendosura për qëllime të manaxhimit të të ardhurave nën- dhe mbirrikuperuese;

ii. llogaritet në bazë të alokimeve dhe flukseve të parashikuara ose historike, ose të dyja;

iii. zbatohet në pika të ndryshme nga pikat e interkonjeksionit;

iv. zbatohet pasi autoriteti rregullator kombëtar ka bërë një vlerësim të reflektimit të kostos dhe ndikimin e tij në ndërsuvencionimin midis pikave të interkonjeksionit dhe pikave të tjera përveç pikave të interkonjeksionit.

4. Të ardhurat nga shërbimet që nuk lidhen me transmetimin do të mbulohen nga tarifat që nuk lidhen me transmetimin të aplikueshme për një shërbim të caktuar që nuk lidhet me transmetimin. Këto tarifa do të jenë si më poshtë:

a) kosto-reflektuese, jodiskriminuese, objektive dhe transparente;

b) të detyrueshme për t’u paguar nga përfituesit e një shërbimi të caktuar që nuk lidhet me transmetimin me qëllim të minimizimit të ndër - suvencionimit ndërmjet përdoruesve të rrjetit brenda ose jashtë një Pale Kontraktore ose të dyja.

Ku sipas autoritetit rregullator kombëtar një shërbim i caktuar që nuk lidhet me transmetimin sjell përfitime për të gjithë përdoruesit e rrjetit, shpenzimet për shërbimin e tillë do të mbulohen nga të gjithë përdoruesit e rrjetit.

Neni 5

Vlerësimi i alokimit të kostove

1. Autoriteti rregullator kombëtar ose operatori i sistemit të transmetimit, siç është vendosur nga autoriteti rregullator kombëtar, kryen vlerësimet e mëposhtme dhe i publikon ato si pjesë e konsultimit përfundimtar të përmendur në nenin 26:

a) një vlerësim të alokimit të kostos që lidhet me të ardhurat e shërbimeve të transmetimit që do të mbulohen nga tarifat e transmetimit të bazuara në kapacitete dhe të bazuara ekskluzivisht në indikatorët e kostos së

i. kapaciteti teknik; ose

ii. kapaciteti i kontraktuar i parashikuar; ose

iii. kapaciteti teknik dhe distanca; ose



iv. kapacitetit të kontraktuar të parashikuar dhe distancës;

b) një vlerësim të alokimit të kostos në lidhje me të ardhurat e shërbimeve të transmetimit që do të mbulohen nga tarifat e transmetimit të bazuara në mall *commodities based*, nëse ka, dhe bazuar ekskluzivisht në indikatorët e kostos e:

- i. sasisë së flukseve të gazit; ose
- ii. sasisë së flukseve të gazit dhe distancën.

2. Vlerësimet e alokimit të kostove duhet të tregojnë shkallën e ndërsuvcionimit ndërmjet përdorimit të rrjetit brenda sistemit dhe ndërsistemeve bazuar në metodologjinë e propozuar të çmimeve të referencës.

3. Vlerësimi i alokimit të kostos nga paragrafi 1 (a) do të kryhet si më poshtë:

a) të ardhurat e kapacitetit të shërbimeve të transmetimit që do të merren nga përdorimi i rrjetit brenda sistemit në të gjitha pikat hyrëse dhe dalëse do të ndahen nga vlera e indikatorit të kostos së kapacitetit përkatës për përdorimin e rrjetit brenda sistemit për të llogaritur raportin e kapacitetit brenda sistemit, i cili përkufizohet si një njësi monetare për njësi matëse, si në euro për MWh/ditë, në përputhje me formulën e mëposhtme:

$$\text{Ratio}_{\text{cap}}^{\text{intra}} = \frac{\text{Revenue}_{\text{cap}}^{\text{intra}}}{\text{Driver}_{\text{cap}}^{\text{intra}}}$$

ku:

(Revenue) Të ardhurat intra/cap është e ardhura, e përcaktuar në një njësi monetare të tillë si euro, e cila është marrë nga tarifat e kapacitetit dhe mbulon përdorimin e rrjetit brenda sistemit;

(Driver) indikator intra/cap është vlera e kostos së kapacitetit që lidhet me kapacitetin për përdorimin e rrjetit brenda sistemit, si shuma e kapaciteteve mesatare të parashikuara ditore të kontraktuara në secilën pikë hyrëse brenda sistemit dhe pikës së daljes brenda sistemit, ose grupit të pikave dhe është përcaktuar në një njësi matëse të tillë si MWh/ditë.

b) Të ardhurat e kapaciteteve të shërbimeve të transmetimit që do të merren nga përdorimi i rrjetit ndërsistemor në të gjitha pikat hyrëse dhe dalëse, do të ndahen me vlerën e kostos së kapacitetit përkatës për përdorimin e rrjetit ndërsistemor për të llogaritur raportin e kapacitetit ndërsistemor, i cili përkufizohet si një njësi monetare për njësi matëse,

si në euro për MWh/ditë, në përputhje me formulën e mëposhtme:

$$\text{Ratio}_{\text{cap}}^{\text{cross}} = \frac{\text{Revenue}_{\text{cap}}^{\text{cross}}}{\text{Driver}_{\text{cap}}^{\text{cross}}}$$

ku:

Të ardhurat (*cross/cap*) është e ardhura, e përcaktuar në një njësi monetare të tillë si euro, e cila është marrë nga tarifat e kapacitetit dhe mbulon shpenzimet për përdorimin e rrjetit ndër sistemor.

Indikator (*cross/cap*) është vlera e indikatorit të kostos të kapacitetit/eve përkatës/e për përdorimin e rrjetit ndër sistemor siç është shuma e kapaciteteve mesatare të parashikuara ditore të kontraktuara në secilën pikë hyrëse dhe dalëse ndër sisteme, ose grupit të pikave dhe është përcaktuar në një njësi matëse si MWh / ditë.

c) indeksi i krahasimit të alokimit të kostos së kapacitetit midis raporteve të përmendura në pikat “a” dhe “b”, që përcaktohet në përputhje, do të llogaritet në përputhje me formulën e mëposhtme:

$$\text{Comp}_{\text{cap}} = \frac{2 \times |\text{Ratio}_{\text{cap}}^{\text{intra}} - \text{Ratio}_{\text{cap}}^{\text{cross}}|}{\text{Ratio}_{\text{cap}}^{\text{intra}} + \text{Ratio}_{\text{cap}}^{\text{cross}}} \times 100\%$$

*Comp (cap)= Krahasimi (kapacitet)

4. Vlerësimi i alokimit të kostos, i referuar në paragrafin 1 (b), do të kryhet si më poshtë:

a) të ardhurat e mallrave të shërbimeve të transmetimit që merren nga përdorimi i rrjetit të brendshëm të sistemit të përdorura së bashku për të gjitha pikat hyrëse dhe pikat dalëse do të ndahen me vlerën e indikatorit të kostos për mallrat përkatës për përdorimin e rrjetit të brendshëm të sistemit për të cilin llogaritet raporti i mallrave brenda sistemit, i cili përkufizohet si një njësi monetare për njësi matëse, e shprehur në euro për MWh, në përputhje me formulën e mëposhtme:

$$\text{Ratio}_{\text{comm}}^{\text{intra}} = \frac{\text{Revenue}_{\text{comm}}^{\text{intra}}}{\text{Driver}_{\text{comm}}^{\text{intra}}}$$

ku:

Të ardhurat (*intra/comm*) është e ardhura, e përcaktuar në një njësi monetare të tillë si euro, e



cila është marrë nga tarifat e mallrave dhe është ngarkuar për përdorimin e rrjetit të brendshëm të sistemit.

Indikator (*intra/comm*) është vlera referuese për koston e mallrave për përdorimin e rrjetit të brendshëm të sistemit, siç është shuma e flukseve mesatare ditore të parashikuara në secilën pikë hyrëse dhe dalje brenda sistemit, ose grupit të pikave dhe është përcaktuar në një njësi matëse të tillë si MWh.

b) të ardhurat e shërbimeve të transmetimit të mallit (sasia e gazi natyror) që do të merren nga përdorimi i rrjetit ndër sistemor së bashku për të gjitha pikat hyrëse dhe pikat dalje do të ndahen me vlerën e indikatorit të koston të mallit GN përkatëse për përdorimin e rrjetit ndër sistemor të sistemeve ndërlidhese në mënyrë që të llogaritet raporti i mallit ndër sistemor i cili është përcaktuar si një njësi monetare për njësi matëse, e shprehur në euro për MWh, në përputhje me formulën e mëposhtme:

$$\text{Ratio}_{\text{comm}}^{\text{cross}} = \frac{\text{Revenue}_{\text{comm}}^{\text{cross}}}{\text{Driver}_{\text{comm}}^{\text{cross}}}$$

ku:

Të ardhurat (cross/comm) është e ardhura, e përcaktuar në një njësi monetare të tillë e shprehur në euro, e cila është marrë nga tarifat e mallit dhe mbulon shpenzimet në përdorimin e rrjetit ndër sistemor;

Indikator (cross/comm) është vlera referuese për koston e mallrave për përdorimin e rrjetit ndër sistemor, siç është shuma e flukseve mesatare ditore të parashikuara në secilën pikë hyrëse dhe dalje të rrjetit ndër sistemor ose grupit të pikave dhe është përcaktuar në një njësi matëse të shprehur me MWh.

*Comm= Komoditet (Mall)

c) indeksi i krahasimit të alokimit të koston së mallit midis raporteve të përmendura në pikat “a” dhe “b”, i cili përcaktohet në përqindje, do të llogaritet në përputhje me formulën e mëposhtme:

$$\text{Comp}_{\text{comm}} = \frac{2 \times |\text{Ratio}_{\text{comm}}^{\text{intra}} - \text{Ratio}_{\text{comm}}^{\text{cross}}|}{\text{Ratio}_{\text{comm}}^{\text{intra}} + \text{Ratio}_{\text{comm}}^{\text{cross}}} \times 100\%$$

5. Të ardhurat e shërbimeve të transmetimit që do të sigurohen nga përdorimi i rrjetit brenda sistemit në pikat hyrëse të përmendura në paragrafët 3 (a) dhe 4 (a) do të llogariten si më poshtë:

a) shuma e kapacitetit të alokuar ose, respektivisht, flukset që kanë të bëjnë me ofrimin e shërbimeve të transmetimit për përdorimin e rrjetit ndër sistem në të gjitha pikat hyrëse do të konsiderohen të barabarta me sasinë e kapacitetit ose, rrjedhimisht, flukseve që i korespondojnë ofrimit të shërbimeve të transmetimit për përdorimin e rrjetit ndër sistem në të gjitha pikat dalje;

b) kapaciteti dhe flukset e përcaktuara në pikën “a” të këtij paragrafi do të përdoren për të llogaritur të ardhurat e shërbimeve të transmetimit që do të merren nga përdorimi i rrjetit ndër sistem në pikat e hyrjes;

c) dallimi midis të ardhurave të përgjithshme të shërbimeve të transmetimit që do të merren në pikat hyrëse dhe vlerës që rezulton nga pika “b” e këtij paragrafi do të jetë e barabartë me të ardhurat e shërbimeve të transmetimit që do të merren nga përdorimi i rrjetit brenda pikave të hyrjes.

6. Aty ku distanca përdoret si indikator i koston në kombinim me kapacitetin ose flukset e kontraktuara teknike ose të parashikuara, do të përdoret distanca mesatare e ponderuar e kapacitetit ose, përkatësisht, distanca mesatare e ponderuar e mallrave. Kur rezultatet e kapacitetit, ose përkatësisht treguesit e krahasimit të shpërndarjes së kostove të mallrave të përmendura në paragrafin 3 (c) ose respektivisht paragrafin 4 (c), kalojnë 10 për qind, autoriteti rregullator kombëtar duhet të sigurojë arsyetimin e rezultateve të tilla në vendimin e përmendur në nenin 27 (4).

KREU II METODOLOGJITË E ÇMIMIT TË REFERENCËS

Neni 6

Aplikimi i metodologjisë së çmimit të referencës

1. Metodologjia e çmimit të referencës do të vendoset ose miratohet nga autoriteti rregullator kombëtar siç përcaktohet në nenin 27. Metodologjia e çmimit të referencës që do të



zbatohet duhet t'i nënshtrohet rezultateve të konsultimeve periodike të kryera në përputhje me nenin 26 nga operatori/ët i/e sistemit të transmetimi ose autoritetit kombëtar rregullator, siç është vendosur nga autoriteti rregullator kombëtar.

2. Zbatimi i metodologjisë së çmimit të referencës do të mundësojë një çmim reference.

3. E njëjta metodologji e çmimit të referencës do të zbatohet për të gjitha pikat hyrëse dhe dalje në një sistem të caktuar të hyrjes-daljes, subjekt i përjashtimeve të përcaktuara në nenet 10 dhe 11.

4. Ndryshimet në zbatimin e metodologjisë së çmimit të referencës në të gjitha pikat e hyrjes dhe daljes mund të bëhen vetëm në përputhje me nenin 9 ose si rezultat i një ose më shumë nga sa vijon:

a) *benchmarking* (vendosja e një pike referimi) nga autoriteti rregullator kombëtar, ku si çmime reference në një pikë të dhënë hyrje ose dalje janë përshtatur në mënyrë që vlerat rezultuese të përmbushin nivelin konkurrues të çmimeve të referencës;

b) njehsimin nga operatori i sistemit të transmetimit ose nga autoriteti rregullator kombëtar, siç është vendosur nga autoriteti rregullator kombëtar, ku çmimi i njëjtë i referencës zbatohet për disa ose të gjitha pikat brenda një grupi homogjen të pikave;

c) përshtatjen nga operatori i sistemit të transmetimit ose autoriteti rregullator kombëtar, siç është vendosur nga autoriteti rregullator kombëtar, ku çmimet e referencës në të gjitha pikat hyrëse ose dalje, ose të dyja, rregullohen ose duke shumëzuar vlerat e tyre me një konstante ose duke shtuar ose zbritur nga vlerat e tyre një konstante.

Neni 7

Zgjedhja e metodologjisë së çmimit të referencës

Metodologjia e çmimit të referencës duhet të jetë në përputhje me nenin 13 të rregullores (KE) nr. 715/2009 dhe me kërkesat e mëposhtme. Ai duhet të synojë:

a) mundësimin për përdoruesit e rrjetit të riprodhojnë llogaritjen e çmimeve të referencës dhe parashikimin e tyre të saktë;

b) marrjen në konsideratë të kostove aktuale të ofruara për shërbimet e transmetimit duke marrë parasysh nivelin e kompleksitetit të rrjetit të transmetimit;

c) sigurimin e mosdiskriminimit dhe parandalimin e ndërsuvencionimit të panevojshëm, përfshirë marrjen në konsideratë të vlerësimeve të ndarjes së kostove të përcaktuara në nenin 5;

d) të sigurojë që një pjesë e konsiderueshme e riskut të vëllimit që lidhet veçanërisht me transportin në të gjithë sistemin e hyrjes dhe daljes nuk i është ngarkuar konsumatorit final brenda atij sistemi hyrje-dalje;

e) të sigurojnë që çmimet reference rezultuese të mos shtrembërojnë tregtinë ndërkufitare.

Neni 8

Metodologjia e çmimit reference së distancës sipas ponderimit të kapacitetit

1. Parametrat për metodologjinë e çmimit të referencës së distancës sipas ponderimit të kapacitetit janë si më poshtë:

a) pjesa e të ardhurave të shërbimeve të transmetimit që duhet të mbulohen nga tarifat e transmetimit të kapaciteteve;

b) kapaciteti i parashikuar i kontraktuar në secilën pikë hyrjeje ose grupi i pikave të hyrjes dhe në secilën pikë dalje ose një grup pikash dalje;

c) ku pikat e hyrjes dhe pikat e daljes mund të kombinohen në skemën e fluksit përkatës, distanca më e shkurtër e itinerareve të tubacionit ndërmjet një pike hyrëse ose një grupi pikash hyrëse dhe një pike dalje ose një grupi pikash dalje;

d) kombinimet e pikave hyrëse dhe dalje, ku disa pika hyrëse dhe disa pika dalje mund të kombinohen në një skemë përkatëse të fluksit;

e) ndarja hyrëse-dalje e përmendur në nenin 30(1)(b)(v)(2) është 50/50. Aty ku pikat e hyrjes dhe pikat e daljes nuk mund të kombinohen në një skemë të fluksit, ky kombinim i pikave hyrëse dhe dalje nuk do të merret parasysh.

2. Çmimet e referencës do të derivohen në hapat vijues:

a) distanca mesatare e ponderuar do të llogaritet për secilën pikë hyrëse ose çdo grup pikash hyrëse dhe për secilën pikë dalje ose çdo grup pikash dalje, duke marrë parasysh, aty ku është e përshtatshme, kombinimet e përmendura në paragrafin 1 (d), në përputhje me formulat përkatëse:

i. për një pikë hyrëse ose grup të pikave hyrëse, si shuma e produkteve të kapacitetit në secilën pikë



dalëse ose grup të pikave dalëse dhe distanca nga kjo pikë hyrëse ose grupi i pikave hyrëse në secilën pikë dalëse ose grup i pikave dalëse, të ndarë nga shuma e kapaciteteve në secilën pikë dalëse ose grup pikash dalëse:

$$AD_{En} = \frac{\sum_{all\ Ex} CAP_{Ex} \times D_{En,Ex}}{\sum_{all\ Ex} CAP_{Ex}}$$

ku:

AD En është mesatarja e ponderuar e distancës për një pikë hyrëse ose një grup pikash hyrëse;

CAP En është kapaciteti i kontraktuar i parashikuar në një pikë dalëse ose një grup pikash dalëse;

D En, Ex është distanca ndërmjet një pikë hyrëse të dhënë ose një grup pikash hyrëse dhe një pike dalëse të dhënë ose një grup pikash dalëse të përmendura në paragrafin 1 (c).

ii. për një pikë dalëse ose grup të pikave të dalëse, si shuma e produkteve të kapacitetit në secilën pikë hyrëse ose grup të pikave hyrëse dhe distancën në këtë pikë dalëse ose grup të pikave dalëse nga çdo pikë hyrëse ose grupi i pikave hyrëse, të ndarë nga shuma e kapaciteteve në secilën pikë hyrëse ose grup të pikave hyrëse:

$$AD_{Ex} = \frac{\sum_{all\ En} CAP_{En} \times D_{En,Ex}}{\sum_{all\ En} CAP_{En}}$$

ku:

AD Ex është mesatarja e ponderuar e distancës për një pikë dalëse ose një grup pikash dalëse;

CAP En është kapaciteti i kontraktuar i parashikuar në një pikë hyrëse ose një grup pikash hyrëse;

D En, Ex është distanca ndërmjet një pikë hyrëse të dhënë ose një grup pikash hyrëse dhe një pike dalje të dhënë ose një grup pikash dalëse të përmendura në paragrafin 1 (c).

b) Pesha e kostos për secilën pikë hyrëse ose çdo grup të pikave të hyrjes dhe për secilën pikë dalëse ose secili grup i pikave dalëse duhet të llogaritet në përputhje me formulat përkatëse:

$$W_{c,En} = \frac{CAP_{En} \times AD_{En}}{\sum_{all\ En} CAP_{En} \times AD_{En}}$$

$$W_{c,Ex} = \frac{CAP_{Ex} \times AD_{Ex}}{\sum_{all\ Ex} CAP_{Ex} \times AD_{Ex}}$$

ku:

Wc, En është pesha e kostos për një pikë hyrëse të dhënë ose një grup pikash hyrëse;

Wc, Ex është pesha e kostos për një pikë dalëse të dhënë ose një grup të pikave dalëse;

AD En është mesatarja e ponderuar e distancës për një pikë hyrëse ose një grup të pikave hyrëse;

AD Ex është mesatarja e ponderuar e distancës për një pikë dalëse ose një grup pikash dalëse;

CAP En është kapaciteti i parashikuar i kontraktuar në një pikë hyrëse ose një grup pikash hyrëse;

CAP Ex është kapaciteti i parashikuar i kontraktuar në një pikë dalëse ose një grup pikash dalëse.

c) pjesa e të ardhurave të shërbimeve të transmetimit që do të rikuperohen nga tarifat e transmetimit të kapacitetit në të gjitha pikat hyrëse dhe pjesa e të ardhurave të shërbimeve të transmetimit që do të mbulohen nga tarifat e transmetimit të kapacitetit në të gjitha pikat dalëse do të identifikohen duke aplikuar ndarjen hyrëse-dalëse;

d) pjesa e të ardhurave të shërbimeve të transmetimit që do të rikuperohen nga tarifat e transmetimit të bazuara në kapacitet në çdo pikë hyrëse ose në çdo grup pikash hyrëse dhe për secilën pikë dalëse ose çdo grup pikash dalëse do të llogaritet në përputhje me formulat përkatëse:

$$REn = W_{c,En} \times R\sum_{En}$$

$$REx = W_{c,Ex} \times R\sum_{Ex}$$

ku:

Wc, En është pesha e kostos për një pikë të dhënë hyrëse ose një grup pikash hyrëse;

Wc, Ex është pesha e kostos për një pikë të dhënë dalëse ose një grup të pikave dalëse;

R En është pjesë e të ardhurave të shërbimeve të transmetimit që do të rikuperohen nga tarifat e transmetimit të bazuara në kapacitete në një pikë hyrëse ose një grup të pikave hyrëse;



R_{Ex} është pjesë e të ardhurave të shërbimeve të transmetimit që do të rikuperohen nga tarifat e transmetimit të bazuara në kapacitete në një pikë dalëse ose një grup të pikave dalëse;

R_{ΣEn} është pjesë e të ardhurave të shërbimeve të transmetimit që do të rikuperohen nga tarifat e transmetimit të bazuara në kapacitete në të gjitha pikat hyrëse;

R_{ΣEx} është pjesë e të ardhurave të shërbimeve të transmetimit që do të rikuperohen nga tarifat e transmetimit të bazuara në kapacitete në të gjitha pikat dalëse.

e) vlerat e marra sipas pikës “d” do të ndahen nga kapaciteti i parashikuar i kontraktuar në secilën pikë hyrëse ose në çdo grup pikash hyrëse dhe në secilën pikë dalëse ose çdo grup të pikave dalëse në përputhje me formulat si në vijim:

$$T_{En} = \frac{R_{En}}{CAP_{En}}$$

$$T_{Ex} = \frac{R_{Ex}}{CAP_{Ex}}$$

ku:

T_{En} është çmimi i referencës në një pikë hyrëse ose çdo pike hyrëse brenda një grup pikash hyrëse;

T_{Ex} është çmimi i referencës në një pikë dalëse ose çdo pike dalëse brenda një grup pikash dalëse;

CAP_{En} është kapaciteti i parashikuar i kontraktuar në një pikë hyrëse ose një grup të pikave hyrëse;

CAP_{Ex} është kapaciteti i parashikuar i kontraktuar në një pikë dalëse ose një grup të pikave dalëse.

Neni 9

Rishikimi i tarifave për pikat hyrëse dhe dalëse për impiantet e depozitimit dhe për pikat hyrëse për impiantet e GNL dhe infrastrukturat për mbylljen e izolimit

1. Një zbritje prej të paktën 50% do të zbatohet për tarifat e transmetimit të bazuara në kapacitete në pikat hyrëse dhe dalëse në impiantet e depozitimit, përveç rasteve kur një impiant depozitimi i cili është i lidhur me më shumë se një

rrjet transmetimi ose shpërndarje për të konkurruar me një pikë interkonjeksioni.

2. Në pikat hyrëse nga impiantet e GNL-së dhe në pikat hyrëse dhe dalëse të infrastrukturës të zhvilluara me qëllim mbylljen e izolimit të palëve kontraktore në lidhje me sistemet e tyre të transmetimit të gazit, mund të zbatohet një zbritje për tarifat përkatëse të transmetimit të bazuar në kapacitete për rritjen e sigurisë së furnizimit.

Neni 10

Rregullat për sistemet hyrëse-dalëse në një Palë Kontraktore ku më shumë se një operator i sistemit të transmetimit është aktiv

1. Në përputhje me nenin 6(3), e njëjta metodologji e çmimit të referencës do të zbatohet bashkërisht nga të gjithë operatorët e sistemit të transmetimit brenda një sistemi hyrës-dalës brenda një Pale Kontraktore.

2. Si përjashtim të paragrafit 1 dhe sipas paragrafit 3, autoriteti rregullator kombëtar mund të vendosë:

a) që metodologjia e njëjtë e çmimit të referencës zbatohet veçmas nga secili operator i sistemit të transmetimit brenda një sistemi hyrje-dalje;

b) si një përjashtim i nenit 6 (3), kur planifikon shkrirjen e sistemeve hyrëse-dalëse në hapat e ndërmjetëm që lejojnë që metodologjitë e çmimeve të ndryshme të referencës të zbatohen veçmas nga secili operator i sistemit të transmetimit brenda sistemeve hyrëse-dalëse në fjalë. Një vendim i tillë do të përcaktojë afatin kohor për zbatimin e hapave të ndërmjetëm. Autoriteti rregullator kombëtar ose operatorët e sistemit të transmetimit, siç vendoset nga autoriteti rregullator kombëtar, duhet të kryejnë një vlerësim të ndikimit dhe një analizë të përfitimit të kostos përpara zbatimit të hapave të tillë të ndërmjetëm.

Si rezultat i aplikimit të metodologjive të ndryshme të çmimeve të referencës veçmas, të ardhurat e shërbimeve të transmetimit nga operatorët e sistemit të transmetimit të përfshira do të përshtaten në përputhje me rrethanat.

3. Me qëllim që të mundësohet aplikimi i duhur i metodologjisë së përbashkët të çmimit të referencës, do të krijohet një mekanizëm efektiv i kompensimit të operatorëve të sistemit ndërtransmetues.



Vendimi i përmendur në paragrafin 2 (a) ose respektivisht paragrafi 2 (b) mund të merret kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) krijohet një mekanizëm efektiv kompensimi i operatorit të sistemit ndërtransmetues me qëllim që:

i. të parandalojë efektet e dëmshme në të ardhurat e shërbimeve të transmetimit të operatorëve të sistemit të transmetimit;

ii. të shmange ndërsubvencionimin midis përdorimit të rrjetit intra-sistemor dhe ndërsistemor;

b) një aplikim i tillë i veçantë siguron që kostot të korrespondojnë me ato të një operatori të sistemit të transmetimit efikas.

4. Periudha maksimale e përcaktuar në vendimin e përmendur në paragrafin 2(a) ose respektivisht paragrafi 2(b) nuk duhet të jetë më vonë se pesë vjet nga data e përmendur në nenin 38(2). Në kohë të mjaftueshme përpara datës së përcaktuar në atë vendim, autoriteti rregullator kombëtar mund të vendosë ta shtyjë këtë datë.

5. Në të njëjtën kohë në përputhje me nenin 26, autoriteti rregullator kombëtar do të kryejë një konsultim përfundimtar mbi parimet e një mekanizmi efektiv të kompensimit të operatorit të sistemit ndërtransmetues të përmendur në paragrafin 3 dhe pasojat e tij në nivelet e tarifave. Mekanizmi i kompensimit të operatorit të sistemit ndërtransmetues do të zbatohet në përputhje me nenin 41(6)(a) të direktivës 2009/73/EC dhe publikohet së bashku me përgjigjet e marra nga konsultimi.

6. Çmimi rezervë i përmendur në nenin 22(1) do të llogaritet ashtu siç është përcaktuar në nenin e sipërcituar. Aty ku do të zbatohet paragrafi 2, duhet të kryhen këto dy llogaritje:

a) llogaritja e përcaktuar në nenin 22(1) do të kryhet nga secili operator i sistemit të transmetimit;

b) mesatarja e ponderuar e vlerave rezultuese të referuara në pikën “a” do të llogaritet në përputhje me formulën e përcaktuar në nenin 22(1)(b), (*mutatis mutandis*).

7. Konsultimet përfundimtare të referuara në nenin 26 do të kryhen nga të gjithë operatorët e sistemit të transmetimit së bashku ose nga autoriteti rregullator kombëtar. Aty ku zbatohet paragrafi 2, të tilla konsultime do të kryhen nga secili operator i sistemit të transmetimit veçmas ose nga autoriteti

rregullator kombëtar, siç është vendosur nga autoriteti rregullator kombëtar.

8. Informacioni i referuar në nenet 29 dhe 30 do të publikohet në nivel të grupuar për të gjithë operatorët e sistemit të transmetimit të përfshirë. Aty ku zbatohet paragrafi 2, do të kryhen këto dy veprime:

a) informacioni i tillë do të publikohet individualisht për secilin operator të sistemit të transmetimit të përfshirë;

b) informacioni mbi ndarjen hyrje-dalje të përmendur në nenin 30(1)(b)(v)(2) për sistemin e hyrjes-daljes duhet të publikohet nga autoriteti rregullator kombëtar.

Neni 11

Rregullat për sistemet hyrëse-dalëse që mbulojnë më shumë se një palë kontraktore ose që mbulojnë palët kontraktore dhe shtetet anëtare ku më tepër se një operator i sistemit të transmetimit është aktiv

Metodologjia e njëjtë e çmimit të referencës mund të zbatohet bashkërisht ose veçmas ose metodologjitë e ndryshme të çmimit të referencës mund të aplikohen veç e veç, ku më shumë se një operator i sistemit të transmetimit është aktiv në një sistem hyrës-dalës që mbulon më shumë se një Palë Kontraktore ose shtet anëtar.

KREU III

ÇMIMET E REZERVËS

Neni 12

Dispozita të përgjithshme

1. Për produktet vjetore të kapacitetit standard të garantuar, çmimet e referencës do të përdoren si çmime të rezervës. Për produktet jovjetore të kapacitetit standard të garantuar, çmimet e rezervës do të llogariten siç janë të përcaktuara në kreun III. Për të dyja llojet e produkteve të kapacitetit të ndërprerë, çmimet vjetore dhe jovjetore të rezervës do të llogariten ashtu siç janë të përcaktuar në kreun III. Niveli i koeficientit dhe i faktorëve sezonalë të përcaktuar në përputhje me nenin 13, dhe niveli i zbritjeve për produktet e kapacitetit standard për kapacitetin e ndërprerë, të përcaktuara në përputhje me nenin 16, mund të jenë të ndryshme në pikat e interkonjeksionit.



2. Aty ku periudha e tarifës dhe viti i gazit nuk përkojnë, çmimet e ndara të rezervës mund të aplikohen respektivisht:

- a) për periudhën kohore prej 1 tetorit deri në fund të periudhës tarifore mbizotëruese; dhe
- b) për periudhën kohore nga fillimi i periudhës tarifore të ndjekur nga periudha tarifore mbizotëruese deri më 30 shtator.

3. Çmimet përkatëse të rezervës të publikuara sipas nenit 29 do të jenë të detyrueshme për vitin e ardhshëm të gazit ose përtej vitit të ardhshëm të gazit në rast çmimi fiks të pagueshëm, duke filluar nga ankandi vjetor i kapacitetit vjetor, përveçse:

a) zbritjet për produktet mujore dhe ditore të kapacitetit për kapacitetin e ndërprerë rillogariten brenda periudhës tarifore nëse probabiliteti i ndërprerjes i përmendur në nenin 16 ndryshon me më shumë se njëzet për qind;

b) çmimi i referencës rillogaritet brenda periudhës tarifore për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme nën të cilat mosrregullimi i niveleve të tarifave do të rrezikonte funksionimin e operatorit të sistemit të transmetimit.

Neni 13

Niveli i koeficientit dhe faktorët sezonalë

1. Niveli i koeficientit do të përfshijë pikat si më poshtë:

a) për produktet tremujore të kapacitetit standard dhe për produktet mujore të kapacitetit standard, niveli i koeficientit përkatës nuk duhet të jetë më i vogël se 1 dhe jo më shumë se 1,5;

b) për produktet ditore të kapacitetit standard dhe për produktet brenda ditës të kapacitetit standard, niveli i koeficientit përkatës nuk duhet të jetë më pak se 1 dhe jo më shumë se 3. Në raste të justifikuara, niveli i koeficientit përkatës mund të jetë më i vogël se 1, por më i lartë se 0, ose më i lartë se 3.

2. Aty ku janë aplikuar faktorët sezonalë, mesatarja aritmetike gjatë vitit të gazit të produktit të koeficientit të zbatueshëm për produktin përkatës të kapacitetit standard dhe faktorët përkatës sezonalë do të jenë brenda intervalit të njëjtë me atë të nivelit të koeficientit përkatës të përcaktuar në paragrafin 1.

3. Deri më 1 tetor 2025, niveli maksimal i koeficientëve për produktet ditore të kapacitetit standard dhe për produktet brenda ditës të kapacitetit standard nuk duhet të jetë më shumë se

1,5, nëse më 1 tetor 2023, Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë lëshon një rekomandim që maksimumi i nivelit të koeficientëve duhet të reduktohet në këtë nivel. Ky rekomandim duhet të marrë parasysh aspektet e mëposhtme në lidhje me përdorimin e koeficientëve dhe faktorëve sezonalë përpara dhe duke filluar nga 31 maji 2021:

- a) ndryshimet në sjelljen e rezervimit;
- b) ndikimi në të ardhurat e shërbimeve të transmetimit dhe rikuperimi i tij;
- c) dallimet midis nivelit të tarifave të transmetimit të zbatueshme për dy periudha tarifore të njëpasnjëshme;
- d) subvencionimi i ndërsjellë ndërmjet përdoruesve të rrjetit që kanë produkte të kontraktuara vjetore dhe jovjetore të kapacitetit standard;
- e) ndikimi në fluksin ndërkufitar.

Neni 14

Përlllogaritja e çmimeve të rezervës për produktet jovjetore të kapacitetit standard për kapacitetin e garantuar në mungesë të faktorëve sezonalë

Çmimet e rezervës për produktet jovjetore të kapacitetit standard për kapacitetin e garantuar do të llogariten si më poshtë:

a) për produktet tremujore të kapacitetit standard, për produktet mujore të kapacitetit standard dhe për produktet ditore të kapacitetit standard, në përputhje me formulën e mëposhtme:

$$P_{st} = (M \times T / 365) \times D$$

ku:

P_{st} është çmimi i rezervës për produktin përkatës të kapacitetit standard;

M është niveli i koeficientit që korrespondon me produktin përkatës të kapacitetit standard;

T është çmimi i referencës;

D është kohëzgjatja e produktit përkatës të kapacitetit standard shprehur në ditët e gazit.

Për vitet e brishta, formula duhet të rregullohet në mënyrë që shifra 365 të zëvendësohet me shifrën 366.

b) për produktet brenda ditës të kapacitetit standard, në përputhje me formulën e mëposhtme:

$$P_{st} = (M \times T / 8760) \times H$$

ku:



Pst është çmimi i rezervës për produktin brenda ditës të kapacitetit standard;

M është niveli i koeficientit përkatës;

T është çmimi i referencës;

H është kohëzgjatja e produktit brenda ditës të kapacitetit standard e shprehur në orë.

Për vitet e brishta, formula duhet të rregullohet në mënyrë që shifra 8760 të zëvendësohet me shifrën 8784.

Neni 15

Përlllogaritja e çmimeve të rezervës të produkteve standarde jovjetore të kapacitetit për kapacitetin e garantuar me faktorët sezonalë

1. Aty ku zbatohen faktorët sezonalë, çmimet e rezervës për produktet jovjetore të kapacitetit standard për kapacitetin e garantuar do të llogariten në përputhje me formulat përkatëse të përcaktuara në nenin 14, të cilat pastaj duhet të shumëzohen me faktorin përkatës sezonal të llogaritur siç përcaktohet në paragrafët 2 deri 6.

2. Metodologjia e përcaktuar në paragrafin 3 do të bazohet në flukset e parashikuara, përveç nëse sasia e fluksit të gazit së paku për një muaj është e barabartë me 0. Në këtë rast, metodologjia bazohet në kapacitetin e parashikuar të kontraktuar.

3. Për produktet mujore të kapacitetit standard për kapacitetin e garantuar, faktorët sezonalë do të llogariten si në hapat vijues:

a) për çdo muaj brenda një viti të dhënë të gazit përdorimi i sistemit të transmetimit do të llogaritet në bazë të flukseve të parashikuara ose kapacitetit të parashikuar të kontraktuar duke përdorur:

i. të dhënat për pikën individuale të interkonjeksionit, ku llogariten faktorët sezonalë për secilën pikë të interkonjeksionit;

ii. të dhënat mesatare për flukset e parashikuara ose kapacitetin e parashikuar të kontraktuar, ku faktorët sezonalë do të llogariten për disa ose të gjitha pikat e interkonjeksionit.

b) vlerat rezultuese të referuara në pikën “a” do të përmbledhen;

c) norma e përdorimit do të llogaritet duke ndarë secilën prej vlerave rezultuese të referuara në pikën “a” nga vlera rezultuese e referuar në pikën “b”;

d) secila nga vlerat rezultuese të referuara në pikën “c” do të shumëzohet me 12. Nëse vlerat

rezultuese janë të barabarta me 0, këto vlera do të përshtaten me cilëndo vlerë vijuese që është më e ulët: 0,1 ose më e ulëta e vlerave rezultuese përveç 0;

e) niveli fillestar i faktorëve përkatës sezonalë do të llogaritet duke ngritur secilën prej vlerave rezultuese të referuara në pikën “d” në të njëjtën fuqi që është jo më pak se 0 dhe jo më shumë se 2;

f) do të llogaritet mesatarja aritmetike e produkteve të vlerave rezultuese të referuara në pikën “e” dhe koeficienti për produktet mujore të kapacitetit standard;

g) vlera rezultuese e referuar në pikën “f” do të krahasohet me gamën e referuar në nenin 13 (1), si vijon:

i. nëse kjo vlerë bie në këtë gamë, atëherë niveli i faktorëve sezonalë do të jetë i barabartë me vlerat përkatëse rezultuese të referuara në pikën “e”;

ii. nëse kjo vlerë bie jashtë kësaj game atëherë do të zbatohet pika “h”.

h) niveli i faktorëve sezonalë llogaritet si produkt i vlerave rezultuese përkatëse të referuara në pikën “e” dhe faktori i korrigjimit i llogaritur si më poshtë:

i. aty ku vlera rezultuese e referuar në pikën “f” është më shumë se 1,5, faktori korrektues llogaritet si 1,5 i ndarë nga kjo vlerë;

ii. aty ku vlera rezultuese e referuar në pikën “f” është më e vogël se 1, faktori korrektues llogaritet si 1 i ndarë nga kjo vlerë.

4. Për produktet ditore të kapacitetit standard për kapacitetin e garantuar dhe produktet brenda ditës të kapacitetit standard për kapacitetin e garantuar, faktorët sezonalë do të llogariten duke zbatuar hapat e përcaktuar në paragrafin 3 (f) deri në (h), përshtatshmërisht *mutatis mutandis*.

5. Për produktet tremujore të kapacitetit standard për kapacitetin e garantuar, faktorët sezonalë do të llogariten me hapat vijues:

a) niveli fillestar i faktorëve përkatës sezonalë llogaritet si në vijim:

i. e barabartë me mesataren aritmetike të faktorëve përkatës sezonalë të zbatueshëm për tre muajt përkatës;

ii. jo më pak se niveli më i ulët dhe jo më i lartë se faktorët sezonalë përkatës të zbatueshëm për tre muajt përkatës.

b) do të ndërmerren hapat e parashikuar në paragrafin 3 (f) deri (h), duke përdorur vlerat



rezultuese të referuara në pikën “a”, përshtatshmërisht *mutatis mutandis*.

6. Për të gjitha produktet jovjetore të kapacitetit standard për kapacitetin e garantuar, vlerat që rezultojnë nga llogaritja e përmendur në paragrafët 3 deri 5 mund të rrumbullakosen lart ose poshtë.

Neni 16

Përlllogaritja e çmimeve të rezervës për produktet e kapacitetit standard për kapacitetin e ndërprerë

1. Çmimet e rezervës për produktet e kapacitetit standard për kapacitetin e ndërprerë do të llogariten duke shumëzuar çmimet e rezervës të produkteve përkatëse të kapacitetit standard për kapacitetin e garantuar të llogaritur siç përcaktohet në nenet 14 ose 15, sipas rastit, nga diferenca midis 100% dhe niveli i zbritjes *ex-ante* llogaritur siç përcaktohet në paragrafët 2 dhe 3.

2. Një zbritje *ex-ante* llogaritet në përputhje me formulën e mëposhtme:

$$Diex\text{-}ante = Pro \times A \times 100\%$$

ku:

Diex-ante është niveli i një zbritje *ex-ante*,

Pro faktori është probabiliteti i ndërprerjes i cili është vendosur ose miratuar në përputhje me nenin 41(6)(a) të direktivës 2009/73/EC në përputhje me nenin 28 dhe që i referohet llojit të produktit të kapacitetit standard për kapacitetin e ndërprerë;

A është faktori rregullues i cili është vendosur ose miratuar në përputhje me nenin 41(6)(a) të direktivës 2009/73/EC në pajtim me nenin 28, që zbatohet për të pasqyruar vlerën ekonomike të vlerësuar nga lloji i produktit të kapacitetit standard për kapacitetin e ndërprerë, të llogaritur për secilin, disa ose të gjitha pikat e interkonjeksionit, të cilat nuk duhet të jenë më pak se 1.

3. Pro faktori i përmendur në paragrafin 2 do të llogaritet për secilën, disa ose të gjitha pikat e interkonjeksionit për llojin e produktit të kapacitetit standard për kapacitetin e ndërprerjes të ofruar në përputhje me formulën e mëposhtme në bazë të informacionit të parashikuar në lidhje me përbërësit e kësaj formule:

$$Pro = \frac{N \times D_{int}}{D} \times \frac{CAP_{av.\ int}}{CAP}$$

ku:

N është pritshmëria e numrit të ndërprerjeve mbi D;

Dint është kohëzgjatja mesatare e ndërprerjeve të pritshme të shprehura në orë;

D është kohëzgjatja e përgjithshme e llojit përkatës të produktit të kapacitetit standard për kapacitetin e ndërprerë e shprehur në orë;

CAP av.int është shuma mesatare e pritshme e kapacitetit të ndërprerë për çdo ndërprerje kur një sasi e tillë lidhet me llojin përkatës të produktit të kapacitetit standard për kapacitetin e ndërprerë;

CAP është sasia totale e kapacitetit të ndërprerë për llojin përkatës të produktit të kapacitetit standard për kapacitetin e ndërprerë.

4. Si alternativë për zbatimin e zbritjeve *ex-ante* në përputhje me paragrafin 1, autoriteti rregullator kombëtar mund të vendosë të aplikojë një zbritje *ex-post*, ku përdoruesit e rrjetit kompensohen pas ndërprerjeve aktuale të shkaktuara. Kjo zbritje *ex-post* mund të përdoret vetëm në pikat e interkonjeksionit, ku nuk ka pasur ndërprerje të kapacitetit për shkak të mbingarkesës fizike në vitin e mëparshëm të gazit.

Kompensimi *ex-post* i paguar për çdo ditë në të cilën ndodh një ndërprerje do të jetë e barabartë me trefishin e çmimit rezervë të produkteve ditore të kapacitetit standard për kapacitetin e garantuar.

KREU IV

HARMONIZIMI I TË ARDHURAVE

Neni 17

Dispozita të përgjithshme

1. Parimet e mëposhtme do të zbatohen në vendin dhe në masën që operatori i sistemit të transmetimit funksionon nën një regjim me përjashtim të çmimit tavan:

a) nënrikuperimi ose mbirrikuperimi i të ardhurave nga shërbimet e transmetimit duhet të minimizohet duke marrë parasysh investimet e nevojshme;

b) niveli i tarifave të transmetimit do të sigurojë që të ardhurat e shërbimeve të transmetimit të rikuperojnë nga operatori i sistemit të transmetimit në kohën e duhur;

c) dallimet e konsiderueshme midis niveleve të tarifave të transmetimit të zbatueshme për dy



periudha tarifore të njëpasnjëshme duhet të shmangen deri në masën e mundshme.

2. Ku dhe për aq sa operatori i sistemit të transmetimit funksionon nën regjimin e çmimit tavan ose zbaton një metodë fikse të çmimeve të pagueshme të përcaktuara në nenin 24 (b), nuk do të ndodhë harmonizimi i të ardhurave dhe të gjitha rreziqet që lidhen me nën- ose mbirikuperimin do të mbulohen ekskluzivisht nga primi i riskut. Në këtë rast, nenet 18, 19 (1) deri (4) dhe 20 nuk do të zbatohen.

3. Duke iu nënshtuar kërkesave të konsultimeve periodike sipas nenit 26 dhe sipas miratimit në përputhje me nenin 41(6)(a) të direktivës 2009/73/EC, të ardhurat nga shërbimet që nuk lidhen me transmetimin mund të harmonizohen siç përcaktohet në kreun IV, *mutatis mutandis*.

Neni 18

Nën- dhe mbirikuperimi

Nën- ose mbirikuperimi i të ardhurave të shërbimeve të transmetimit do të jetë i barabartë me:

RA – R

ku:

RA është e ardhura aktuale në lidhje me ofrimin e shërbimeve të transmetimit;

R është e ardhura e shërbimeve të transmetimit. Vlerat e RA dhe R do t'i atribuohen të njëjtës periudhë tarifore dhe, ku një mekanizëm efektiv i kompensimit të operatorit të sistemit ndërtransmetues i përcaktuar në nenin 10 (3) është vendosur, do të marrë në konsideratë një mekanizëm të tillë.

Ku ndryshimi i llogaritur në përputhje me paragrafin 1 është pozitiv, ai duhet të tregojë një mbirikuperim të të ardhurave të shërbimeve të transmetimit. Ku ndryshimi i tillë është negativ, do të tregojë një nën-rikuperim të të ardhurave të shërbimeve të transmetimit.

Neni 19

Llogaria rregullatore

1. Llogaria rregullatore do të tregojë informacionin e përmendur në nenin 18(1) për një periudhë tarifore të caktuar dhe mund të përfshijë informacione të tjera, siç është dallimi mes

komponentëve të parashikuar dhe atyre aktual të kostos.

2. Të ardhurat e shërbimeve të transmetimit të nën- ose mbirikuperuara të operatorit të sistemit të transmetimit i atribuohen llogarisë rregullatore, përveç nëse rregulla të tjera janë miratuar në përputhje me nenin 41(6)(a) të direktivës 2009/73/EC.

3. Ku zbatohen mekanizmat nxitës për shitjet e kapaciteteve, në varësi të një vendimi në përputhje me nenin 41(6)(a) të direktivës 2009/73/EC, vetëm një pjesë e nën- ose mbirikuperimit të operatorit të sistemit të transmetimit duhet t'i atribuohet llogarisë rregullatore. Në një rast të tillë, pjesa e mbetur e saj do të mbahet ose paguhet, sipas rastit, nga operatori i sistemit të transmetimit.

4. Secili operator i sistemit të transmetimit do të përdorë një llogari rregullatore.

5. Në varësi të një vendimi në përputhje me nenin 41(6)(a) të direktivës 2009/73/EC, primi i fituar i ankandit, nëse ka, mund t'i atribuohet një llogarie të veçantë të ndarë nga llogaria rregullatore e përmendur në paragrafin 4. Autoriteti rregullator kombëtar mund të vendosë ta përdorë këtë prim ankandi për të zvogëluar mbingarkesën fizike ose, ku operatori i sistemit të transmetimit funksionon vetëm nën regjimin e kufizuar të çmimit tavan, për të ulur tarifat e transmetimit për periudhën /at e ardhshme tarifore siç përcaktohet në nenin 20.

Neni 20

Harmonizimi i llogarisë rregullatore

1. Harmonizimi i plotë ose i pjesshëm i llogarisë rregullatore do të kryhet në përputhje me metodologjinë e aplikuar të çmimit të referencës dhe përveç kësaj, duke përdorur ngarkesën e përmendur në nenin 4(3)(b), nëse zbatohet.

2. Harmonizimi i llogarisë rregullatore do të kryhet në përputhje me rregullat e miratuara në përputhje me nenin 41 (6) (a) të direktivës 2009/73 / KE për një periudhë harmonizimi të caktuar, që do të thotë periudha kohore gjatë së cilës llogaria rregullatore referuar në nenin 19 do të harmonizohet.

3. Llogaria rregullatore do të harmonizohet me qëllim rimbursimin e operatorit të sistemit të transmetimit nën-rimëkëmbjen dhe kthimin e mbirikuperimit të përdoruesit e rrjetit.



KREU V
ÇMIMI I KAPACITETIT TË LIDHUR DHE
KAPACITETIT NË PIKËN VIRTUALE TË
INTERKONJEKSIONIT

Neni 21

Çmimi i Kapacitetit të Lidhur

1. Çmimi i rezervës për një produkt të kapacitetit të lidhur do të jetë i barabartë me shumën e çmimeve të rezervës për kapacitetet që kontribuojnë në atë produkt. Çmimet e rezervës për kapacitetet përkatëse hyrëse dhe dalëse do të vihen në dispozicion kur produkti i kapacitetit të lidhur ofrohet dhe shpërndahet nëpërmjet një platforme të përbashkët të rezervës të referuar në nenin 37 të rregullores (BE) 2017/459.

2. Të ardhurat që rrjedhin nga shitjet e produkteve me kapacitet të lidhur me çmimin e rezervës për një produkt të tillë i atribuohen operatorëve përkatës të sistemit të transmetimit si më poshtë:

a) pas çdo transaksioni për një produkt të kapacitetit të lidhur;

b) në proporcion me çmimet e rezervës për kapacitetet që kontribuojnë në këtë produkt.

3. Primi i ankandit që rrjedh nga shitjet e produkteve të kapacitetit të lidhur duhet të atribuohet në përputhje me marrëveshjen ndërmjet operatorëve përkatës të sistemit të transmetimit i cili është objekt i miratimit nga autoriteti ose autoritetet rregullatore kombëtare që duhet të jepen jo më vonë se tre muaj përpara fillimit të ankandeve vjetore të kapacitetit vjetor. Në mungesë të miratimit të tillë nga të gjitha autoritetet rregullatore kombëtare të përfshira, primi i ankandit i atribuohet operatorëve përkatës të sistemit të transmetimit në mënyrë të barabartë.

4. Ku pika e interkonjeksionit në fjalë lidhet me sistemet fqinje hyrëse-dalëse të dy palëve kontraktore, autoritetet rregullatore kombëtare përkatëse do të dorëzojnë marrëveshjen e përmendur në paragrafin 3 në Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë për informacion. Neni 22

Çmimi i kapacitetit në pikën virtuale të interkonjeksionit

1. Çmimi i rezervës për një produkt me kapacitet të ndarë të ofruar në pikën virtuale të

interkonjeksionit do të llogaritet në përputhje me njërin nga metodat e mëposhtme:

a) llogaritur mbi bazën e çmimit të referencës, ku metodologjia e çmimit të referencës së aplikuar lejon marrjen parasysh të pikës së lëvrimit të interkonjeksionit;

b) e barabartë me mesataren e ponderuar të çmimeve të rezervës, ku mesatarja e tillë llogaritet në bazë të çmimeve të referencës për secilën pikë interkonjektive që kontribuon në pikën e tillë virtuale të interkonjeksionit, ku metodologjia e çmimit të referencës së aplikuar nuk lejon marrjen parasysh të ndërlidhjes virtuale të pikës së lëvrimit, në përputhje me formulën e mëposhtme:

$$P_{st, VIP} = \frac{\sum_i^n (P_{st, i} \times CAP_i)}{\sum_i^n CAP_i}$$

ku:

$P_{st, VIP}$ është çmimi i rezervës për një produkt të dhënë të ndarë të kapacitetit standard në pikën virtuale të interkonjeksionit;

i është një pikë interkonjeksioni që kontribuon në pikën virtuale të interkonjeksionit;

n është numri i pikave të interkonjeksionit që kontribuojnë në pikën virtuale të interkonjeksionit;

$P_{st, i}$ është çmimi i rezervës për një produkt të dhënë të kapacitetit standard të ndarë në pikën e interkonjeksionit i ;

CAP_i është kapaciteti teknik ose kapaciteti i parashikuar i kontraktuar, si i rëndësishëm, në pikën e interkonjeksionit i .

2. Çmimi i rezervës për një produkt të kapacitetit standard të lidhur të ofruar në një pikë virtuale të interkonjeksionit do të llogaritet siç është përcaktuar në nenin 21 (1).

KREU VI
ÇMIMI “EKUILIBËR” DHE ÇMIMI I
PAGUESHËM

Neni 23

Llogaritja e çmimit “EKUILIBËR” në pikat e interkonjeksionit

Çmimi i “ekuilibrit” (*clearing price*) për një produkt të kapacitetit të dhënë në një pikë interkonjeksioni do të llogaritet në përputhje me formulën e mëposhtme:



$$Pcl = PR, au + AP$$

ku:

Pcl është çmimi ekuilibër;

P R,au është çmimi i rezervës i aplikueshëm për një produkt të kapacitetit standard që publikohet në kohën kur ky produkt është vënë në ankand;

AP është primi i ankandit, nëse ka.

Neni 24

Llogaritja e çmimit të pagueshëm në pikat e interkonjeksionit

Çmimi i pagueshëm për një produkt të kapacitetit të dhënë në një pikë interkonjeksioni duhet të llogaritet në përputhje me njërin nga format e mëposhtme:

a) kur përdoret qasja e çmimeve të pagueshme:

b)

$$Pflo = PR, flo + AP$$

ku:

Pflo është çmimi variabël i pagueshëm;

PR,flo është çmimi i rezervës për një produkt me kapacitet standard i aplikuar në kohën kur ky produkt mund të përdoret;

AP është primi i ankandit, nëse ka.

b) kur zbatohet qasja e çmimeve fikse të pagueshme:

$$Pfix = (PR, y \times IND) + RP + AP$$

ku:

Pfix është çmimi fiks i pagueshëm;

PR,y është çmimi i aplikueshëm i rezervës për një produkt të kapacitetit vjetor i cili është publikuar në kohën kur ky produkt hidhet në ankand;

IND është raporti midis indeksit të zgjedhur në kohën e përdorimit dhe të njëjtit indeks në kohën kur produkti hidhet në ankand;

RP është primi i riskut që pasqyron përfitimet e sigurisë në lidhje me nivelin e tarifës së transmetimit, ku primi i tillë nuk duhet të jetë më i vogël se 0;

AP është primi i ankandit, nëse ka.

Neni 25

Kushtet për ofrimin e qasjeve të çmimeve të pagueshme

1. Ku dhe në masën që operatori i sistemit të transmetimit funksionon nën një regjim të kufizuar ku nuk aplikohen çmimet tavan, kushtet për ofrimin e qasjeve të çmimeve të pagueshme janë si më poshtë:

a) për rastet kur ofrohet vetëm kapaciteti ekzistues:

i. do të ofrohet qasja e çmimeve variabël të pagueshme;

ii. qasja e çmimeve fikse të pagueshme nuk lejohet.

b) për kapacitetin në rritje dhe kapacitetin ekzistues të ofruar në ankandin e njëjtë ose mekanizmin alternativ të alokimit:

i. mund të ofrohet qasja e çmimit variabël të pagueshëm;

ii. qasja e çmimeve fikse të pagueshme mund të ofrohet kur plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:

1) përdoret një mekanizëm alternativ alokimi i përcaktuar në nenin 30 të rregullores (BE) 2017/459;

2) përfshihet një projekt në listën e Projekteve të Interesit të Komunitetit të Energjisë ose projekteve të interesave të përbashkët siç përcaktohet në nenin 3 të rregullores (EU) nr. 347/2013, të miratuar dhe përshtatur me vendimin e Këshillit Ministror 2015/09/MC-EnC.

2. Ku dhe për aq sa operatori i sistemit të transmetimit funksionon nën regjimin e kufizuar të çmimeve tavan, mund të ofrohet qasja e çmimeve variabël të pagueshme ose qasja e çmimit fiks i pagueshëm ose të dyja.

KREU VII

KËRKESAT PËR KONSULTIME

Neni 26

Konsultimet periodike

1. Një ose më shumë konsultime do të kryhen nga autoriteti rregullator kombëtar ose operatori i sistemit të transmetimit, siç është vendosur nga autoriteti rregullator kombëtar. Për aq sa është e mundur dhe me qëllim që të bëhet më efektiv procesi i konsultimit, dokumenti i konsultimit



duhet të publikohet në gjuhën angleze. Konsultimi përfundimtar para vendimit të përmendur në nenin 27 (4) duhet të përputhet me kërkesat e përcaktuara në këtë nen dhe nenin 27, dhe duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

a) përshkrimin e metodologjisë së propozuar të çmimeve referuese, si dhe pikat e mëposhtme:

i. informacionin tregues të përcaktuar në nenin 30(1)(a), duke përfshirë:

1. justifikimin e parametrave të përdorur që lidhen me karakteristikat teknike të sistemit;

2. informacionin për vlerat përkatëse të këtyre parametrave dhe supozimet e aplikuar.

ii. vlerën e përshtatjeve të propozuara për tarifën e transmetimit të bazuara në kapacitete sipas nenit 9;

iii. çmimet referuese indikative që i nënshtrohen konsultimit;

iv. rezultatet, përbërësit dhe detajet e këtyre komponentëve për vlerësimet e alokimit të kostove të përcaktuara në nenin 5;

v. vlerësimin e metodologjisë së propozuar të çmimit të referencës në përputhje me nenin 7;

vi. ku metodologjia e propozuar e çmimit të referencës është e ndryshme nga metodologjia e çmimit të referencës së distancës së ponderuar të kapacitetit të detajuar në nenin 8, krahasimi i tij kundrejt këtij të fundit shoqërohet me informacionin e paraqitur në pikën “iii”;

b) informacionin tregues i përcaktuar në nenin 30(1)(b)(i),(iv),(v);

c) informacioni i mëposhtëm mbi tarifën e transmetimit dhe jo të transmetimit:

i. ku propozohen tarifën e transmetimit të bazuara në produkt nga neni 4(3):

1. mënyrën në të cilën ato janë përcaktuar;

2. pjesa e të ardhurave të lejuara apo të synuara që parashikohen të mbulohen nga këto tarifa;

3. tarifën e transmetimit të bazuara në produkt;

ii. ku propozohen shërbimet që nuk kanë lidhje me transmetimin të ofruara për përdoruesit e rrjetit

1. metodologjinë e tarifave të shërbimit jotransmetues;

2. pjesa e të ardhurave të lejuara apo të synuara që parashikohen të mbulohen nga këto tarifa;

3. mënyrën në të cilën barazohen të ardhurat e shërbimeve që nuk lidhen me transmetimin siç parashikohet sipas nenit 17(3);

4. tarifën indikative të që nuk lidhen me transmetimin për shërbimet që nuk lidhen me transmetimin për përdoruesit e rrjetit;

d) informacionin indikativ të përcaktuar në nenin 30 (2);

e) ku qasja e çmimeve fikse të pagueshme të përmendura në nenin 24 (b) konsiderohet të ofrohet sipas regjimit të kufizuar të çmimeve tavan për kapacitetin ekzistues:

i. indeksin e propozuar;

ii. llogaritjen e propozuar dhe mënyrën se si përdoren të ardhurat që rrjedhin nga primi i riskut;

iii. në të cilën pika/t e interkonjeksionit dhe për të cilat periudha/t tarifore është propozuar një qasje e tillë;

iv. procesin e ofrimit të kapacitetit në një pikë interkonjeksioni, ku propozohen si qasje të çmimeve fikse të pagueshme ashtu edhe ato variabël të përmendura në nenin 24.

2. Konsultimi përfundimtar para vendimit të përmendur në nenin 27 (4) do të jetë i hapur për të paktën dy muaj. Dokumentet e konsultimit për cilin do nga konsultimet e përmendura në paragrafin 1 mund të kërkojnë që përgjigjet e dërguara nga rezultatet e konsultimit të përfshijnë një version jokonfidencial të përshtatshëm për publikim.

3. Brenda një muaji pas përfundimit të konsultimit, operatori i sistemit të transmetimit ose autoriteti rregullator kombëtar, në varësi të subjektit që publikon dokumentin e konsultimit të përmendur në paragrafin 1, do të publikojë përgjigjet e konsultimit të marra dhe përmbledhjen e tyre. Për aq sa është e mundur dhe me qëllim që të bëhet më efektiv procesi i konsultimit, përmbledhja do të sigurohet në gjuhën angleze.

4. Konsultimet periodike pasuese do të bëhen në përputhje me nenin 27(5).

5. Për dokumentin e konsultimit të përmendur në paragrafin 1, mund të përdoret modeli i hartuar nga Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve Evropianë.

Neni 27

Vendimmarrjet periodike të autoritetit rregullator kombëtar

1. Me nisjen e konsultimit përfundimtar në përputhje me nenin 26 përpara vendimit të përmendur në nenin 27 (4), autoriteti rregullator kombëtar ose operatori i sistemit të transmetimit,



siç është vendosur nga autoriteti rregullator kombëtar, do të përcjellë dokumentet e konsultimit në Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë.

2. Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë do të analizojë aspektet e mëposhtme të dokumentit të konsultimit:

a) nëse të gjitha informatat e përmendura në nenin 26 (1) janë publikuar;

b) nëse elementet e konsultuara në përputhje me nenin 26 janë në përputhje me kërkesat e mëposhtme:

1) nëse metodologjia e propozuar e çmimit të referencës është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 7;

2) nëse janë plotësuar kriteret për vendosjen e tarifave të transmetimit të bazuar në produkt, siç përcaktohet në nenin 4(3);

3) nëse janë plotësuar kriteret për caktimin e tarifave që nuk lidhen me transmetimin siç përcaktohet në nenin 4(4).

3. Brenda dy muajve pas përfundimit të konsultimit të referuar në paragrafin 1, Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë do të publikojë dhe do t'i dërgojë autoritetit rregullator kombëtar ose operatorit të sistemit të transmetimit, në varësi të cilit subjekt ka publikuar dokumentin e konsultimit dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë përfundimi i analizës së tij në përputhje me paragrafin 2 në gjuhën angleze.

Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë do të ruajë konfidencialitetin e çdo informacioni komercialisht të ndjeshëm.

4. Brenda pesë muajve pas përfundimit të konsultimit përfundimtar, autoriteti rregullator kombëtar, duke vepruar në përputhje me nenin 41(6)(a) të direktivës 2009/73/EC, merr dhe publikon një vendim të motivuar për të gjitha elementët e përcaktuara në nenin 26(1). Pas publikimit, autoriteti rregullator kombëtar do të dërgojë në Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë vendimin e tij.

5. Procedura që konsiston në konsultimet përfundimtare mbi metodologjinë e çmimit të referencës në përputhje me nenin 26, vendimi nga autoriteti rregullator kombëtar në përputhje me paragrafin 4, llogaritja e tarifave në bazë të këtij vendimi dhe publikimi i tarifave në përputhje me kreun VIII mund të iniciohet që nga hyrja në fuqi e këtij Kodi dhe do të përfundojë jo më vonë se data

31 maj 2021. Kërkesat e përcaktuara në kreun II, III dhe IV do të merren parasysh në këtë procedurë. Tarifat e aplikueshme për periudhën tarifore deri më 31 maj 2021 do të zbatohen deri në fund të saj. Kjo procedurë duhet të përsëritet të paktën çdo pesë vjet duke filluar nga data 31 maj 2021.

Neni 28

Konsultimet rreth zbritjeve, koeficientëve dhe faktorëve sezonalë

1. Në të njëjtën kohë me konsultimin përfundimtar të kryer në përputhje me nenin 26 (1), autoriteti rregullator kombëtar do të kryejë një konsultim me autoritetet rregullatore kombëtare të të gjitha shteteve anëtare të lidhura drejtpërsëdrejti dhe palëve kontraktore dhe aksionerët përkatës për sa vijon:

a) niveli i koeficientëve;

b) nëse është i aplikueshëm, niveli i faktorëve sezonalë dhe llogaritjet e përcaktuara në nenin 15;

c) nivelet e zbritjeve të përcaktuara në nenin 9(2) dhe 16. Pas përfundimit të konsultimit do të merret një vendim i motivuar në përputhje me nenin 41(6)(a) të direktivës 2009/73/EC mbi aspektet e përmendura në pikat “a” deri “c” të këtij paragrafi. Secili autoritet rregullator kombëtar do të marrë në konsideratë pozicionet e autoriteteve rregullatore kombëtare të shteteve anëtare të lidhura drejtpërsëdrejti dhe palëve kontraktore.

2. Konsultimet pasuese do të kryhen çdo periudhë tarifore nga data e vendimit të përmendur në paragrafin 1. Pas çdo konsultimi dhe siç përcaktohet në nenin 32 (a), autoriteti rregullator kombëtar merr dhe publikon një vendim të motivuar mbi aspektet e referuara në paragrafin 1 (a), (b) dhe (c).

3. Kur miratohet vendimi i përmendur në paragrafët 1 dhe 2, autoriteti rregullator kombëtar merr parasysh përgjigjet në konsultim dhe aspektet e mëposhtme:

a) për koeficientët:

i. balanca ndërmjet lehtësimit të tregtisë së gazit afatshkurtër dhe ofrimit të sinjaleve afatgjata për investime efikase në sistemin e transmetimit;

ii. ndikimin në të ardhurat e shërbimeve të transmetimit dhe rikuperimin e tij;



iii. nevoja për të shmangur ndërsbvencionimin ndërmjet përdoruesve të rrjetit dhe për të rritur reflektimin e kostove të çmimeve të rezervës;

iv. situata të kongestionit fizik dhe kontraktual;

v. ndikimi në fluksin ndërkufitar;

b) për faktorët sezonalë:

i. ndikimin në lehtësimin e shfrytëzimit ekonomik dhe efikas të infrastrukturës;

ii. nevojën për të përmirësuar reflektimin e kostove të çmimeve të rezervës.

KREU VIII

KËRKESAT PËR PUBLIKIME

Neni 29

Informacioni për t'u publikuar përpara ankandit vjetor të kapacitetit vjetor

Për pikat e interkonjeksionit dhe, ku autoriteti rregullator kombëtar merr vendim për të aplikuar rregulloren (EU) 2017/459, pikat përveç pikës së interkonjeksionit, informacionet e mëposhtme duhet të publikohen përpara ankandit vjetor të kapacitetit vjetor në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenet 31 dhe 32 nga autoriteti rregullator kombëtar ose operatori/et i sistemit të transmetimit, siç është vendosur nga autoriteti rregullator kombëtar:

a) për produktet e kapacitetit standard për kapacitetin e garantuar:

i. çmimet e rezervës të aplikueshme deri në fund të vitit të gazit që fillon pas ankandit vjetor të kapacitetit vjetor;

ii. koeficientët dhe faktorët sezonalë që aplikohen në çmimet e rezervës për produktet jovjetore të kapacitetit standard;

iii. arsyetimin e autoritetit rregullator kombëtar për nivelin e koeficientëve;

iv. ku faktorët sezonalë janë zbatuar, do të bëhet arsyetimi për aplikimin e tyre.

b) për produktet e kapacitetit standard për kapacitetin e ndërprerës:

i. çmimet e rezervës të aplikueshme deri në fund të vitit të gazit që fillon pas ankandit vjetor të kapacitetit vjetor;

ii. një vlerësim të probabilitetit të ndërprerjes, duke përfshirë:

1) listën e të gjitha llojeve të produkteve të kapacitetit standard për kapacitetet e ndërprera të

ofruara duke përfshirë probabilitetin përkatës të ndërprerjes dhe nivelin e zbritjes së aplikuar;

2) shpjegimin se si probabiliteti i ndërprerjes është llogaritur për secilin lloj produkti të referuar në pikën 1;

3) të dhënat historike ose të parashikuara, ose të dyja, të përdorura për vlerësimin e probabilitetit të ndërprerjes të përmendur në pikën 2.

Neni 30

Informacioni për t'u publikuar përpara periudhës tarifore

1. Informacioni i mëposhtëm do të publikohet përpara periudhës tarifore në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenet 31 dhe 32 nga autoriteti rregullator kombëtar ose operatori i sistemit të transmetimit, siç është vendosur nga autoriteti rregullator kombëtar:

a) informacion mbi parametrat e përdorura në metodologjinë e çmimit të referencës së aplikuar që lidhen me karakteristikat teknike të sistemit të transmetimit, si:

i. kapaciteti teknik në pikat hyrëse dhe dalëse dhe supozimet e lidhura;

ii. kapaciteti i kontraktuar i parashikuar në pikat hyrëse dhe dalëse dhe supozimet e lidhura;

iii. sasinë dhe drejtimin e rrjedhës së gazit për pikat hyrëse dhe dalëse dhe supozimet e lidhura me to, siç janë skenarët e kërkesës dhe furnizimit për rrjedhën e gazit në kushtet e pikut;

iv. përfaqësimi strukturor i rrjetit të transmetimit me një nivel të detajuar;

v. informacione shtesë teknike për rrjetin e transmetimit, të tilla si gjatësia dhe diametri i tubacioneve dhe fuqia e stacioneve të kompresorëve.

b) informacionin e mëposhtëm:

i. të ardhurat e lejuara ose të synuara, ose të dyja, të operatorit të sistemit të transmetimit;

ii. informacionin lidhur me ndryshimet në të ardhurat e përmendura në pikën “i” nga një vit në vitin e ardhshëm;

iii. parametrat e mëposhtëm:

1) llojet e pasurive të përfshira në bazën e rregulluara të aseteve dhe vlerën e tyre të grupuar;

2) koston e kapitalit dhe metodologjinë e saj të llogaritjes;

3) shpenzimet kapitale, duke përfshirë:



a) metodologjitë për të përcaktuar vlerën fillestare të aseteve;

b) metodologjitë për rivlerësimin e aseteve;

c) shpjegimet e ndryshimit të vlerës së aseteve;

d) periudhat e zhvlerësimit dhe shumat për llojin e asetit

4) shpenzimet operationale;

5) mekanizmat nxitës dhe objektivat e efikasitetit;

6) indekset e inflacionit.

iv. të ardhurat nga shërbimet e transmetimit;

v) raportet e mëposhtme për të ardhurat e përmendura në pikën “iv”:

1) ndarje produkt-kapacitet, që nënkupton ndarjen midis të ardhurave nga tarifat e transmetimit të bazuara në kapacitete dhe të ardhurave nga tarifat e transmetimit të bazuar në produkt;

2) ndarje hyrëse-dalëse, që nënkupton ndarjen midis të ardhurave nga tarifat e transmetimit të kapaciteteve në të gjitha pikat hyrëse dhe të ardhurat nga tarifat e transmetimit të kapaciteteve në të gjitha pikat dalëse;

3) ndarje në sistem/ndërsistem, që nënkupton ndarjen midis të ardhurave nga përdorimi i rrjetit brenda sistemit në të dy pikat hyrëse dhe pikat dalëse dhe të ardhurat nga përdorimi i rrjetit ndërsistemor në të dy pikat hyrëse dhe pikat dalëse llogaritur si të përcaktuara në nenin 5.

vi. ku dhe për aq sa operatori i sistemit të transmetimit funksionon nën regjimin e kufizuar që nuk lidhen me çmimet tavan, informacioni i mëposhtëm në lidhje me periudhën e mëparshme tarifore për harmonizimin e llogarisë rregullatore:

1) të ardhurat e përfituara aktuale, nën- ose mbirikuperimin e të ardhurave të lejuara dhe pjesën e saj që i takon llogarisë rregullatore dhe, nëse aplikohet, nën-llogaritë brenda llogarisë së tillë rregullatore;

2) periudhën e bashkërendimit dhe mekanizmat nxitës të zbatuar.

vii. përdorimi i synuar i primeve të ankandit.

c) informacionin e mëposhtëm mbi tarifat e transmetimit dhe tarifat që nuk lidhen me transmetimin, të shoqëruara me informacionin përkatës në lidhje me derivimin e tyre:

i. ku zbatohen, tarifat e transmetimit të bazuara në produkt të përmendura në nenin 4 (3);

ii. ku zbatohen, tarifat që nuk lidhen me transmetimin për shërbimet jashtë transmetimit të përmendura në nenin 4(4);

iii. çmimet e referencës dhe çmimet e tjera të zbatueshme në pikat e ndryshme nga ato të përmendura në nenin 29.

2. Përveç kësaj, informacionet e mëposhtme do të publikohen në lidhje me tarifat e transmetimit:

a) shpjegimin e mëposhtëm:

i. ndryshimi në nivelin e tarifave të transmetimit për të njëjtin lloj shërbimi transmetimi të zbatueshëm për periudhën tarifore të aplikueshme dhe për periudhën tarifore për të cilën publikohet informacioni;

ii. ndryshimi i parashikuar në nivelin e tarifave të transmetimit për të njëjtin lloj shërbimi transmetimi të aplikueshëm për periudhën tarifore për të cilën publikohet informacioni dhe për çdo periudhë tarifore brenda pjesës së mbetur të periudhës rregullatore.

b) të paktën një model tarifar të thjeshtuar, të përditësuar rregullisht, shoqëruar me shpjegimin se si ta përdorë atë, duke u mundësuar përdoruesve të rrjetit që të llogarisin tarifat e transmetimit të aplikueshme për periudhën tarifore mbizotëruese dhe të vlerësojnë ndryshimet e tyre të mundshme përtej kësaj periudhe tarifore.

3. Për pikat e përjashtuara nga përkufizimi i pikave përkatëse të referuara në pikën 3.2 (1) (a) të aneksit I të rregullores (EC) nr. 715/2009, informacioni mbi sasinë e kapacitetit të parashikuar të kontraktuar dhe sasinë e parashikuar të rrjedhës së gazit do të publikohet siç përcaktohet në pikën 3.2 (2) të aneksit I të rregullores (KE) nr. 715/2009.

Neni 31

Mënyra e publikimit

1. Për palët kontraktore, OST-të e të cilëve janë anëtarë ose vëzhgues të ENTSO për gazin, informacioni i referuar në nenin 29 dhe 30 do të publikohet siç përcaktohet në nenin 32 nëpërmjet një lidhjeje në platformën e përmendur në pikën 3.1.1 (1) (h) të aneksit I të rregullores (KE) nr. 715/2009 në faqen e internetit të subjektit përkatës. Për palët e tjera kontraktore, informacioni i referuar në nenin 29 dhe 30 do të publikohet në faqen e internetit të operatorit kombëtar të sistemit të transmetimit për gazin.



Informacioni i tillë do të jetë i arritshëm për publikun, pa pagesë dhe pa limit në përdorimin e tij. Ai do të publikohet:

- a) i thjeshtë për përdoruesin;
- b) në mënyrë të qartë, lehtësisht të arritshme dhe në baza jodiskriminuese;
- c) në një format të shkarkueshëm;
- d) në një ose më shumë gjuhë zyrtare të Palës Kontraktore dhe, më së shumti, në gjuhën angleze.

2. Për palët kontraktore OST-ja e së cilave janë anëtare ose vëzhguese të ENTO-s për gazin informacioni i mëposhtëm do të publikohet për pikat e interkonjeksionit në platformën e përmendur në pikën 3.1.1 (1) (h) të aneksit I të rregullores (EC) nr. 715/2009:

a) në të njëjtën kohë siç përcaktohet në nenin 29, çmimet e rezervës për produktet e kapacitetit standard për kapacitetin e garantuar dhe për produktet e kapacitetit standard për kapacitetin e ndërprerë;

b) në të njëjtën kohë siç përcaktohet në nenin 30, një pagesë e bazuar në fluks e referuar në nenin 4 (3) (a), ku zbatohet.

Për palët e tjera kontraktore një informacion i tillë do të publikohet në faqen zyrtare të operatorit kombëtar të sistemit të transmetimit për gazin.

3. Informacioni i referuar në paragrafin 2 do të publikohet në këtë mënyrë:

- a) siç përcaktohet në paragrafin 1 (a) deri (c);
- b) në gjuhën angleze;
- c) në një tabelë të standardizuar e cila duhet të përfshijë së paku informacionin e mëposhtëm:
 - i. pikën e interkonjeksionit;
 - ii. drejtimin e fluksit të gazit;
 - iii. emrat e operatorëve përkatës të sistemit të transmetimit;
 - iv. kohën e fillimit dhe përfundimit të produktit;
 - v. nëse kapaciteti është i garantuar ose i ndërprerë;
 - vi. indikacionin e produktit të kapacitetit standard;

vii. tarifën e aplikueshme për kWh / h dhe për kWh / d në monedhën vendase dhe në euro duke marrë parasysh:

1) ku njësia e kapacitetit të aplikuar është kWh / h, informacioni mbi tarifën e aplikueshme për kWh / d nuk është i detyrueshëm dhe anasjelltas;

2) ku monedha vendase është e ndryshme nga euro, informacioni mbi tarifën e aplikueshme në euro nuk është i detyrueshëm.

Përveç kësaj, në të njëjtën kohë siç përcaktohet në nenin 30, tabela e tillë e standardizuar përfshin simulimin e të gjitha shpenzimeve për fluksin e 1 GWh / ditë / vit për çdo pikë interkonjeksionit në monedhën vendase dhe në euro sipas pikës vii (2).

4. Ku informacioni i përmendur në paragrafin 2 është i ndryshëm nga informacioni përkatës i përmendur në paragrafin 1, do të merret për bazë informacioni përkatës i përmendur në paragrafin 1.

Neni 32

Periudha e njoftimit të publikimit

Afati i fundit për publikimin e informacionit të përcaktuar në nenin 29 dhe 30 do të jetë si vijon:

a) për informacionin e përcaktuar në nenin 29, jo më vonë se tridhjetë ditë përpara ankandit vjetor të kapacitetit vjetor;

b) për informacionin e përcaktuar në nenin 30, jo më vonë se tridhjetë ditë para periudhës përkatëse tarifore;

c) për tarifën përkatëse të transmetimit të përditësuar brenda periudhës tarifore të përcaktuar në nenin 12 (3), menjëherë pas miratimit në përputhje me nenin 41(6)(a) të direktivës 2009/73/EC.

Çdo përditësim i tarifave të transmetimit do të shoqërohet me informacione që tregojnë arsyet për ndryshimet në nivelin e tyre. Ku zbatohet neni 12(3)(b), gjithashtu do të shoqërohet me raportin e përditësuar të referuar në nenin 29(b) për llojet përkatëse të produkteve të kapacitetit standard për kapacitetin e ndërprerë.

KREU IX

KAPACITETI I SHTUAR

Neni 33

Parimet tarifore për kapacitetin e shtuar

1. Çmimi minimal me të cilin operatorët e sistemit të transmetimit do të pranojnë një kërkesë për kapacitet shtesë është çmimi i referencës. Për llogaritjen e testit ekonomik, çmimet e referencës do të përfshihen duke përfshirë në metodologjinë e çmimit të referencës supozimet përkatëse lidhur me ofertën e kapacitetit shtesë.

2. Ku qasja e çmimit fiks të pagueshëm përcaktuar në nenin 24(b) konsiderohet të jetë ofruar për kapacitetin shtesë, çmimi i rezervimit i



përmendur në nenin 24(b) do të bazohet në kostot e investimeve të parashikuara dhe operative. Sapo të jetë vendosur kapaciteti i shtuar, çmimi i tillë i rezervimit do të rregullohet proporcionalisht me diferencën, pavarësisht nëse është pozitive ose negative, ndërmjet kostove të investimit të parashikuar dhe kostove aktuale të investimit.

3. Në rast se alokimi i të gjithë kapacitetit të shtuar me çmimin e referencës nuk do të gjeneronte të ardhura të mjaftueshme për një rezultat pozitiv të testit ekonomik, një prim minimal i detyrueshëm mund të zbatohet në ankandin e parë ose mekanizmin alternativ të alokimit në të cilin ofrohet kapaciteti i shtuar. Primi minimal i detyrueshëm mund të zbatohet edhe në ankandet e mëvonshme kur ofrohet kapaciteti i cili fillimisht ka mbetur i pashtur ose kur ofrohet një kapacitet i cili fillimisht është caktuar sipas nenit 8(8) dhe (9) të rregullores (BE) 2017/459. Vendimi nëse dhe në cilat ankande duhet aplikuar një minimum primi i detyrueshëm do të merret në përputhje me nenin 41(6)(a) të direktivës 2009/73/EC.

4. Niveli i primit minimal të detyrueshëm do të mundësojë një rezultat pozitiv të testit ekonomik me të ardhurat e krijuara nga kapaciteti i ofruar në ankandin e parë ose mekanizmin alternativ të alokimit në të cilin ofrohet kapaciteti i shtuar. Gama e nivelit të primit minimal të detyrueshëm, në varësi të kapacitetit të caktuar të alokuar, do të paraqitet tek autoritetet përkatëse rregullatore kombëtare për miratim në përputhje me nenin 25(1)(c) të rregullores (EU) 2017/459.

5. Një minimum primi i detyrueshëm i miratuar nga autoriteti rregullator kombëtar do të shtohet në çmimin e referencës për produktet e kapacitetit të lidhur në pikën përkatëse të interkonjeksionit dhe do t'u atribuohet ekskluzivisht operatorëve të sistemit të transmetimit për të cilat është aprovuar minimumi i detyrueshëm nga autoriteti rregullator kombëtar. Ky parim i paracaktuar për atribuimin e një primi minimal të detyrueshëm, nuk paragjykon ndarjen e një primi shtesë të ankandit sipas nenit 21(3) ose një marrëveshje alternative ndërmjet autoriteteve rregullatore kombëtare të përfshira.

KREU X

DISPOZITA FINALE DHE TRANZITORE

Neni 34

Metodologjitë dhe parametrat e përdorura për përcaktimin e të ardhurave të lejuara ose të synuara të operatorëve të sistemit të transmetimit

1. Përpara 1 tetorit 2021, Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë do të publikojë një raport mbi metodologjitë dhe parametrat e përdorura për të përcaktuar të ardhurat e lejuara ose të synuara të operatorëve të sistemit të transmetimit. Raporti do të bazohet të paktën në parametrat e përmendur në nenin 30(1)(b)(iii).

2. Autoritetet rregullatore kombëtare do t'i paraqesin Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë, në përputhje me procesin e përcaktuar nga Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë, të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me metodologjitë dhe parametrat e përdorura për të përcaktuar të ardhurat e lejuara ose të synuara të operatorëve të sistemit të transmetimit.

Neni 35

Kontratat ekzistuese

1. Ky kod nuk do të ndikojë në nivelet e tarifave të transmetimit që rezultojnë nga kontratat ose rezervimet e kapaciteteve të lidhura para datës 1 tetor 2019 ku këto kontrata ose rezervime të kapaciteteve nuk parashikojnë ndryshime në nivelet e tarifave të transmetimit të kapacitetit dhe / ose të produkteve, përveç indeksimit, nëse ka.

2. Dispozitat e kontratës në lidhje me tarifat e transmetimit dhe rezervimet e kapaciteteve të përmendura në paragrafin 1 nuk do të rinovohen, zgjaten ose të hidhen poshtë pas datës së skadimit të tyre.

3. Para 1 nëntorit 2019, një operator i sistemit të transmetimit do të dërgojë për informacion kontratat ose informacionin për rezervimet e kapaciteteve, nëse ka, të referuara në paragrafin 1 tek autoriteti rregullator kombëtar.



Neni 36

Monitorimi i implementimit

1. Në kuadër të zbatimit të përgjegjësisë të monitorimit, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë do të monitorojë dhe analizojë se si operatorët e sistemit të transmetimit kanë zbatuar këtë kod.

2. Operatorët e sistemit të transmetimit do t'i dorëzojnë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë të gjitha informacionet e kërkuara nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë për të përmbushur detyrimet e tij sipas paragrafit 1, në përputhje me afatet në vijim:

a) 1 korrik 2020 lidhur me kërkesat e kreut VIII; 31 dhjetor 2021 për të gjitha dispozitat e tjera të këtij kodi.

3.<.....>

4. Konfidencialiteti i informacionit komercialisht të ndjeshëm do të ruhet nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.

5. Brenda tri viteve nga afati përfundimtar për transpozimin e këtij kodi, Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë do të publikojë një raport mbi zbatimin e metodologjive të çmimit të referencës në Palët Kontraktore.

Neni 37

E drejta përjashtimore

1. Autoritetet rregullatore kombëtare mund, me kërkesë të një subjekti i cili vepron në një interkonjektor që ka përfituar nga një përjashtim nga neni 41(6), (8) dhe (10) i direktivës 2009/73/EC në përputhje me nenin 36 të asaj direktive ose një përjashtim të ngjashëm, bashkërisht t'i japin një subjekti të tillë një shmangie nga zbatimi i një ose më shumë neneve të këtij kodi në përputhje me paragrafët 2 deri 6 të këtij neni ku zbatimi i këtyre neneve për këtë subjekt do të kishte një ose disa nga pasojat negative si më poshtë:

a) nuk do të lehtësojë tregtinë efikase të gazit dhe konkurrencën;

b) nuk do të ofrojë stimuj për investime për kapacitete të reja ose për të ruajtur nivelet ekzistuese të kapaciteteve;

c) do të shtrembërojë në mënyrë të paarsyeshme tregtinë ndërkufitare;

d) do të shtrembërojë konkurrencën me operatorët e tjerë të infrastrukturës që ofrojnë

shërbime të një natyre të ngjashme me ato të interkonjektorit;

e) nuk mund të zbatohet kur merret parasysh natyra specifike e interkonjektorëve.

2. Subjekti që kërkon një përjashtim sipas paragrafit 1 duhet të përfshijë në kërkesën e tij një arsyetim të hollësishëm, me të gjitha dokumentet mbështetëse, duke përfshirë, kur është e përshtatshme, një analizë kosto-përfitim, duke treguar që një ose më shumë nga kushtet e paragrafit 1 (a) deri (e) janë përmbushur.

3. Autoritetet rregullatore kombëtare në fjalë do të vlerësojnë së bashku kërkesën për një përjashtim dhe do të merren me të në bashkëpunim të ngushtë. Kur autoritetet rregullatore kombëtare përkatëse japin një përjashtim, ata duhet të specifikojnë kohëzgjatjen në vendimet e tyre.

4. Autoritetet rregullatore kombëtare do të njoftojnë vendimet e tyre që u japin këto përjashtime Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

5. Autoritetet rregullatore kombëtare mund të revokojnë një përjashtim nëse rrethanat ose arsyet themelore, ose të dyja, nuk zbatohen më, ose mbi një rekomandim të arsyetuar të Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë ose të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për të revokuar një shmangie për shkak të mungesës së arsytimit.

VENDIM**Nr. 232, datë 20.12.2019****MBI MIRATIMIN E “RREGULLORES DHE TË METODOLOGJISË PËR LLOGARITJEN DHE VENDOSJEN E DËMIT EKONOMIK TË SHKAKTUAR NGA NDËRRHYRJET E PALIGJSHME NË SISTEMIN E MATJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 16, të nenit 20, të nenit 77, pika 9, nenit 110, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 15 dhe 26, të “Rregullores e organizimit funksionimit dhe procedurave të ERE”, të miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike me nr. 119/4 prot., datë, 19.12.2019, në lidhje me “Miratimin e metodologjisë së llogaritjes së dëmit



ekonomik nga operatori i sistemit, si pasojë e ndërhyrjeve të paligjshme në sistemin e shpërndarjes”,

konstatoi:

- Me vendimin nr. 94, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, ka vendosur, “Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e metodologjisë së llogaritjes së dëmit ekonomik nga operatori i sistemit, si pasojë e ndërhyrjeve të paligjshme në sistemin e shpërndarjes”.

- Me shkresën tonë nr. 481 pro., date 22.6.2016, iu dërgua palëve të interesit kjo rregullore, me qëllim mbledhjen e mendimeve e vërejtjeve të tyre në lidhje me draftin e hartuar.

- Në përfundim të afatit 15-ditor për marrjen e komenteve, kanë mbërritur në ERE komentet e Shoqatës së Konsumatorit Shqiptar, e cila në shkresën me nr. 481/1 prot. hyrës, datë 19.7.2016, shpreh një vlerësim të punës së kryer nga stafi i ERE-s, por për arsye objektive (mungesë stafi) nuk mund të shprehet specifikisht për draftmetodologjinë në fjalë.

- Gjatë shqyrtimit të këtij drafti është konstatuar se shumë prej pikave të draftit nuk kanë lidhje me objektin e metodologjisë, gjithashtu, dhe aneksi bashkëlidhur, i cili përcakton procedurat e brendshme që ndiqen gjatë konstatimit të ndërhyrjeve në sistemin e shpërndarjes, nuk është objekt i miratimit nga ERE.

- Me shkresën nr. 574 prot, datë 24.8.2017, me lëndë: “Kërkesë për informacion”, ERE i është drejtuar shoqërisë OSHEE sh.a., lidhur me metodologjinë e llogaritjes së rimbursimit të dëmit ekonomik nga operatori i sistemit.

- Në përgjigje të kësaj shkrese, shoqëria OSHEE sh.a., me shkresën 20062/1 prot., datë 29.9.2017, ka dhënë disa sqarime lidhur me informacionin e kërkuar.

- Gjatë shqyrtimit u konstatua nevoja e zhvillimit të një sërë seancash dëgjimore, të cilat kanë çuar në tejzgjatjen e këtij procesi, për shkak të nevojës për t’u sqaruar lidhur me përmbajtjen e draftit të propozuar.

- Konkretisht, janë zhvilluar seanca dëgjimore mes përfaqësuesve të shoqërisë OSHEE sh.a. dhe ERE, në datat 7.11.2017, 12.1.2018 dhe 18.1.2018 dhe në përfundim të këtyre seancave, me shkresën nr. 26/2 prot. hyrës, datë 8.2.2018, shoqëria OSHEE sh.a. ka paraqitur në ERE një draft të

përmirësuar, i cili përsëri nuk ka adresuar të gjitha paqartësitë e krijuara.

- Në vijim janë zhvilluar disa seanca dëgjimore në datat 10.10.2018, 22.5.2019, 10.7.2019 dhe 1.11.2019, si dhe me shkresën nr. 412/1, datë 3.7.2019, i është kërkuar depozitimi i draftrregullores dhe të metodologjisë së llogaritjes së dëmit ekonomik nga operatori i sistemit, si pasojë e ndërhyrjeve të paligjshme në sistemin e shpërndarjes.

- Në konkluzion, të gjithë sa më sipër shpjeguar, ERE vendosi të konkludojë në një draft përfundimtar të kësaj rregulloreje dhe metodologjie për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik, i cili në përmbajtje të tij ka 4 pjesë, të përbëra nga 14 nene dhe 1 aneks bashkëlidhur.

- Në aneksin 1 bashkëlidhur rregullores është përcaktuar struktura e përdoruesve të rrjetit, sipas kategorive të caktuara, duke u bazuar në llojin e klientit (familjar ose jofamiljar) dhe fuqinë e instaluar. Mbi këto 2 lloj parametrash është përcaktuar sasia e energjisë elektrike që do të faturohet si dëm ekonomik në rastin e konstatimit të ndërhyrjeve të paligjshme.

- Kjo sasi është shumëzuar me numrin e muajve për të cilin do të përlllogaritet dëmi i shkaktuar, për të përfutur sasinë totale të energjisë të llogaritur si “dëm ekonomik”. Sasia totale do të shumëzohet me çmimin e përcaktuar në pikën 3, të nenit 9, të draftrregullores, për të përcaktuar kundërvleftën në lekë të dëmit ekonomik të shkaktuar ndaj OSSH sh.a.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë “Rregulloren dhe metodologjinë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike”(bashkëlidhur).

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë të interesuarit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn nga data 1.1.2020.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti
Faqe | 17571



**RREGULLORJA DHE METODOLOGJIA
PËR LLOGARITJEN DHE VENDOSJEN E
DËMIT EKONOMIK TË SHKAKTUAR NGA
NDËRHYRJET E PALIGJSHME NË
SISTEMIN E MATJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

**PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Qëllimi i Rregullores

Qëllimi i kësaj rregullore është të përcaktojë metodologjinë për llogaritjen e dëmit ekonomik që i shkaktohet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes dhe në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike nga përdoruesit e rrjetit të lidhur në sistemin e shpërndarjes, si dhe procedurave që ndiqen nga OSSH-ja për konstatimin dhe vendosjen e dëmit ekonomik, e cila do të mundësojë minimizimin e humbjeve joteknike në rrjetin shpërndarës së energjisë elektrike.

Neni 2

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje, është përlllogaritja e dëmit ekonomik të shkaktuar Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, nga:

1. Ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes në boks individual, të cilat shmangin evidentimin e sasisë reale të energjisë elektrike të konsumuar prej tyre, nga përdoruesit e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

2. Lidhja me një linjë të dytë furnizimi nga rrjeti, të paautorizuar nga OSSH-ja të bërë nga një përdorues që ka një kontratë lidhjeje me OSSH-në.

3. Rilidhja e paautorizuar e çdo përdoruesi të rrjetit, furnizimi i të cilit është ndërprerë nga OSSH-ja me kërkesë të përdoruesit/furnizuesit apo me iniciativë të OSSH-ja.

Neni 3

Baza ligjore

Kjo rregullore dhe metodologji është hartuar dhe miratohet në përputhje me:

- nenin 77, pika 9, e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar;
- pikën II.8 dhe II.9 të Kodit të Matjes.

Neni 4

Përkufizime

Të gjithë termat e tjerë të përdorur në këtë rregullore do të kenë kuptimet e mëposhtme:

“Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” ose **“OSSH”** është një person juridik, përgjegjës për operimin e sigurt, të besueshëm dhe të efektshëm të rrjetit të shpërndarjes, duke siguruar mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes, të shtrirë në një zonë të caktuar dhe, kur është e aplikueshme, lidhjet e tij me sisteme të tjera për të siguruar aftësi afatgjatë të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë, në harmoni me mjedisin dhe eficiencën e energjisë.

“Përdoruesit e rrjetit” janë personat fizikë ose juridikë, të cilët i furnizon ose furnizohen me energji elektrike nëpërmjet rrjetit të shpërndarjes.

“Rrjeti i shpërndarjes së energjisë elektrike” përfshin zbarat, pajisjet kyçëse/shkyçëse dhe transformatorët në nënstacionet 110/35/20/10 kV, si dhe të gjitha elementet në nivel tensioni më të ulët se 110 kV në pronësi të OSSH-së.

“Sistemi i matjes” kupton tërësinë e pajisjeve të matjes: matësin, automatin, transformatorët e matjes, mbrojtjen e matësit dhe izolatorët, qarqet dhe pajisjet e ruajtjes së të dhënave, pajisjet e transmetimit dhe të komunikimit të të dhënave dhe lidhjet e nevojshme kabllorë të cilat janë pjesë e pajisjeve të matjeve të Energjisë Elektrike aktive dhe Energjisë Elektrike reaktive në objekt.

“Boks individual” kupton kutinë që mbron matësin nga lagështira, papastërtia, fushat elektromagnetike, goditjet fizike, i siguruar me dry dhe/ose i vulosur, me qëllim që të mos lejojë ndërhyrjet e paautorizuara.

“Kufijtë e pronësisë” do të thotë pika ose pikat në të cilat energjia elektrike tërhiqet ose injektohet ndërmjet sistemi të shpërndarjes dhe të instalimit të përdoruesit, të cilat përcaktohen nga OSSH-ja dhe përdoruesi në marrëveshjen e lidhjes.

“Klient fundor” është një klient që blen energji elektrike vetëm për përdorim vetjak.

Të gjithë termat dhe përkufizimet e përdorura në këtë rregullore, të cilat janë të përcaktuara në



ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, do të kenë të njëjtin kuptim edhe në këtë rregullore.

PJESA E DYTË
PROCEDURA E KONSTATIMIT TË
NDËRHYRJEVE NË SISTEMIN E MATJES
SË ENERGJISË ELEKTRIKE

Neni 5

Të drejtat dhe përgjegjësitë e OSSH-së

Në përputhje me të drejtat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe në kushtet dhe termat e licencës për veprimtarinë e shpërndarjes të lëshuar nga ERE, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka të drejtën dhe përgjegjësinë të ushtrojë kontroll për zbatimin e legjislacionit përkatës, lidhur me administrimin dhe përdorimin e rrjetit të energjisë elektrike;

1. Përfaqësuesit e OSSH-së kanë të drejtën e aksesit në pronat dhe/ose banesat e shtetasve për të kontrolluar mirëfunksionimin e rrjetit të shpërndarjes dhe sistemin e matjes, në prani të përdoruesit të rrjetit.

2. OSSH-ja është përgjegjëse për sigurimin, instalimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të matjes dhe matjen në kufijtë ku përdoruesit e rrjetit janë të lidhur me sistemin e shpërndarjes.

Neni 6

Autorizimi i grupeve të kontrollit

Kontrolli i sistemit të matjes dhe i rrjetit të shpërndarjes, me qëllim evidentimin e rasteve të ndërhyrjeve të paligjshme në rrjetin e shpërndarjes, sipas përcaktimeve të nenit 2, kryhet nga grupe kontrolli të pajisur me një autorizim të posaçëm dhe nën logon e OSSH-së.

Neni 7

Ushtrimi i kontrolleve

1. OSSH-ja ushtron kontrolle për verifikimin e sistemit të matjes dhe të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, në çdo rast që ka të dhëna ose dyshime të arsyeshme për ndërhyrje të paligjshme, të tilla që mund të kenë shkaktuar apo shkaktojnë dëm ekonomik.

2. Ushtrimi i veprimtarisë së OSSH-së për kontrollin dhe verifikimin e sistemit të matjes dhe rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të nenit 2 të kësaj rregulloreje, bëhet në përputhje të plotë me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë marrëdhënien e përdoruesve të rrjetit të shpërndarjes me OSSH-në.

Neni 8

Dokumentimi i kontrollit

1. Në rastet e ushtrimit të kontrollit në zbatim të parashikimeve të nenit 7.1 të kësaj rregulloreje, OSSH-ja, jo më pak se 48 orë përpara, njofton paraprakisht furnizuesin për kontrollin që do të ushtrohet në sistemin e matjes së energjisë elektrike të përdoruesit të rrjetit me të cilin ka një kontratë furnizuese dhe kohën kur do të kryhet.

2. Njoftimi paraprak është i paaplikueshëm në rastet e parashikuara në pikën 2, të nenit 2, të kësaj rregulloreje.

3. Në çdo rast, OSSH-ja dokumenton nëpërmjet procesverbalit të konstatimit tip të miratuar nga OSSH-ja, dëmin e konstatuar, shoqëruar me provat e shkeljes së evidentuar.

4. Në çdo rast, OSSH-ja do të realizojë marrjen e pamjeve vizive nëpërmjet kamerave/aparateve fotografike, në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

5. Në rast se është e nevojshme, gjatë procesit të kontrollit, OSSH-ja do të sigurojë provat laboratorike të cilat shprehen me rezultatet e verifikimit të matësit të energjisë elektrike.

6. Gjatë ushtrimit të kontrollit është e domosdoshme prezenca e përdoruesit të rrjetit apo të organeve ligjzbatuese.

PJESA E TRETË
METODOLOGJIA PËR PËRLLLOGARITJEN
E DËMIT EKONOMIK

Neni 9

Përlllogaritja e dëmit ekonomik

1. Dëmi ekonomik do të jetë kundërvlefë në lekë e sasisë së energjisë elektrike e shprehur në kwh energji aktive, e kërkuar prej OSSH-së ndaj përdoruesit të rrjetit, e cila përfaqëson



energjinë elektrike të konsumuar pa autorizim nga ky i fundit.

2. Llogaritja e sasisë së energjisë elektrike, e kërkueshme prej OSSH-së ndaj përdoruesit të rrjetit, do të bëhet bazuar në tabelën e aneksit 1 të kësaj rregulloreje.

3. Çmimi i energjisë elektrike, i cili do të shërbejë për përlogaritjen e kundërvleftës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, do të përcaktohet si shuma e: I. çmimit mesatar të ponderuar të energjisë elektrike për njësi kwh, të blerë për mbulimin e humbjeve në periudhën që do të faturohet dëmi ekonomik, me II. kostot e transmetimit; dhe II. kostot e rrjetit në të cilin është kyçur përdoruesi për secilën kategori të tij.

4. Në faturën e lëshuar nga OSSH-ja për përdoruesin e rrjetit lidhur me dëmin ekonomik të shkaktuar, duhet të evidentohet çdo komponent që përben kundërvleftën e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Neni 10

Faturimi dhe pagesa e dëmit ekonomik të përlogaritur

1. OSSH-ja sigurohet që të informojë furnizuesin dhe përdoruesin e rrjetit në çdo rast që konstaton dëm ekonomik të shkaktuar nga një përdorues i rrjetit me të cilin furnizuesi ka një kontratë furnizimi, jo më vonë se 48 orë nga konstatimi, përpara ndërmarrjes së ndonjë veprimi kundërshtues të rrjetit.

2. OSSH-ja lëshon faturë të posaçme të dëmit ekonomik të përlogaritur për përdoruesin të rrjetit, jo më vonë se 7 ditë nga konstatimi, e dërgon atë në adresën e përcaktuar në marrëveshjen e lidhjes me përdoruesin e rrjetit dhe sigurohet që ta arkëtojë atë brenda 30 ditëve nga lëshimi i saj.

3. Përdoruesi i rrjetit do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën e dëmit ekonomik, jo më vonë se 30 ditë, nga data e lëshimit të faturës.

4. Në mungesë të pagesës së faturës nga përdoruesi i rrjetit, brenda afatit të caktuar për pagesë, sipas pikës 3 të këtij neni, OSSH-së i lind e drejta që të bëjë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të përdoruesit, pasi e ka lajmëruar me shkrim këtë të fundit dhe furnizuesin, 48 orë përpara.

PJESA E KATËRT DISPOZITA TË TJERA

Neni 11

Ankimi

1. Çdo përdorues i rrjetit, në përputhje me parashikimet e kësaj rregulloreje, si dhe legjislacionit në fuqi, ka të drejtën e ankimit në OSSH dhe/ose në ERE, në rast se kundërshton faturën e dëmit ekonomik të vendosur nga OSSH-ja ose pretendon se OSSH-ja nuk ka ndjekur dhe zbatuar dispozitat e kësaj Rregulloreje.

2. OSSH-ja ose ERE do të trajtojnë çdo ankesë të përdoruesit, brenda 7 ditësh nga paraqitja e saj, në përputhje me dispozitat dhe procedurat e “Rregullores për trajtimin e ankesave” të miratuar nga OSSH-ja.

3. Në rastet kur OSSH-ja nuk i kthen përgjigje për ankesën e përdoruesit të rrjetit, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni apo nëse përdoruesi nuk është dakord me përgjigjen e dhënë prej OSSH-së, atij i lind e drejta të paraqesë, gjithashtu, një ankesë pranë ERE-s, sipas procedurave të përcaktuara në rregulloret përkatëse të ERE-s.

4. Ankesa në ERE mund të paraqitet jo më vonë se 1 muaj pas marrjes dijeni nga përdoruesi i rrjetit të përgjigjes së trajtimit të ankesës nga OSSH-ja në adresën e përcaktuar në marrëveshjen e lidhjes me rrjetin e shpërndarjes.

5. Në rast se pas verifikimeve të OSSH-së, rezulton se “dëmi ekonomik” i cili i është faturuar përdoruesit të rrjetit është në kundërshtim me përcaktimet e kësaj rregulloreje ose është përlogaritur në mënyrë të pasaktë, atëherë OSSH-ja, brenda 7 ditësh nga konstatimi anulon faturën përkatëse dhe lëshon faturën e korrigjuar kur është rasti.

6. Për faturat e ankimuar nga përdoruesi i rrjetit nuk do të ndërpritet furnizimi me energji elektrike deri në përfundimin e shqyrtimit të ankesës për këtë faturë nga OSSH-ja.

7. Pavarësisht dispozitave të pikës 1 të mësipërme, çdo përdorues i rrjetit mund të paraqesë një ankimim pranë gjykatës kompetente.



Neni 13

Ndryshimi i Rregullores

Kjo Rregullore është objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit të ERE-s.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

ANEKS 1

**LLOGARITJA E SASISË SË ENERGJISË ELEKTRIKE, E KËRKUESHME PREJ OSSH-së
NDAJ PËRDORUESIT TË RRJETIT**

Nr.	Lloji i matësit	Kategoria	Pinst (kw)	In e automatit	Sasia e energjisë elektrike e llogaritur si “dëm ekonomik”	Nr. i muajve	Sasia totale e energjisë e llogaritur si “dëm ekonomik”	Çmimi i energjisë elektrike	Kundërvlehtësi në lekë e “dëmit ekonomik” të shkaktuar
1	Matës 1-fazor	familjar	1 deri 5	deri 25 A	320	6	1920		
2	Matës 3-fazor	familjar	6 deri 40	deri 80 A	640	6	3840		
3	Matës 1-fazor	jofamiljar	1 deri 5	deri 25 A	1200	6	7200		
4	Matës 3-fazor	jofamiljar	6 deri 10	deri 16 A	2500	6	15000		
5	Matës 3-fazor	jofamiljar	10 deri 20	deri 32 A	5000	6	30000		
6	Matës 3-fazor	jofamiljar	20 deri 50	deri 80 A	12000	6	72000		
7	Matës 3-fazor në panel matjeje me TRI 100/5A	jofamiljar	51–74	deri 100A	17750	6	106500		
8	Matës 3-fazor në panel matjeje me TRI 150/5A	jofamiljar	75–99	deri 150A	23760	6	142560		
9	Matës 3-fazor në panel matjeje me TRI 200/5A	jofamiljar	100–124	deri 200 A	29760	6	178560		
10	Matës 3-fazor në panel matjeje me TRI 250/5A	jofamiljar	125–150	deri 250 A	36000	6	216000		
11	Matës 3-fazor në panel matjeje me TRI 300/5A	jofamiljar	151–174	deri 300 A	41760	6	250560		
12	Matës 3-fazor në panel matjeje me TRI 400/5A	jofamiljar	175–200	deri 400 A	48000	6	288000		



13	Matës 3-fazor në panel matjeje me TRI 500/5A	jofamiljar	201–225	deri 500 A	54000	6	324000		
14	Matës 3-fazor në panel matjeje me TRI 600/5A	jofamiljar	226–300	deri 600 A	72000	6	432000		
15	Matës 3-fazor në panel matjeje në TM	jofamiljar			420000	6	2520000		

VENDIM**Nr. 233, datë 20.12.2019**

**MBI MIRATIMIN E DISA
NDRYSHIMEVE NË
“METODOLOGJINË E PËRCAKTIMIT
TË ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I
MUNDËSISË SË FUNDIT”, MIRATUAR
ME VENDIMIN NR. 201, DATË 4.12.2017,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16, të nenit 1, germa “b”, të nenit 20, germa “a” dhe të nenit 87, të ligjit 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 14, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, e ndryshuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 144, datë 25.6.2018; të nenit 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 119/8 prot., datë 18.12.2019, dhe propozimin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, për fillimin e procedurës për rishikimin e “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 201, datë 4.12.2017, ka miratuar “Metodologjinë e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë

elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” dhe me vendimin nr. 144, datë 25.6.2018, miratoi rishikimin e saj.

- Me vendimin nr. 155, datë 29.10.2019, bordi i ERE-s është shprehur për fillimin e procedurës për disa ndryshime në “Metodologjinë e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar më parë vendimin nr. 201, datë 4.12.2017, të Bordit të ERE-s, të ndryshuar.

- Në vijim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 155, datë 29.10.2019, “Mbi fillimin e procedurës për rishikimin e Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar”, u bënë publikimet, në faqen e *web-it* të ERE-s, në Fletoren Zyrtare me nr. 152, datë 13.11.2019, si dhe u bë njoftimi në medien e shkruar me nr. 32/46 prot., datë 6.11.2019.

- Për të marrë opinionet e palëve të interesuara, bazuar në urdhrin nr. 148, datë 5.12.2019, të kryetarit të ERE-s, ERE, me anë të njoftimit nr. 792 prot., datë 4.12.2019, thirri palët e interesit dhe organizoi një seancë dëgjimore në datën 13.12.2019, midis drejtorive teknike dhe përfaqësuesve të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Autoritetit të Konkurrencës (AK), Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a.) dhe subjekteve të cilat kanë marrë apo janë duke marrë shërbimin e furnizimit në kushtet e Furnizimit të Mundësisë së Fundit.

- Gjatë kësaj seancë në të cilën morën pjesë përfaqësues të OSHEE sh.a., MIE-s dhe subjekteve të cilat kanë marrë apo janë duke marrë



shërbimin e furnizimit në kushtet e Furnizimit të Mundësisë së Fundit, palët e interesit nuk shprehën kundërshti mbi propozimin e ERE-s, në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 155, datë 29.10.2019 dhe nuk patën asnjë koment apo sugjerim për ndryshime mbi draftin për të cilin ka filluar procedura e ndryshimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI

1. Miratimin e disa ndryshimeve në “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin nr. 201, datë 4.12.2017, të Bordit të ERE-s, të ndryshuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 144, datë 25.6.2018, “Mbi rishikimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, si më poshtë:

i. neni 6 pika 3 ndryshon:

“Tarifa që FMF-ja do të aplikojë/ do të ngarkojë te klientët, do të përfshijë kostot për blerjen e energjisë elektrike për këta klientë për periudhën e livrimit, mbi të cilën do të aplikohet dhe një marzh i furnizimit i cili vendoset nga Rregullatori.”;

ii. neni 6 pika 9 ndryshon:

“Kostot, të cilat varen nga vëllimi i energjisë elektrike të furnizuar për këtë kategori klientësh, do të pasqyrohen në mënyrë transparente, jodiskriminuese dhe do të reflektojnë koston reale të furnizimit, e cila do të monitorohet nga Rregullatori në mënyrë periodike. Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të japë çdo muaj evidencë të qartë në formën e një bilanci energjetik i cili të mund të argumentojë burimin e mbulimit të kërkesës mujore për klientët e FMF-së.”;

iii. neni 7 pika 2, ndryshon:

“Deri në përcaktimin e çmimit nga ERE, Furnizuesi do të faturojë klientin e furnizuar në kushtet e furnizimit të mundësisë së fundit, me çmimin mesatar të ponderuar të profileve të blerjes së energjisë elektrike të siguruar për periudhën në të cilën furnizohet, publikuar nga FMF-ja, duke pasqyruar kostot administrative, e transmetimit/të shpërndarjes, sipas nivelit të tensionit ku është i lidhur konsumatori, si dhe kostot e përcaktuara në piken 6, të nenit 6.”;

iv. neni 8, pika 1, ndryshon:

“CBEt është çmimi mesatar i ponderuar i profileve të blerjes për sasinë e energjisë së siguruar për mbulimin e kërkesës së klientëve FMF për periudhën e furnizimit nga tregu i parregulluar dhe nga prodhuesit me përparësi (BRE).”;

v. shtohet pika 3 në nenin 8, ndryshon:

“Çmimi i energjisë në pik duhet të llogaritet dhe të evidentohet nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, bazuar në kostot reale të energjisë së furnizuar në periudhën e pikut. Faturimi në pik do të jetë në fashën orare, si vijojnë:

Për periudhën 1 nëntor–31 mars nga ora 18:00 deri në 22:00;

Për periudhën 1 prill–31 tetor nga ora 19:00 deri në 23:00,

në të gjitha rastet fjala “konsumator” do të zëvendësohet me fjalën “klient”.”.

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi nga data 1.1.2020.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 234, datë 20.12.2019**

**MBI MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË
“RREGULLOREN PËR LIDHJET E REJA
NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES”,
MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 166,
DATË 10.10.2016, I NDRYSHUAR ME
VENDIMIN NR. 177, DATË 8.11.2016, TË
BORDIT TË ERE-S, SI ANEKS 3,
“TARIFAT PËR LIDHJET E REJA ME
SISTEMIN E SHPËRNDARJES E
VETËPRODHUESVE TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA DIELLI, ME
KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR
DERI NË 500 kwp”, PËR PËRCAKTIMIN
DHE MIRATIMIN E TARIFAVE PËR
LIDHJEN E IMPIANTEVE
VETËPRODHUESE TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA DIELLI ME
KAPACITET TOTAL DERI NË 500 kw**

Në mbështetje të nenit 10, pika 2, të nenit 16 dhe të nenit 27, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 15, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” dhe të neni 21, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.12.2019, pasi shqyrtoi relacionin nr. 119/15 prot., 19.12.2019, të përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s, “Mbi miratimin e disa shtesave në “Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, të ndryshuar me vendimin nr. 177, datë 8.11.2016, të Bordit të ERE-s, “Për përcaktimin dhe miratimin e tarifave për lidhjen e impianteve vetëprodhuese të energjisë elektrike nga dielli”,

konstatoi se:

- Me vendimin e bordit të ERE-s nr. 152, datë 14.10.2019, është vendosur për fillimin e procedurës për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në “Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, i ndryshuar me vendimin nr. 177, datë 8.11.2016, të Bordit të ERE-s, për përcaktimin dhe miratimin e tarifave për lidhjen e

impianteve vetëprodhuese të energjisë elektrike nga dielli me kapacitet total deri në 500 kw (bashkëlidhur studimi).

- Me shkresën nr. 32/43 prot., datë 30.10.2019, njoftimi për këtë vendim është botuar në gazetë, me qëllim marrjen e opinioneve apo të komenteve të palëve të interesit, në lidhje me këtë vendimmarrje.

- Me shkresën e ERE-s nr. 680 prot., datë 30.10.2019, ky vendim u është dërguar palëve të interesit.

- Në përfundim të afateve për pritjen e komenteve të palëve të interesit nuk rezultoi të ketë vërejtje apo sugjerime në lidhje me sa propozohet nga OSHEE sh.a., për përcaktimin dhe miratimin e tarifave për lidhjen e impianteve vetëprodhuese të energjisë elektrike nga dielli me kapacitet total deri në 500 kw.

- ERE, me qëllim shterimin e të gjitha pyetjeve dhe marrjen e informacionit të nevojshëm nga ana e OSHEE sh.a., në lidhje me tarifat e propozuara, njoftoi me shkresën nr. 759 prot., datë 20.11.2019, OSHEE sh.a. për organizimin e një seance dëgjimore në datën 20.11.2019.

- Gjatë diskutimeve në këtë seancë dëgjimore, përfaqësuesit e OSHEE sh.a. dhanë shpjegime në lidhje me çështjet e ngritura për diskutim nga ERE e që lidhen me analizën e kryer për përcaktimin e tarifave të propozuara. Në kushtet kur nga ana e shoqërisë OSHEE sh.a. mungon një analizë e detajuar e kostove, mbi bazën e të cilave janë përllogaritur tarifat e propozuara, vlerësojmë se:

- tarifa T1 (Tarifa e studimit dhe e vlerësimit të miratimit të projektit) duhet të jetë e njëjtë në vlerë me atë të përcaktuar në “Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, i ndryshuar me vendimin nr. 177, datë 8.11.2016, të Bordit të ERE-s, sipas niveleve përkatëse të tensionit, ku realizohet lidhja me sistemin e shpërndarjes e vetëprodhuesve të energjisë elektrike nga dielli me kapacitet total të instaluar deri në 500 kwp;

- tarifa T2 (Tarifa e distancës) e lidhjes me sistemin e shpërndarjes e vetëprodhuesve të energjisë elektrike nga dielli me kapacitet total të instaluar deri në 500 kwp duhet të jetë 0 lek, siç edhe propozuar nga shoqëria OSHEE sh.a.;

- tarifa T3 (Tarifa e fuqisë) e lidhjes me sistemin e shpërndarjes e vetëprodhuesve të energjisë elektrike nga dielli me kapacitet total të instaluar



deri në 500 kwp duhet të jetë 0 lek, siç edhe propozuar nga shoqëria OSHEE sh.a.;

- T4 (Tarifa e shërbimeve për realizimin e lidhjeve të reja dhe matjes), duhet të jetë e njëjtë në vlerë me atë të përcaktuar në “Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, i ndryshuar me vendimin nr. 177, datë 8.11.2016, të Bordit të ERE-s.

Kjo tarifë përbëhet nga këta komponentë:

1. Tarifë për azhurnimin e rrjetit: 1500 lekë;
2. Shpenzime administrative: 1000 lekë;
3. Tarifa për verifikimin/kolaudimin fillestar të matësve:

- monofazë;

- trefazor,

ku tarifa për verifikimin/kolaudimin fillestar të matësit, duhet të përcaktohet në zbatim të parashikimeve të nenit 77, pika 8, e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.

- Në kushtet kur mungon propozimi i shoqërisë OSHEE sh.a. për tarifën T1, T2, T3, T4, në rastin e shtesës së fuqisë, modifikimit të lidhjes ose transferimit, vlera respektive e tyre duhet të jetë 0 lekë.

- Në kushtet kur do të aplikohet njëkohësisht për lidhje të re me rrjetin e shpërndarjes dhe lidhje për impiantet vetëprodhuese fotovoltaike me kapacitet total të instaluar deri në 500 kwp (p.sh., banesë e re e sapondërtuar dhe e pajisur me impiant vetëprodhues të energjisë elektrike nga dielli apo biznes i porsangritur që ka montuar/planifikon montimin e impiantit fotovoltaiq që në momentin e projektimit/hartimit të plan biznesit), tarifa T4 do të paguhet vetëm një herë.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në “Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, i ndryshuar me vendimin nr. 177, datë 8.11.2016, të Bordit të ERE-s, si aneks 3, “Tarifat për lidhjet e reja me sistemin e shpërndarjes së vetëprodhuesve të energjisë elektrike nga dielli me kapacitet total të instaluar deri në 500 kwp”, për përcaktimin dhe miratimin e tarifave për lidhjen e

impianteve vetëprodhuese të energjisë elektrike nga dielli me kapacitet total deri në 500 kw (bashkëlidhur aneksi 3).

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi nga data 1 janar 2020.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETAR
Petrit Ahmeti

ANEKS 3

TARIFAT PËR LIDHJET E REJA ME SISTEMIN E SHPËRNDARJES E VETËPRODHOUESVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA DIELLI ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR DERI NË 500 kwp

T1 – TARIFA E STUDIMIT DHE E VLERËSIMIT E MIRATIMIT TË PROJEK- TIMIT

T1 është tarifë fikse, lidhur me kostot për studimin e projektit të lidhjes së re dhe studimit dhe azhurnimit të pikës së lidhjes me metodologjinë GIS. Sipas kategorizimit të klientëve dhe nivelit të tensionit, ku kërkohet lidhja e re, është përcaktuar:

Për klientët familjarë – T1= 1000 lekë

Për klientët jofamiljarë në tension të ulët – T1= 5000 lekë

Për klientët e lidhur në tension të mesëm 6/10/20/35 kV – T1= 23000 lekë

Për shtesë fuqie, modifikim lidhje, transferim lidhje – T1= 0 lek

T2 – TARIFA E DISTANCËS = 0 lek

T3 – TARIFA E FUQISË = 0 lek

T4 – TARIFA E SHËRBIMEVE PËR
REALIZIMIN E LIDHJES SË RE DHE
KOLAUDIMIT FILLESTAR TË MATËSIT

Tarifa T4 është tarifë fikse e shërbimeve për realizimin e lidhjes së re dhe verifikimit/kolaudimit



filleshtar të matësit. Kjo tarifë përbëhet nga këta komponentë:

1. Tarifë për azhurnimin e rrjetit: 1500 lekë;
2. Shpenzime administrative: 1000 lekë;
3. Tarifa për verifikimin/kolaudimin filleshtar të matësve:

- monofazë;
- trefazor.

Tarifa për verifikimin/kolaudimin filleshtar të matësit u referohet parashikimeve të nenit 77, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

VENDIM

Nr. 235, datë 20.12.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “STRATEGJISË PËR INFRASTRUKTURAT KRITIKE NË SEKTORIN E ENERGIJËS ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 18, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; ligjit nr. 2/2017 “Për sigurinë kibernetike” dhe VKM-së nr. 222, datë 26.4.2018 “Për miratimin e listës së infrastrukturës kritike dhe informacionit dhe të listës së infrastrukturës të rëndësishme të informacionit”, neneve 15 dhe 26 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 119/3 prot., datë 18.12.2019 “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e ‘Strategjisë për infrastrukturat kritike në sektorin e energjisë elektrike’”,

konstatoi se:

- Në Korrik të vitit 2016, Bashkimi Evropian ka miratuar direktivën nr. 2016/1148 “Mbi sigurinë e sistemit dhe sistemeve informatike” (NIS), e njohur ndryshe dhe si direktiva mbi “Cybersecurity”.

- Pas miratimit të rezolutës nga Kuvendi i Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2018”, ndër të tjera, në këtë rezolutë, ERE-s i është kërkuar të punojë për hartimin e një strategjie për infrastrukturat kritike në sektorin e energjisë në përputhje me direktivën e BE-së “Mbi sigurinë e sistemit dhe sistemeve informatike”.

- Në përmbushje të detyrave të lëna në rezolutën e Kuvendit, sipas nenit 18, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; ligjit nr. 2/2017 “Për sigurinë kibernetike” dhe VKM-së nr. 222, datë 26.4.2018, “Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe të listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit”, ERE ka vijuar punën për hartimin e “Strategjisë për infrastrukturat kritike në sektorin e energjisë elektrike”.

- Zbatimi i direktivës së BE-së është i një rëndësie të veçantë për Komunitetin e Traktatit të Energjisë së Vendeve të Evropës Juglindore, pjesë e së cilës është dhe Shqipëria, prandaj nga ana e Sekretariatit të Energjisë janë duke u zhvilluar me rregullatorët dhe operatorët rajonalë, grupe pune për mbledhjen e informacioneve lidhur me masat e marra për zbatimin e kësaj direktive.

- Duke kuptuar rëndësinë e strategjisë së sigurisë së kibernetike, në kuadër të nismës së USAID-it me ndihmën e NARUC-ut së bashku me Komunitetin e Energjisë, është duke u punuar për përpilimin e “Strategjisë për infrastrukturat kritike në sektorin e energjisë elektrike”.

- Për përgatitjen e kësaj strategjie, OEIK (Operatorëve Ekonomikë të Infrastrukturave Kritike), u është kërkuar informacion lidhur me masat e marra në zbatim të direktivës 2016/1148, të Bashkimit Evropian “Mbi sigurinë e sistemit dhe sistemeve informatike”, për ruajtjen e të dhënave konfidenciale të klientëve, lidhur me implementimin e masave në këtë drejtim, si dhe çdo masë tjetër të marrë në lidhje me sigurinë e sistemeve informatike.

- Ligji nr. 2/2017 “Për sigurinë kibernetike”, neni 6, pika 2, Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës, miraton listën e infrastrukturave kritike të informacionit dhe të infrastrukturave të rëndësishme të informacionit, e cila përditësohet të paktën një herë në dy vjet.

- “Infrastrukturat kritike të informacionit”, përbëjnë shtyllat kryesore për funksionimin e ekonomisë dhe shoqërisë dhe një sulm ose ndërprerje ndaj këtyre aseteve dhe shërbimeve do ndikojë në një pjesë të madhe të popullsisë.

- ERE i ka propozuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, duke bërë me dije Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, si dhe KESH sh.a.,



përditësimin e Listës së Infrastrukturave Kritike të Informacionit, duke përfshirë në listën e këtyre infrastrukturave dhe infrastrukturave të kompanisë publike të gjenerimit.

- Shoqëria KESH sh.a., menaxhon kaskadën e lumit Drin që është burimi kryesor i furnizimit me energji elektrike të vendit, mosfunksionimi i së cilës do të shkaktoje efekte financiare, dhe sigurie për vendin, ERE ka propozuar përditësimin e Listës së Infrastrukturave Kritike të Informacionit për sektorin e energjisë elektrike me shoqërinë KESH sh.a. (Korporata Elektroenergjetike Shqiptare) si një infrastrukturë e rëndësishme dhe tejet kritike, e cila zotëron, gjithashtu, sistemin SCADA.

- ERE ushtron funksionet rregullatore me qëllim promovimin e një tregu të brendshëm konkurrues të sigurt dhe miqësor ndaj mjedisit për të gjithë klientët dhe furnizuesit, duke siguruar kushtet e duhura për funksionimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të rrjeteve të energjisë elektrike, në bashkëpunim të ngushtë me Komunitetin e Energjisë dhe autoritetet rregullatore të vendeve të tjera.

- Aktualisht Sekretariati i Komunitetit të Energjisë ka zhvilluar me rregullatorët dhe operatorët rajonalë grupe pune për mbledhjen e informacioneve lidhur me masat e marra për zbatimin e direktivës së sipërcituar.

- Qëllimi i këtij dokumenti është të përcaktojë rregullat dhe masat që duhet të ndërmerren nga operatorët e infrastrukturave kritike në sektorin e energjisë elektrike për rreziqet e shkeljes apo dëmtimit të këtyre infrastrukturave në kuadër të operimit përmes platformave të ndryshme digjitale.

- “Strategjia për infrastrukturën kritike në sektorin e energjisë elektrike”, përcakton detyrimin e operatorëve që operojnë infrastrukturën kritike në sektorin e energjisë elektrike që të marrin masat e duhura gjatë projektimit, instalimit dhe funksionimit të rrjetit ose pajisjeve të përdorura prej tyre, në mënyrë që të garantojnë sigurinë, integritetin dhe funksionimin e qëndrueshëm të sistemit elektroenergjetik.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e “Strategjisë për infrastrukturën kritike në sektorin e energjisë elektrike”.

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM Nr. 236, datë 20.12.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “KODIT TË RRJETIT TË TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR” NË SHQIPËRI

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe neneve 16 dhe 44, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, si dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 119/5 prot., datë 18.12.2019, e përgatitur nga Drejtoria e Monitorimit mbi fillimin e procedurës për miratimin e Kodit të Rrjetit të Transmetimit të Gazit Natyror,

konstatoi se:

- Në mbështetje të nenit 44, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, ERE miraton Kodin e Rrjetit të Transmetimit të Gazit Natyror.

- Kodi i Rrjetit të Transmetimit të Gazit Natyror është hartuar duke u bazuar në ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, rregulloren e Komisionit (BE) 2017/459, të datës 16 mars 2017, për krijimin e një kodi të rrjetit mbi kapacitetin shpërndarës të sistemeve të transmetimit të gazit, rregulloren e Komisionit (BE) nr. 312/2014, të datës 26 mars 2014, për krijimin e një kodi të rrjetit për balancimin e gazit në rrjetet e transmetimit /ENTSO-G CAM NC Modeli i Termave dhe Kushteve kryesore /Rregulloren (BE) nr. 703/2015, të datës 30 prill



2015. Krijimi i një kodi të rrjetit mbi rregullat e ndërveprimit dhe shkëmbimit të të dhënave/Kodin e Rrjetit TAP /Marrëveshjen e Transportit të Gazit TAP /Kodin e Transmetimit të Gazit i Irlandës Veriore dhe një numër dokumentash shoqërues /Kodin e Rrjetit i Sistemit Grek të Transmetimit të Gazit /Kodin e Rrjetit të Gazit SNAM Rete /dokumente të tjera rregullatore përkatëse.

- Në funksion sa më sipër, ky dokument synon të kontribuojë në krijimin e Rrjetit të Transmetimit të Gazit Natyror në Shqipëri mbi baza jodiskriminuese për të gjitha palët me qëllim arritjen e objektivave strategjike në këtë sektor. Gjithashtu, synohet që të arrihet një planifikim dhe operim koherent dhe i koordinuar ndërmjet Operatorit të Kombinuar të Gazit Natyror “Albgaz” sh.a. dhe gjithë përdoruesve të rrjetit të gazit aktual ose që do të krijohen në të ardhmen, me qëllim vendosjen e kushteve më të mira të mundshme për zhvillimin dhe funksionimin e një tregu të integruar dhe efektiv të gazit natyror.

- Kodi i Rrjetit të Transmetimit të Gazit Natyror trajton çështjet që lidhen me planifikimin dhe operimin e sistemit të gazit në tërësi dhe

aksesin e aktorëve të tregut në rrjetin e transmetimit të gazit natyror në Shqipëri.

- Kodi i Rrjetit të Transmetimit parashtrohet normat, rregullat, procedurat dhe kërkesat e përgjithshme dhe themelore që drejtojnë operimin dhe zhvillimin e sistemit të gazit natyror në vendin tonë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e Kodit të Rrjetit të Transmetimit të Gazit Natyror në Shqipëri.

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 756 lekë